



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 597 Akti

Nr. 514 Vendimi
Tiranë, më 28.2.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Kryesuese
Olsi Komici	Relator
Xhensila Pine	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot, në datat 24.11.2021, ora 14.00 dhe 25.2.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Violeta Shkurta**, prokurore, drejtuese e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr.76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjo relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, subjektin e rivlerësimit Violeta Shkurta, vëzhguesin ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot, pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore publike, në tërësinë e tij, vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Violeta Shkurta, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Violeta Shkurta, ushtron detyrën e drejtueses së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.6.2020 në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, short nga i cili rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 2, i përbërë nga komisionerët: Firdes Shuli, Olsi Komici dhe Xhensila Pine. Relator i çështjes u zgjodh me short, komisioneri Olsi Komici.

3. Me vendimin nr.1, datë 2.7.2021, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Violeta Shkurta, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Firdes Shuli. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mungesa e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes.

Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Ferdinando Buatier De Mongeot.

4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim, Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Grupi i Punës në Këshillin e Lartë të Prokurorisë (në vijim KLP).

5. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme vetëm për kriterin e pasurisë.

6. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 28.10.2021, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për kriterin e pasurisë për subjektin e rivlerësimit Violeta Shkurta, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurës Administrative.

7. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 28.10.2022 mbi të drejtën e saj për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfuturara nga hetimi kryesisht i zhvilluar prej Komisionit. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

8. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me rezultatet e hetimit në datën 12.11.2021 ka dërguar nëpërmjet postës zyrtare, të protokolluar me nr. *** prot., datë 15.11.2021, prapësimet dhe provat në Komision, në lidhje me rezultatet e hetimit të dërguara nga Komisioni.

9. Komisioni, nëpërmjet postës elektronike në datën 16.11.2021, njoftoi subjektin për seancën dëgjimore të datës 18.11.2021. Me *e-mail* në datën 17.11.2021 subjekti i rivlerësimit i kërkoi Komisionit shtyrjen e seancës dëgjimore për arsye shëndetësore. Komisioni, me *e-mail* në datën 18.11.2021, i njoftoi subjektit se seanca dëgjimore do të zhvillohej më 24.11.2021 (ora 14:00).

10. Komisioni, pasi mori në konsideratë shpjegimet e dhëna nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe provat e depozituara, vendosi të pranojë kërkesën e subjektit nr. *** prot., datë 15.11.2021, të përsëritur edhe në seancë dëgjimore, për riçeljen e hetimit administrativ për kriterin e pasurisë dhe çeljen e hetimit për dy kriteret e tjera të vlerësimit: kontrollin e figurës dhe aftësive profesional, duke ia njoftuar këtë vendim subjektit.

11. Komisioni, pasi kreu hetimin administrativ, në lidhje me kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesional, me *e-mail*, datë 11.2.2022, i dërgoi subjektit të rivlerësimit rezultatet e hetimit.

12. Me *e-mail*, datë 21.2.2022, subjekti i rivlerësimit ka dërguar prapësime dhe prova në lidhje me këto rezultate.

II. SEANCA DËGJIMORE

13. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, në lidhje me diskutimin e rezultateve për kriterin e vlerësimit të pasurisë, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 24.11.2021 (ora 14:00), në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot.

14. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe parashtroi shpjegimet e saj, si dhe i depozitoi ato me shkrim në Komision. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit Violeta Shkurta kërkoi rihapjen e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesional dhe në përfundim kërkoi konfirmimin e saj në detyrë.

15. Me *e-mail*, datë 25.11.2021, Komisioni njoftoi subjektin e rivlerësimit për pranimin e kërkesës për riçeljen e hetimit administrativ për kriterin e pasurisë dhe riçeljen e hetimit edhe për të dy kriteret e tjera, të figurës dhe atë profesional.

16. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore, me njoftimin e bërë në rrugë elektronike në datën 22.2.2022, për t'u dëgjuar në lidhje me rezultatet e hetimit administrativ për të tri kriteret e vlerësimit.

17. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 25.2.2022, ku subjekti i rivlerësimit, pasi dha shpjegimet e saj, kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

18. Zj. Violeta Shkurta ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Subjekti ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe ka dhënë shpjegime për të gjitha problematikat për të cilat Komisioni i ka ngarkuar barrën e provës.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

19. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

20. Për subjektin e rivlerësimit Violeta Shkurta, bazuar në nenin 179/b Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të saj, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit përfshin tri kritere: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; si dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

21. Pavarësisht se në kreun IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me këtë vlerësim pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut II të ligjit nr. 84/2016, Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

22. Me shkresën nr. ***, datë 30.3.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Violeta Shkurta, e cila është subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së që prej vitit 2003, me numër indeksi ***, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

23. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2013 deri në vitin 2016 dhe referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 25.1.2017. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për çdo pasuri të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ILDKPKI-ja ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

24. Bazuar në ligjin nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të kontrollit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Referuar neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr.84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- b) deklaratën e pasurisë - shtojca 2 dhe deklaratat periodike të pasurisë ndër vite;
- c) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI;

- d) provat shkresore/dokumentet, të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016;
- e) deklarime dhe prova të dërguara nga subjekti i rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- f) shpjegimet me shkrim të subjektit, si dhe shpjegimet e saj në seancën dëgjimore, etj.

25. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, si dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të pasurive në pronësi apo përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë situatë konflikti interesi, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

26. Në lidhje me dorëzimin e deklaratës së pasurisë - shtojca 2 në zbatim të nenit 31/1¹ të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit Violeta Shkurta e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë (duke përfshirë edhe personat e lidhur me të) në datën 25.1.2017, brenda afatit 30-ditor nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

❖ Pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *Vetting*

1. Pasuria e llojit “apartament” e regjistruar në ZVRPP-në Fier, përfituar nga privatizimi me kontratë shitblerjeje nr. *, datë 23.2.2011. Vlera e apartamentit 0 (zero) lekë, kurse vlera e truallit 174,802 lekë. Pjesa takuese: 50%.**

Burimi i krijimit: të ardhurat, huamarrje.

1.1 Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2011. Subjekti, ndër të tjera, i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: (i) certifikatë pronësie, datë 3.7.2014, që konfirmon bashkëpronësinë e subjektit dhe bashkëshortit mbi këtë apartament me sip. 36.5 m²; (ii) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 3.2.2011, me shitës Bashkinë Fier dhe blerës subjekti dhe bashkëshorti A.Sh.; (iii) autorizim, datë 23.7.1992, i ish-Komitetit Ekzekutiv Pluralist Fier, në të cilin autorizohet shtetasi A.Sh. (bashkëshorti i subjektit) të strehohet në një dhomë e kuzhinë (dhoma nr. ***), në banesën te hotel “****”, lagjja “****”, Fier.

1.2 Praktika e privatizimit është dërguar² në Komision edhe nga ASHK-ja Fier. Gjithashtu, sipas shkresës³ së ZVRPP-së Fier dërguar ILDKPKI-së, rezultoi se në pronësi të subjektit dhe bashkëshortit A.Sh. figurojnë pasuria nr. ***, e llojit “Apartament” me sip. 36.5 m² dhe vërtetimi i parë i pronësisë mban datën 28.2.2011.

1.3 Në DIPP-të e viteve 2003 dhe 2005 subjekti ka deklaruar adresën – lagjja “****”, ish-hotel “****”, dhoma nr. ***, Fier; në DIPP-në e vitit 2004, adresën – rruga “****”, p. ***, ap. ***, shk. ***, të cilat përputhen me adresën e apartamentit me sip. 36.5 m², ndërkohë që në pyetësorin standard subjekti ka deklaruar se gjatë periudhës 2003 – korrik 2006, familjarisht, kanë banuar në apartamentin e shtetasit S.M. në lagjen “****”, me qira në vlerën 5,000 lekë/muaj⁴.

¹Subjekti i rivlerësimit ka detyrim të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon në ILDKPKI.

²Shkresë nr. *** prot., datë 2.7.2021, e ASHK-së Fier.

³Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2017, e ZVRPP-së Fier.

⁴Subjekti ka paraqitur deklaratë noteriale nr. ***, datë 13.7.2020, të shtetasës D.M., e cila konfirmon se: “Ka në pronësi një apartament në lagjen ‘****’, ku ka banuar shtetasja Violeta Shkurta së bashku me familjen e saj nga muaji shtator 2002

1.4 Lidhur me këtë mospërputhje, subjekti ka shpjeguar se: “Unë kam banuar në periudhën 1992 – 2002, në dhomën nr. ***, ish-hotel ‘***’, Fier. Në periudhën shtator 2002 – korrik 2006 kam banuar në apartamentin e shtetasit S.M. me qira në vlerën 5,000 lekë/muaj, në lagjen ‘***’. Prej vitit 2007 kam filluar të banoj në adresën lagjja ‘***’, rr. ‘***’, pranë Muzeut Historik Fier, ap. ***...”.

1.5 Në lidhje me investimet e kryera për mobilimin e apartamentit me sip. 36.5 m², subjekti ka shpjeguar se nga viti 1992 kur është martuar dhe deri në vitin 2002, ka jetuar me bashkëshortin dhe fëmijët në dhomën nr. ***, në ish-hotel “***”, Fier, sipas autorizimit të dhënë nga Komiteti Ekzekutiv Pluralist i kohës. Që nga viti 2002 – 2009 kanë qenë subjekte në disa procese gjyqësore, ku shtetasi Xh.Xh. pretendonte pronësinë e kësaj dhome dhe dhomave të tjera. Gjatë këtyre proceseve i është hequr nëdorësia e dhomës në momente të caktuara⁵. Në vitin 2002, për shkak se fëmijët u rritën, u largua me qira në një apartament tjetër në pronësi të shtetasit S.M. Nuk kanë kryer mobilim të kësaj dhome, të cilën prej vitit 2015 ia ka dhënë me qira shtetasit M.Sh., i cili ushtron veprimtari shitje materiale ndërtimi. Nga fotot e objektit, bashkëlidhur shpjegimeve, konstatohen ambiente tregtimi të materialeve të ndërtimit.

1.6 Komisioni ka hetuar për ndonjë situatë konflikti interesi të subjektit me shtetasin S.M. dhe nga hetimi⁶ nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë.

1.7 Komisioni ka disponuar shkresën⁷ nr. ***, datë 21.9.2021, të Gjykatës së Apelit Vlorë, e cila ka dërguar disa vendime gjyqësore⁸, ku rezulton që për periudhën 2004 – 19.4.2019 ka pasur procese gjyqësore në tri shkallët e gjykimit, me objekt “njohje pronësie” mbi dhomën nr. *** (dhe dhoma të tjera të godinës) nga paditësi Xh.Xh., por nuk rezulton që në momente të caktuara t’i jetë hequr subjektit e drejta e përdorimit.

1.8 Subjekti ka depozituar në Komision një shkresë⁹ nga ASHK-ja Fier, ku rezulton se bashkia e ka humbur pronësinë mbi apartamentin gjatë periudhës 26.9.2005 – 17.7.2009, kur prona ishte e regjistruar në emër të shtetasit Xh.Xh. Si rrjedhim, e drejta e përdorimit të këtij apartamenti mund t’i jetë hequr subjektit gjatë kësaj periudhe, pasi në qershor të vitit 2014 shtetasi Xh.Xh. ka cenuar pronën e subjektit duke hyrë me forcë brenda saj. Për të provuar shpjegimet e tij, subjekti ka paraqitur përveç vendimeve gjyqësore përkatëse edhe vendimin e datës 4.9.2014 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, për njoftimin e akuzës së veprës penale të vetëgjyqësisë shtetasit Xh.Xh., i cili ka cenuar pronën e subjektit duke hyrë me forcë brenda saj.

– korrik 2006, me qira mujore 5.000 lekë/muaj dhe kanë paguar rregullisht detyrimet e tyre. Qiraja nuk ka qenë me kontratë sepse fillimisht bëhej fjalë për një qëndrim disamujor pastaj u zgjat me dëshirën e dyanshme për një periudhë të pacaktuar”.

⁵Subjekti vijon: “Me vendimin nr. ***, datë 8.6.2005, të Gjykatës së Apelit Vlorë është ndryshuar vendimi nr. ***, datë 29.6.2004, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, duke vendosur detyrimin e Bashkisë Fier të njohë paditësin Xh.L. si pronar të dhomave të ish-hotel *** (përfshirë edhe dhomën tonë). Përfundimisht me vendimin nr. ***, datë 19.4.2019, Gjykata e Apelit Vlorë vendosi që pronar i dhomave ***, ***, ***, *** në hotel ‘***’ është Bashkia Fier dhe kalimi i pronësisë të kryer nga bashkia rezultoi i ligjshëm”. Subjekti ka depozituar bashkëlidhur, vendimin nr. ***, datë 29.6.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ku është bërë shënimi nga sekretaria gjyqësore se: “Me vendimin nr. ***, datë 1.12.2006, të Gjykatës së Lartë është lënë në fuqi vendimi nr. ***, datë 8.6.2005. Me vendimin nr. ***, datë 15.2.2018, të Gjykatës së Lartë është vendosur pranimi i kërkesës së shtetasit A.Sh. për rishikim, prishjen e vendimit nr. ***, datë 8.6.2005, dhe rikthimin e çështjes për rigjykim. Me vendimin nr. ***, datë 19.4.2019, Gjykata e Apelit Vlorë ka lënë në fuqi vendimin nr. ***, datë 29.6.2004”.

⁶Shkresë nr. *** prot., datë 10.9.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

⁷Shkresë nr. *** prot., datë 21.9.2021, e Gjykatës së Apelit Vlorë.

⁸Vendimi nr. ***, datë 8.6.2005 dhe vendimi nr. ***, datë 19.4.2019, i Gjykatës së Apelit Vlorë.

⁹Shkresë nr. *** prot., datë 4.11.2021, e ASHK-së Fier.

Lidhur me burimin e krijimit të këtij apartamenti – huamarrja

1.9 Në deklaratën Vetting, subjekti ka deklaruar: “*Bashkëshorti huamarrje nga motra A.G. në vitin 2011, me qëllim mbylljen e kredisë që ka marrë në vitin 2006 dhe për shpenzime të tjera vërtetuar me deklaratë noteriale nr. ***, datë 8.2.2016. Vlera: 10,000 euro*”.

1.10. Në DIPP-në e vitit 2011, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar në seksionin e të dhënave konfidenciale “*marrë hua nga motra ime A.Sh. (G.), në shumën 10,000 euro*”.

1.11. Në procesverbalin e ILDKPKI-së¹⁰, datë 9.2.2016, subjekti është pyetur mbi qëllimin e huamarrjes, burimin e saj, si është marrë kjo hua nga ana e subjektit (*cash* apo me transfertë bankare), sa është detyrimi i mbetur deri në datën 31.12.2014. Subjekti ka shpjeguar se kjo vlerë është marrë me qëllim pagesën e dhomës me sip. 36 m² në ish-hotel “****” dhe një pjesë për mbylljen e kredisë favorizuese nga bashkia në vitin 2006. Detyrimi i mbetur deri në datën 31.12.2014 është në vlerën 10,000 euro. Burimi i huas është nga të ardhurat nga puna në shoqërinë “****” sh. a.

1.12. Subjekti i ka bashkëlidhur deklarimit, deklaratën noteriale¹¹, datë 8.2.2016, ku zj. A.G. deklaroi se në vitin 2011 i ka dhënë vëllait të saj A.Sh., vlerën monetare 10,000 euro, për një kohë të pacaktuar për shkak të lidhjeve familjare. Këtë shumë e ka kursyer nga puna e saj, ndër vite, pranë shoqërisë “****” sh. a.

1.13 Lidhur me këtë hua, në pyetësorin standard, subjekti ka deklaruar se huaja personale e marrë nga bashkëshorti motrës A.G., në vitin 2011, në shumën 10,000 euro, është përdorur: (i) shuma 600,000 lekë për mbylljen e kredisë të marrë në BKT në vitin 2006; (ii) shuma 200,000 lekë për blerjen e apartamentit tek ish-hotel “****”; (iii) shuma 200,000 lekë shpenzime për mjekimin e babait të bashkëshortit; (iv) shuma 200,000 lekë për blerjen e disa mobileve për shkak të gjendjes shëndetësore të vjehrrit.

1.14 Bashkëlidhur, subjekti ka depozituar vërtetimin, datë 6.7.2020, nga shoqëria “****” sh. a., që konfirmon se znj. A.G. ka qenë e punësuar pranë kësaj shoqërie gjatë periudhave 1.10.2005 – 30.9.201 dhe 1.10.2012 – 18.2.2019 dhe se paga *neto* mujore përpara shkëputjes së marrëdhënieve të punës ka qenë 162,040 lekë/muaj.

1.15 Komisioni vlerëson se referuar pikës 14 të nenit 3, si dhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, motra e bashkëshortit të subjektit bën pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë.

1.16 QKB-ja¹² informon se shtetasja A.G. figuron anëtare e Këshillit Mbikëqyrës në subjektin “****” sh. a.

1.17 Shoqëria “****” sh. a.¹³ sqaron se znj. A.Sh. ka qenë e punësuar pranë kësaj shoqërie për periudhën 1.10.2005 – 30.9.2010, por nuk e disponojnë informacionin e kërkuar nga Komisioni¹⁴, për shkak se nuk e ruan këtë informacion për më shumë se 10 vjet, bazuar në ligjin nr. 9154, datë 6.1.2003, “Për arkivat”.

¹⁰Përcjellë nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. *** prot., datë 3.2.2021.

¹¹Deklaratën noteriale nr. ***, datë 8.2.2016, të zj. A.G.

¹²Shkresë nr. *** prot., datë 29.8.2017 (dosje ILDKPKI).

¹³Shkresë nr. *** prot., datë 8.8.2021.

¹⁴Me shkresën nr. *** prot., datë 23.6.2021, Komisioni kërkoi informacion lidhur me të ardhurat e realizuara nga punësimi pranë kësaj shoqërie nga ana e shtetasës A.G., përgjatë periudhës 1.10.2005 – 31.12.2011.

1.18 Nga përlllogaritja e të ardhurave *neto* mbi pagat dhe shpërblimet, bazuar në dokumentacionin e depozituar nga Arkivi Qendor Tiranë¹⁵, si dhe e shpenzimeve jetike të përlllogaritura për një person dhe duke mos konsideruar asnjë investim në pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, personi tjetër i lidhur, znj. A.Sh., rezultoi në pamundësi financiare në vlerën 585,500 lekë, për të mundësuar dhënien e huas prej 10,000 euro.

1.19 Subjekti ka paraqitur një transfertë bankare, datë 17.7.2020, nga llogaria e bashkëshortit të llogaria e shtetas A.G. me përshkrimin “kthim detyrimi”, në shumën 700,000 lekë.

1.20 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe neneve Ç e D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit, për sa duket se personi tjetër i lidhur/shtetasja A.G. nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për huan e dhënë në vlerën 10,000 euro dhe, për rrjedhojë, subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

1.21 Në prapësimet mbi barrën e provës, subjekti i rivlerësimit, veç të tjerash ka shpjeguar se: (i) shtetasja A.G. ka qenë emëruar anëtare e Këshillit Mbikëqyrës në shoqërinë “****” sh. a., për periudhën 11.11.2008 – 11.11.2011, ku është paguar me honorare *bruto* 30,000 lekë/muaj, referuar vërtetimit, datë 4.11.2021, lëshuar nga kjo shoqëri; si dhe (iii) është martuar me shtetasin I.G., i cili zotëron 50% të aksioneve në shoqërinë “****”.

1.22 Subjekti i ka bashkëlidhur shpjegimeve: (i) raportin e ekspertimit, datë 10.9.2021, të ekspertit kontabël A.M.; (ii) certifikatë martesë, datë 5.11.2021, ku A. dhe I.G. figurojnë të martuar në datën 18.2.2008; (iii) vërtetim, datë 4.11.2021, nga shoqëria “****” sh. a. për honorarin në vlerën 30,000 lekë/muaj të anëtares së Këshillit Mbikëqyrës, A.G.; (iv) vendimin e asamblesë, datë 11.11.2008, të shoqërisë “****” sh. a. për emërimin e zj. A.G. si anëtare e Këshillit Mbikëqyrës për 3 vjet; (v) vërtetim page, datë 10.11.2021, të z. I.G., për periudhën janar 2008 – dhjetor 2011, lëshuar nga shoqëria “****” sh. a.; (vi) ekstraktin e shoqërisë “****” sh. a., ku z. I.G. figuron ortak me 50% të aksioneve që nga data e regjistrimit 15.1.1996.

1.23 Pas riçeljes së hetimit, Komisioni hetoi lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të shtetas A.G. dhe administroi shkresën nr. ***, datë 6.12.2021, të Drejtorisë së Arkivit Lundër, ISSh-ja, ku pasqyrohen të ardhurat *bruto* nga pagat e shtetasit I.G. për periudhën janar 2008 – dhjetor 2011.

Vlerësimi i Komisionit

1.24 Komisioni përlllogariti të ardhurat *neto* të shtetasit I.G., për periudhën 2008 – 2010, bazuar në legjislacionin në fuqi të kohës, nga ku rezultuan të ardhura në shumën totale 1,900,548 lekë¹⁶.

1.25 Komisioni kreu analizën financiare, duke përfshirë të ardhurat e shtetas A.G., të ardhurat e bashkëshortit të saj I.G. dhe duke përlllogaritur shpenzime jetike për 3 persona, nga ku rezultoi një balancë pozitive në vlerën 1,454,084 lekë, e mjaftueshme për dhënien e huas në vlerën 1,383,000 lekë, si në tabelën në vijim:

Tabela nr. 1 – Analiza financiare për huan në vlerën 10,000 euro

Viti	Të ardhura nga paga A.G.	Të ardhura nga paga I.G.	Shpenzime jetike 3 persona	Balanca e fondeve
------	--------------------------	--------------------------	----------------------------	-------------------

¹⁵Shkresë nr. *** prot., datë 28.7.2021.

¹⁶Tatimi mbi të ardhurat u përlllogariti bazuar në ligjin nr. 9766, datë 9.7.2007, ndalesat për sigurimet shoqërore u përlllogaritën në masën 11,2%.

2008	216,032	419,846	409,860	226,018
2009	324,048	672,977	409,860	587,165
2010	243,036	807,725	409,860	640,901
TOTAL	783,116	1,900,548	1,229,580	1,454,084

Bazuar në prapësimet e subjektit dhe në dokumentacionin e administruar të riçeljes së hetimit, si dhe në analizën financiare të rishikuar, Komisioni vlerëson se personi tjetër i lidhur/A.G. ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për t'i dhënë hua subjektit të rivlerësimit në shumën 10,000 euro dhe, për rrjedhojë, subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.

2. Apartament banimi me sip. 180.3 m², i regjistruar në ZVRPP-në Fier me nr. *, vol. ***, f. ***, z. k. ***, datë 16.5.2006, blerë me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 19.4.2006, hipotekuar në favor të BKT-së, dega Fier, në datën 17.5.2006. Vlera: 8,060,000 lekë Pjesa takuese: 50 %.**

Burimi i krijimit: kredi marrë pranë BKT-së, dega Fier, datë 7.5.2006. Të ardhurat nga shitja e aparaturave të bingos “****”, blerë në vitin 1999.

2.1 Subjekti në lidhje me këtë pasuri shpjegon se: *“Në lidhje me vlerën e apartamentit sqarohet se në kontratën e shitblerjes, vlera e apartamentit është 8,460,000 lekë, kontrata është lidhur me qëllim marrjen e kredisë, por apartamenti ishte i papërfunduar. Në vazhdim të punimeve dhe në marrëveshje me firmën ndërtuese, disa punime në vlerën 400,000 lekë nuk u kryen”*. Subjekti, bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, ka depozituar këto dokumente: (i) aktmarrëveshje, datë 16.4.2005, lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k., me cilësinë e sipërmarrësit (përfaqësuar nga administratori E.Xh.) dhe bashkëshortit të subjektit A.Sh. me cilësinë e blerësit, për ndërtimin në favor të blerësit të një apartamenti me sip. 180.3 m², kundrejt vlerës 8.460.000 lekë; (ii) mandatpagesën nr. ***, datë 16.4.2005, lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k., sipas së cilës blerësi ka paguar 30% e vlerës totale 2,500,000 lekë, në datën e lidhjes së aktmarrëveshjes; (iii) vërtetim hipotekor lëshuar nga ZVRPP-ja Fier, datë 31.10.2005, sipas të cilit shtetasi E.Xh. është pronar i këtij apartamenti (dhe jo shoqëria “****” sh.p.k.); (iv) mandatpagesë nr. ***, datë 31.12.2006, lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k., sipas së cilës blerësi ka paguar këstin në vlerën 400,000 lekë; (v) transfertën bankare, datë 31.1.2006, nga “Raiffeisen Bank”, për shumën 800,000 lekë për shlyerje të vlerës së apartamentit; (vi) mandat, datë 17.10.2006, nga “Raiffeisen Bank”, sipas të cilit subjekti ka tërhequr shumën 697,000 lekë për t’ia kaluar shoqërisë “****” sh.p.k., me qëllim shlyerje kësti të apartamentit; (vii) kontratë shitblerje¹⁷ apartamenti, datë 19.4.2006, lidhur midis shitësve E. dhe A.Xh. (si individë dhe jo si përfaqësues të shoqërisë “****” sh.p.k.) dhe blerësve Violeta e A.Sh., për pasurinë nr. ***, z. k. ***, e llojit apartament me sip. 180.3 m², lagjja “****”, rr. “****”, Fier, kundrejt vlerës 8,460,000 lekë, e cila sipas kontratës rezulton se është marrë dorazi njëherësh nga pala shitëse; (viii) vërtetim pronësie, datë 16.5.2006, nga ZVRPP-ja Fier, në emër të subjektit dhe bashkëshortit, për apartamentin me sip.180.3 m²; (ix) kontratë hipotekimi¹⁸ të apartamentit me sip.180.3 m² në pronësi të subjektit dhe bashkëshortit në favor të BKT-së, dega Fier, si garanci për kredinë e marrë në vlerën 4.500.000 lekë për blerjen e këtij apartamenti; (x) përshkrim llogarie të subjektit nga BKT-ja Fier, sipas të cilit në datën 18.5.2006, në llogarinë e subjektit është kredituar vlera e kredisë; (xi) deklaratë noteriale, nr. ***, datë 13.4.2007, nënshkruar nga shtetasi E.Xh., subjekti dhe bashkëshorti, ku palët deklarojnë se pavarësisht nga vlera totale e apartamentit prej 8,460,000 lekësh, është zbritur

¹⁷Kontratë shitblerje apartamenti nr. ***, datë 19.4.2006.

¹⁸Kontratë hipotekimi nr. ***, datë 17.5.2006.

vlera 400,000 lekë, për shkak ndryshimi të projektit, si dhe mbetet pa shlyer për një afat të pacaktuar në vlerën 250,000 lekë.

2.2 Komisioni ka administruar shkresën¹⁹ dhe nuk rezultoi ndonjë situatë konflikti interesi ndërmjet subjektit dhe shtetasit E.Xh.

2.3 Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar: “*Apartament banimi me sip. 180.3 m², blerë nga firma ‘***’, vendndodhja lagjja ‘***’, qyteti Fier, paguar kësti i parë në datën 16.4.2005, në shumën 2.500.000 lekë, pa hipotekuar, vlera e përgjithshme 8.460.000 lekë, pjesa takuese 50%. Detyrim financiar ndaj firmës ndërtuese ‘****’ sh.p.k., Fier. Vlera: 5,960,000 lekë*”.

2.4 Në DIPP viti 2006, subjekti ka deklaruar: “*Apartament banimi me sip.180.3 m², blerë me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 19.4.2006, regjistruar në hipotekë në datën 16.5.2006, në ZVRPP-në Fier, hipotekuar në favor të BKT-së për marrjen e kredisë për blerjen e shtëpisë në datën 17.5.2006, vlera 5,300,000 lekë. Në lidhje me vlerën e apartamentit sqaroj se disa prej punimeve në vlerën 400,000 lekë nuk u kryen me marrëveshje për shkak të ndryshimit të projektit. Vlera reale e apartamentit është 8,060,000 lekë. Ndaj shitësit kemi një detyrim 250,000 lekë për të paguar për një afat të pacaktuar*”. Më tej, në seksionin e detyrimeve financiare të deklaratës citon ndër të tjera: “*... detyrim ndaj shtetasit E.Xh. në shumën 250,000 lekë për blerjen e apartamentit*”.

2.5 Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 9.2.2016, subjekti ka shpjeguar se: “*Apartamenti është blerë fillimisht me kontratë porosie sipas aktmarrëveshjes, datë 16.4.2005, me lidhjen e së cilës ka likuiduar vlerën 2,500,000 lekë²⁰. Burim i kësaj vlere është nga shitja e aktivitetit ‘****’ sh.p.k., në vlerën 1,900,000 lekë dhe pjesa tjetër nga aktiviteti i bashkëshortit. Në janar të vitit 2006 kam pakësuar llogarinë e pagës në ‘Raiffeisen Bank’, në vlerën 700,000 lekë dhe 100,000 lekë nga bashkëshorti dhe kemi kryer likuidimin e vlerës 800,000 lekë. Në maj të vitit 2006, kemi marrë kredinë në vlerën 4,500,000 lekë dhe më pas kemi shlyer pjesën e mbetur*”.

2.6 Në deklaratën Vetting, subjekti deklaron: “*Detyrim ndaj subjektit ‘***’ sh.p.k., që ka mbetur pa u shlyer nga blerja e apartamentit me sipërfaqe 180,3 m². Vlera: 250,000 lekë*”.

2.7 Bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit standard, subjekti ka depozituar edhe deklaratën noteriale, datë 28.3.2019²¹, ku deklaruesit E.Xh. (Xh.), subjekti dhe bashkëshorti deklarojnë se shuma 250,000 lekë, njohur si detyrim ndaj E.Xh. për blerjen e apartamentit me vlerë 8,060,000 lekë, është shlyer jashtë zyrës noteriale dhe nga ky moment nuk kanë asnjë detyrim ndaj z. E.Xh. Duke iu referuar deklaratës noteriale nr. ***, datë 13.4.2007²², si dhe deklarimeve të subjektit, rezulton se detyrimi prej 250,000 lekë i është shlyer shitësit të apartamentit pas një periudhe rreth 12-vjeçare. Në pyetësorin nr. 2, Komisioni kërkoi nga subjekti që të shpjegojë se me cilat kushte i është lënë nga ana e shitësit kjo shumë pa paguar, konsideruar periudhën relativisht të gjatë rreth 12 vjet. Në përgjigje të pyetësorit, subjekti ka shpjeguar se shitësi banon në të njëjtin pallat me të dhe bashkëshorti e ka njoftuar se pas blerjes, kishin ndërmend ta shisnim apartamentin, por nuk gjetëm blerës, kështu që prej disa vitesh ishim në vështirësi për pagesat e kredisë dhe në vitin 2019 mundëm të shlyenim detyrimet ndaj shitësit.

2.8 Referuar deklarimeve të subjektit dhe dokumenteve më lart si: (i) aktmarrëveshje, datë 16.4.2005, lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k. me cilësinë e sipërmarrësit; vërtetim hipotekor

¹⁹Shkresë nr. *** prot., datë 10.9.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

²⁰Mandatpagesë nr. ***, datë 16.4.2005.

²¹Kontratë shitblerje apartamenti nr. ***, datë 19.4.2006.

²²Me anë të së cilës shtetasi E.Xh. konfirmon detyrimin e mbetur në shumën 250.000 lekë dhe i njeh debitorëve të drejtën për të shlyer detyrimin në një kohë të pacaktuar.

nga ZVRPP-ja Fier, datë 31.10.2005, sipas të cilit pronar i apartamentit me sip. 180,3 m² është shtetasi E.Xh. dhe jo shoqëria “****” sh.p.k.; (ii) kontratë shitblerjeje apartamenti²³ lidhur midis shitësve E. dhe A.Xh. dhe blerësve Violeta dhe A.Sh., Komisioni i ka kërkuar subjektin në pyetësonin nr. 2, që të shpjegojë dhe provojë me dokumentacion, lidhjen e shoqërisë “****” sh.p.k. dhe z. E.Xh., si dhe kalimin e të drejtave të pronësisë së apartamentit me sip. 180 m² nga kjo shoqëri te z. E.Xh. Në përgjigje, subjekti ka depozituar shkresën e ASHK-së Fier²⁴, sipas së cilës konfirmohet se: *Apartamenti me sip. 180.3 m² është regjistruar fillimisht në emër të E.Xh. dhe më pas me kontratë shitblerje nr. ****, datë 19.4.2006, është regjistruar në emër të subjektit dhe bashkëshortit të saj.* Gjithashtu, subjekti ka depozituar edhe vërtetimin, datë 28.8.2021, të shoqërisë “****” sh.p.k. nënshkruar nga A.Xh., përfaqësuese e kësaj shoqërie, që konfirmon porositjen e apartamentit nga bashkëshorti i subjektit me aktmarrëveshjen, datë 16.4.2005, pagesën e këstit në vlerën 2,500,000 lekë, në datën 16.4.2005, kësti 800,000 lekë në janar 2006, kësti 4,500,000 lekë, i paguar *cash* në datën 18.5.2006, lidhjen e kontratës së shitblerjes së apartamentit, nr. ****, datë 19.4.2006, si dhe kësti i mbetur në shumën 250,000 lekë i paguar në vitin 2019.

2.9 Komisioni ka verifikuar dhe çmimin e blerjes së apartamentit duke e krahasuar me çmimin referues të EKB-së për vitin 2006, ku çmimi në tregun e lirë të apartamenteve për qytetin e Fierit²⁵ llogaritet me 48,248 lekë/m². Duke llogaritur sip. 180.3 m² x 48,248 lekë/m² = 8,699,114 lekë, nuk u konstatua ndonjë problematikë.

2.10 Në pyetësonin standard, lidhur me shpenzimet e mobilimit të shtëpisë, subjekti ka sqaruar se për mobilimin e shtëpisë ka shpenzuar rreth 300,000 lekë gjatë periudhës 2007 – 2009. Një pjesë të mobileve i ka punuar te shtetasi M.Ç.²⁶, një pjesë i ka pasur edhe në banesat ku ka jetuar më parë. Disa punime i ka kryer z. A.V., bashkëshorti i motrës së subjektit, i cili është marangoz dhe e ka ushtruar këtë aktivitet për disa vjet në Fier e Durrës.

2.11 Në përfundim të hetimit, Komisioni i ka kërkuar subjektin shpjegime për sa duket e dyshimtë se vlera e shpenzimeve për mobilimin e shtëpisë të ketë qenë 300,000 lekë, duke konsideruar sipërfaqen e saj prej 180,3 m² (4 dhoma gjumi, etj.) dhe përbërjen familjare prej 4 personash.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

2.12 Në prapësime, subjekti ka dhënë të njëjtat përgjigje që ka dhënë në pyetësonin standard dhe i ka bashkëlidhur shpjegimeve: (i) deklaratë noteriale, datë 11.11.2021²⁷, ku shtetasi M.Ç. deklaroi se ka punuar disa mobilje për subjektin në vlerën 300,000 lekë; (ii) ekstrakt të regjistrimit tregtar të personit fizik M.Ç. i regjistruar në datën 9.6.2003; (iii) shkresë, datë 11.11.2021, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier²⁸ që konfirmon se shtetasi A.V. figuron i regjistruar si tatimpagues me aktivitet “marangoz”, për periudhën 1997 – 1998; (iv) deklaratë noteriale, datë 11.11.2021²⁹, ku shtetasi A.V. (bashkëshorti i motrës së subjektit) deklaroi se i ka bërë dhuratë subjektit, disa mobilje për shtëpinë e re që kanë blerë në lagjen “****”, Fier, gjatë kohës kur punonte si marangoz në shoqërinë “****” sh.p.k.

²³Kontratë shitblerjeje apartamenti nr. ****, datë 19.4.2006.

²⁴Shkresë nr. ****, datë 16.7.2021, e ASHK-së Fier.

²⁵Udhëzim nr. 5, datë 7.9.2006, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga EKB-ja, për vitin 2006”.

²⁶Për të hetuar konfliktin e interesit midis subjektit dhe shtetasit M.Ç., Komisioni administroi shkresën nr. **** prot., datë 10.9.2021, sipas së cilës nuk rezulton që pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier të jenë regjistruar të dhëna për këtë shtetas.

²⁷Deklaratë noteriale nr. ****, datë 11.11.2021, nga shtetasi M.Ç.

²⁸Shkresë nr. **** prot., datë 11.11.2021, nga DR Tatimore Fier.

²⁹Deklaratë noteriale nr. ****, datë 11.11.2021.

Vlerësimi i Komisionit

2.13 Në vlerësim të situatës faktike, pavarësisht se vlera e arredimit e deklaruar nga subjekti për periudhën 2007 – 2009 nuk duket plotësisht e besueshme, Komisioni gjendet në kushtet e pranimit të vërtetësisë së deklarimeve të subjektit në kushtet e mungesës së një reference ligjore që do të bënte të mundur përcaktimin e një vlere të ndryshme nga ajo e deklaruar.

Në vijim, Komisioni analizoi secilën pagesë të kryer për blerjen e apartamentit dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre.

2.14 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka dhënë shpjegime në lidhje me pagesat për blerjen e apartamentit dhe kohën e kryerjes së tyre duke paraqitur dhe dokumentacion justifikues të lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k., në vijim. Apartamenti është porositur sipas aktmarrëveshjes, datë 16.4.2005, në vlerën 8,460,000 lekë. Pagesat janë kryer si vijon: (i) në momentin e nënshkrimit të aktmarrëveshjes, është paguar nga bashkëshorti kësti i parë në shumën 2,500,000 lekë, sipas mandatpagesës nr. ***, datë 16.4.2005; (ii) në datën 31.12.2006 paguar kësti i dytë me vlerë 800,000 lekë me burim kursimet nga pagat sipas transfertës bankare; (iii) pasi është disbursuar kredia në datën 18.6.2006, është paguar shuma 4,500,000 lekë sipas mandatarkëtimit³⁰; (iv) me deklaratë noteriale³¹ u pasqyrua fakti që një pjesë e punimeve në shumën 400,000 lekë nuk u kryen, kurse shuma 250,000 lekë u njoh si detyrim nga palët për t’u shlyer në kohë të pacaktuar dhe u pagua në datën 28.3.2019, siç vërtetohet nga deklaratat noteriale nr. ***, datë 28.3.2019. Bashkëlidhur: vërtetim nga shoqëria “****” sh.p.k., datë 28.8.2021; mandatarkëtim nr. ***, datë 16.4.2005; mandatpagesë nga “Raiffeisen Bank”, datë 31.1.2016; mandatarkëtim nr. ***, datë 18.6.2006; deklaratë noteriale³², datë 13.4.2007; deklaratë noteriale³³, nr. ***, datë 28.3.2019.

Pagesa e parë – kësti në shumën 2,500,000 lekë, datë 16.4.2005

2.15 Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 9.2.2016, subjekti ka shpjeguar se me lidhjen e marrëveshjes ka likuiduar vlerën 2,500,000 lekë, sipas mandatpagesës nr. ***, datë 16.4.2005³⁴, bashkëlidhur, arkëtuar nga shtetasi A.Sh. për shoqërinë “****” sh.p.k., me përshkrim “apartamenti nr. ***, në katin *** të banimit” dhe, më tej, ka sqaruar se burim i kësaj vlere është nga shitja e “****” sh.p.k., në vlerën 1,900,000 lekë dhe pjesa tjetër nga aktiviteti i bashkëshortit.

2.16 Komisioni i analizoi këto dy burime si vijon:

i) Të ardhurat nga shitja e “****” sh.p.k. (në vlerën 1,900,000 lekë)

2.17 Në DIPP-në e vitit 2003, subjekti ka deklaruar: “*Bingo ‘***’ pronë e bashkëshortit të cilat i janë dhënë me qira Bingos ***, vlera 4,000,000 lekë, adresa lagjja ‘***’, Fier. Blerë nga të ardhurat në disa vjet punë dhe emigracion deri në vitin 1995 (dhjetor) dhe nga kjo periudhë në sektorin privat*”.

2.18 Në DIPP-në e vitit 2005, shtetasi A.Sh. ka deklaruar se: “*Aparaturat e Bingos të blerë në vitin 1999 nga ‘***’ sh.p.k., me vlerë 4,000,000 lekë (50% e vlerës e shlyer pas 1 viti garanci), shitur në vitin 2005 ‘***’ sh.p.k., P. me administrator z. R.B. me vlerë 1,900,000 lekë (50% e vlerës e likuiduar pas 6 muajve të garancisë). Pjesa që zotëron: 100%*”. Gjithashtu, ka deklaruar: “*Shitje pjesë kapitali të shoqërisë ‘***’ sh.p.k., vlera 1,900,000 lekë*”.

³⁰Mandatarkëtimi nr. ***, datë 18.6.2006, nga shoqëria “****” sh.p.k.

³¹Deklaratë noteriale nr. ***, datë 13.4.2007.

³²Deklaratë noteriale³² nr. ***, datë 13.4.2007.

³³Deklaratë noteriale nr. ***, datë 28.3.2019.

³⁴Ky mandat është paraqitur edhe në deklaratën *Vetting*.

(në seksionin e pasurive, në deklaratë) dhe të ardhura nga shitja e një pjesë të kapitalit të shoqërisë “***” sh.p.k., vlera 1,900,000 lekë” (në seksionin e të ardhurave, në deklaratë).

2.19 Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 9.2.2016, subjekti ka sqaruar se, si burim i shumës 4,000,000 lekë me të cilat janë blerë pajisjet bingo, kanë shërbyer të ardhurat nga emigracioni dhe më pas të ardhurat nga puna e tij si menaxher në disa bingo në Lushnjë dhe tre bingo në Fier, konkretisht “****” dhe “****”. Bashkëlidhur, subjekti ka paraqitur këto akte: (i) kontratë shitblerje nr. ***, datë 8.10.2000³⁵, ku shitësi shoqëria “****” Pogradec me administrator Sh.B., i shet blerësit A.Sh., Bington “****” me vlerë 4,000,000 lekë, likuiduar jashtë zyrës së noterisë; (ii) akte zhdoganimi nr. *** dhe nr. **, datë 20.1.1998, sipas të cilave “****” sh.p.k. zhdoganon për llogari të saj, aparatura (1 copë mbajtëse sferash bingoje, 1 tabelë informacioni elektrike, secila nga 1,300 USD), për aktivitetin bingo me vlerë blerjeje 2,600 USD dhe vlerë zhdoganimi 98,315 lekë.

2.20 Sa më lart, rezulton se ka mospërputhje midis DIPP-së së vitit 2005, ku z. A.Sh. deklaroi *aparaturat e bingos të blerë në vitin 1999 në vlerën 4,000,000 lekë nga “***” sh.p.k.* dhe kontratës shitblerje³⁶, sipas të cilës shitësi shoqëria “****” Pogradec sh.p.k., i shet blerësit A.Sh., bington “****”, në vlerën 4,000,000 lekë.

2.21 Me anë të pyetësorit nr. 2³⁷, Komisioni i kërkoi subjektit: (i) të shpjegojë nëse nëpërmjet transaksioneve të kryera nga bashkëshorti i saj janë blerë dhe shitur vetëm pajisjet e bingos apo edhe vetë aktiviteti si bingo; (ii) të paraqesë dokumentacion ligjor për të provuar të ardhurat në vlerën 1,900,000 lekë të përfituara nga shitja e aparaturave në vitin 2005; (iii) të shoqërojë shpjegimet me dokumentacionin ligjor të nevojshëm.

2.22 Në përgjigje subjekti ka shpjeguar se bashkëshorti me kontratën e datës 8.10.2000³⁸ ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k., aparatura bingo në vlerën 4,000,000 lekë. Këto aparaturat iu shitën në vlerën 1,900,000 lekë shoqërisë “****” sh.p.k., me administrator R.B. dhe për të provuar këtë ka paraqitur deklaratën noteriale³⁹ të shtetasit R.B., i cili deklaroi se me cilësinë e administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k., në vitin 2005 i ka blerë shtetasit A.Sh. aparatura lojërash fati (bingo) me shumën 1,900,000 lekë që ia ka likuiduar me këste brenda vitit 2005 pa akt noterial, meqë ishin në mirëbesim me njëri-tjetrin.

2.23 Komisioni hetoi për ndonjë situatë konflikti interesi midis subjektit dhe shtetasit R.B., por nga hetimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë⁴⁰.

2.24 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve⁴¹ dhe QKB-ja⁴² nuk konfirmojnë regjistrimin e shoqërisë “****” si aktivitet i shtetasit A.Sh. dhe duke qenë se subjekti nuk provoi me dokumentacion ligjor justifikues kryerjen e transaksionit të shitjes (të kapitalit dhe pajisjeve, referuar deklaratimeve në DIPP e vitit 2005) dhe vlerën e përfutur nga ky transaksion, Komisioni nuk i konsideroi këto të ardhura në analizën financiare (në relacionin mbi rezultatet e hetimit kryesisht).

2.25 Për sa i përket burimit të shumës 4,000,000 lekë që ka shërbyer për blerjen e bingos, Komisioni analizoi të ardhurat e deklaruara në deklaratën Vetting në shumën 7,100,000 lekë. Subjekti ka deklaruar në deklaratën Vetting se: “Bashkëshorti ka punuar në emigracion në

³⁵Kontratë shitblerje nr. ***, datë 8.10.2000.

³⁶Kontratë shitblerje nr. ***, datë 8.10.2000.

³⁷E-mail, datë 6.8.2021.

³⁸Kontratë nr. ***, datë 8.10.2000.

³⁹Deklaratë noteriale nr. ***, datë 11.6.2021.

⁴⁰Sipas shkresës nr. *** prot., datë 18.10.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

⁴¹Shkresë nr. *** prot., datë 3.2.2021, e DRT-së.

⁴²Shkresë nr. ***, datë 3.2.2021, e QKB-së.

Greqi në vitet 1994 – 1996 dhe 1998, ka punuar në të zezë si pjesa më e madhe e emigrantëve. Të ardhura nga emigracioni dhe nga puna si menaxher në disa bingo në Lushnjë dhe Fier, vlera 7,100,000 lekë”.

2.26 Lidhur me të ardhurat nga emigracioni, subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion për të provuar emigrimin apo të ardhurat e përfituara nga emigrimi.

2.27 Referuar dokumentacionit për punësimin e z. A.Sh., në Shqipëri dhe për pagat e përfituara, rezulton se pagat *neto* për periudhën 1992 – 2000 kanë qenë në shumën 459,141 lekë⁴³, kurse për vitet 1994, 1995 dhe periudhën maj 1997 - mars 1999 nuk paraqiten të dhëna. Duke qenë se këto të ardhura janë deklaruar si burim edhe për blerjen e automjetit tip “Land Rover”, ato u përfshinë në analizën financiare, për periudhën 1992-2002, paraqitur në tabelën nr. 5, të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

2.28 Për sa më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën për sa duket se: (i) personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor për të provuar të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e bingos në vlerën 4,000,000 lekë, në vitin 2000 (viti i blerjes sipas kontratës), për të cilat deklaroi si burim punën në emigracion dhe në disa bingo në Shqipëri; (ii) subjekti nuk provon me dokumentacion ligjor regjistrimin e aktivitetit të blerë nga shoqëria “****” sh.p.k., dhe shitjen e tij shoqërisë “****” sh.p.k. dhe, për rrjedhojë, nuk provon të ardhurat në vlerën 1,900,000 lekë që deklaroi se kanë shërbyer për pagesën e kështit të parë të apartamentit me sip.180.3 m²; (iii) subjekti dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën 1,900,000 lekë, për kryerjen e pagesës së kështit të parë për apartamentin.

Qëndrimi i subjektit

2.29 Në prapësime, në lidhje me konkluzionin e parë, subjekti ka shpjeguar se vlera e blerjes së aparaturave bingo është 4,000,000 lekë dhe ka si burim të ardhurat në emigracion dhe ato nga puna e bashkëshortit në disa subjekte në Fier e Lushnjë dhe kërkon të merren në konsideratë informaliteti i lartë dhe aktiviteti i emigrantëve pas vitit 1990, ku e ka burimin edhe shuma 4,000,000 lekë. Më tej, subjekti shpjegon se paratë kanë qenë në sistemin bankar qysh në vitin 2001 para fillimit të detyrës dhe nuk kanë lidhje me detyrën e saj.

2.30 Me *e-mail*-in e datës 21.2.2022, për të provuar të ardhurat e përfituara në emigrim, subjekti ka depozituar vërtetimin, datë 18.2.2022, të shtetasit grek M.S. me cilësinë e administratorit të një biznesi, i cili citon se A.Sh. ka punuar në biznesin e tij në vitet 1994 – 1996 dhe është paguar me pagë ditore 5,000 drahmi dhe 2,500 drahmi për orët jashtë orarit.

2.31 Në lidhje me konkluzionin e dytë, subjekti shpjegon se bashkëshorti i ka blerë aparaturat e bingos si individ, në vlerën 4,000,000 lekë nga shoqëria “****” Pogradec me kontratën e blerjes, datë 8.10.2000, pra, nuk ka blerë biznesin dhe këtë fakt e ka deklaruar në deklaratën për herë të parë të vitit 2003 dhe në DIPP-në e vitit 2005.

2.32 Pas riçeljes së hetimit, subjekti ka depozituar⁴⁴ kontratë shitblerje mjete, datë 8.11.2004⁴⁵, lidhur midis shitësit A.Sh. dhe blerësit shoqërisë “****” sh.a. (përfaqësuar nga administratori R.B.) për shitjen e pajisjeve të bingos (që shitësi i ka blerë sipas kontratës së

⁴³Bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: vërtetim nr. **** prot., datë 25.1.2017, nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier; vërtetim nr. **** prot., datë 20.10.2016, nga DRSSH Fier (saktësuar me përllogaritjet për pagën neto); vërtetim nr. **** prot., datë 25.10.2016, nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier.

⁴⁴Shkresë nr. **** prot., datë 15.2.2022.

⁴⁵Vërtetim njësie me origjinalin nr. **** rep., datë 12.1.2022, i kontratë shitblerje mjete nr. **** rep., datë 8.11.2004.

shitblerjes, datë 8.10.2000, nga shoqëria “***” sh.p.k.) në vlerën 1,900,000 lekë. Pala blerëse deklaroi se nuk ka asnjë pretendim për gjendjen e sendit dhe që e ka likuiduar vlerën tërësisht.

Vlerësimi i Komisionit

2.33 *Për sa i përket të ardhurave nga shitja e Bingos, të cilat nuk ishin konsideruar në analizën financiare në relacionin mbi rezultatet e hetimit kryesisht, Komisioni vendosi t'i përfshijë këto të ardhura në analizën financiare të rishikuar, referuar: (i) deklarimeve të bashkëshortit në DIPP-në e vitit 2005; (ii) paraqitjes së kontratës së shitjes nga subjekti; (iii) si dhe shitjen e pajisjeve në më pak se gjysmën e vlerës me të cilën janë blerë, pra, mos ekzistencën e detyrimit për të paguar tatim mbi fitimin e realizuar.*

2.34 *Lidhur me momentin e përfitimit të këtyre të ardhurave, Komisioni vlerëson se është e pamundur të identifikohet se cili është momenti i saktë i përfitimit të këtyre të ardhurave për sa kohë vetë subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumente dhe shpjegime kontradiktore, pasi: - Nga njëra anë, në deklaratat periodike vjetore dhe përgjatë gjithë hetimit, subjekti ka deklaruar se këto të ardhura janë përfituar në vitin 2005, e mbështetur kjo nga: (i) në DIPP-në e vitit 2005, bashkëshorti i subjektit ka përshkruar tri herë të ardhurat në vlerën 1,900,000 lekë si të përfituara në vitin 2005, ndërsa në DIPP-në e vitit 2004 nuk është kryer asnjë deklaram lidhur me këtë transaksion; dhe (ii) në deklaratën noteriale të paraqitur nga vetë subjekti në pyetësin nr. 2, ku shtetasi R.B. deklaroi se aparatura lojërash fati (bingo) janë blerë në vitin 2005 me shumën 1,900,000 lekë që ia ka likuiduar me këste brenda vitit 2005 pa akt noterial meqë ishin në mirëbesim me njëri-tjetrin.*

- Ndërkohë që, pas riçeljes së hetimit, subjekti i është referuar kontratë së shitblerjes së mjetit, datë 8.11.2004 dhe, po kështu, në seancën e dytë dëgjimore, në përgjigje të pyetjes nga trupi gjykues i Komisionit, subjekti sqaroi se shitblerja nuk është kryer sipas shpjegimeve të bashkëshortit, por mendon ka filluar në nëntor si marrëveshje dhe ka përfunduar e gjithë shumën deri në datën që është bërë pagesa e kështit të parë të apartamentit.

2.35 *Në vijim të sa përshkruar më lart, Komisioni vlerësoi të marrë në konsideratë kontratën e shitblerjes së datës 8.11.2004 dhe t'i referohet përmbajtjes së saj, për sa i përket momentit të përfitimit të të ardhurave (pra, vitit 2004), si i vetmi dokument ligjor që tregon në mënyrë të padyshimtë vullnetin e palëve për kryerjen e këtij veprimi juridik.*

2.36 *Për rrjedhojë, Komisioni paraqiti vlerën 1,900,000 lekë në analizën financiare të vitit 2004. Lidhur me përdorimin e kësaj vlere si burim për pagesën e kështit të datës 16.4.2005, Komisioni vlerëson se përderisa në DIPP-në e vitit 2004, subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë deklaruar kursime në formën e likuiditetit *cash* jashtë sistemit bankar, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, atëherë vlera prej 1,900,000 lekësh prezumohet e shpenzuar dhe nuk mund të ketë shërbyer si burim për pagesën e kështit prej 2,500,000 lekësh.*

2.37 *Pavarësisht sa më lart, Komisioni analizoi edhe skenarin tjetër, sipas të cilit të ardhurat nga shitja e bingos do të ishin përfituar në vitin 2005, si në vijim:*

2.38 *Në DIPP-në e vitit 2005, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar se 50% e vlerës është likuiduar pas 6 muajve të garancisë dhe, po kështu, edhe shtetasi R.B. ka deklaruar⁴⁶ se shumën 1,900,000 lekë, që ia ka likuiduar me këste brenda vitit 2005, çka do të thotë vlerat prej 950,000 lekësh⁴⁷ të ardhura, janë përfituar me 6 muaj diferencë nga njëra-tjetra.*

⁴⁶Deklaratë noteriale nr. ***, datë 11.6.2021.

⁴⁷Vlera 1,900,000 lekë pjesëtuar me dy.

2.39 Edhe në skenarin më favorizues për subjektin, ai i arkëtimit të pjesës së parë prej 950,000 lekësh, në periudhën 1.1.2005 – 16.4.2005⁴⁸, sërish subjekti dhe personat të lidhur do të gjendeshin në kushtet e mungesës së vlerës prej 950,000 lekësh për pagesën e kështit.

2.40 *Për sa i përket të ardhurave të përfituara në emigracion, Komisioni vlerëson se vërtetimi, datë 18.2.2022, nuk mund të provojë të ardhurat e përfituara për sa kohë nuk provohet pagesa e tyre me dokument financiar dhe as pagimi i detyrimeve tatimore për këto të ardhura, kështu që në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 19 të ligjit nr. 84/2016, këto të ardhura nuk konsiderohen të ligjshme dhe në këto kushte ato nuk u përfshinë në analizën financiare. Gjithashtu, subjekti nuk arriti të provojë pamundësinë objektive për të disponuar dokumentet që justifikojnë të ardhurat nga emigracioni, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.*

2.41 **Në përfundim, personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor për të provuar të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e bingos në vlerën 4,000,000 lekë në vitin 2000 (viti i blerjes sipas kontratës), për të cilat deklaroi si burim punën në emigracion dhe në disa bingo në Shqipëri dhe, për rrjedhojë, ka mungesë burimesh të ligjshme financiare për blerjen e aparaturave në vitin 2000, duke u gjendur në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm, sipas parashikimeve të pikës 5/b, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.**

2.42 *Lidhur me ushtrimin e aktivitetit tregtar të shoqërisë “****”*

2.43 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve⁴⁹ dhe QKB-ja⁵⁰ nuk konfirmojnë regjistrimin e kësaj shoqërie.

2.44 Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, datë 9.2.2016, subjekti ka paraqitur: (i) shkresën nr. *** prot., datë 8.2.2016, e DRT-së Fier që konfirmon se Bingo “****” nuk figuron e regjistruar në DRT-së Fier; (ii) dokument emërimi në detyrë, nga “****” sh.a., datë 6.12.2002, sipas të cilit kjo shoqëri për ushtrimin e aktivitetit të saj, administron në Fier sallën ish “****”, në lagjen “****” dhe emëron në detyrë si përgjegjës zj. L.N.; (iii) vërtetim nr. *** prot., datë 17.9.2002, nga Drejtoria e Tatim Taksave sipas së cilës shoqëria “****” sh.a. zgjeron aktivitetin me sallë bingo në adresën ish “****” Fier dhe i kërkon Degës Fier të konfirmojë fillimin e aktivitetit të kësaj salle.

2.45 Me anë të pyetësorit nr. 2⁵¹, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë dokumentacion ligjor për të provuar regjistrimin e shoqërisë “****” në gjykatë dhe në organet tatimore, statusin e bashkëshortit të subjektit si ortak i kësaj shoqërie, fitimin e realizuar, ndër vite, si dhe të shpjegojë dhe të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues lidhur me marrëdhënien e biznesit midis “****” sh.a. dhe “****”.

2.46 Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar se: *“Në vitin 2001 aparaturat e bingos iu dhanë me qira shoqërisë ‘****’ sh.a. deri në dhjetor 2003, ashtu siç është shënuar në DPV e vitit 2003, në formularin *** ku theksohet ‘këto aparatura i janë dhënë me qira Bingo ***’. Në vitin 2001 - dhjetor 2002, qiraja mujore ishte 300,000 lekë dhe janar-dhjetor 2003 me qira mujore 150,000 lekë. Të ardhurat e marra nga qiraja u përdorën gjatë aktivitetit të ‘****’. Bashkëshorti kishte deklaruar ‘****’ dhe në DPV-në e vitit 2003 kemi deklaruar gabimisht llogaritë e personit juridik. Kjo ka ndodhur për shkak se ishin vitet e para të deklarimit”.*

⁴⁸Data e likudimit të kështit të parë të apartamentit.

⁴⁹Shkresë nr. *** prot., datë 3.2.2021, e DRT-së.

⁵⁰Shkresë nr. *** prot., datë 3.2.2021, e QKB-së.

⁵¹E-mail, datë 6.8.2021.

2.47 Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti ka depozituar: (i) deklaratën noteriale⁵², ku deklaruesi A.M.deklaron se ka qenë administrator i shoqërisë “****” sh.a., që ka ushtruar aktivitetin me objekt “Lojëra fati”. Pajisjet e bingos ishin në pronësi të A.Sh. dhe shoqëria i ka marrë me qira në vlerën 300,000 lekë/muaj nga shkurti 2001 – dhjetor 2002, kurse nga janar 2003 – dhjetor 2003 qiraja ka qenë 150,000 lekë. Pagesa për vitin 2001 u bë totalisht në fillim të kontratës për gjithë vitin në masën 3,000,000 lekë me para në dorë (*cash*). Shoqëria ka paguar detyrimet tatimore për marrjen me qira të këtyre pajisjeve; (ii) shkresën përcjellëse nr. *** prot., datë 14.7.2021, nga DR Tatimore Fier, sipas së cilës në DRT-n` Fier rezulton i regjistruar tatimpaguesi “****” sh.a., me NIPT *** me administrator L.N. me aktivitet “Aktivitete të lojërave të fatit dhe basteve”, me adresë, lagjja “****”, Fier, e regjistruar në datën 9.12.2002 dhe çregjistruar në datë 5.2.2004; (iii) shkresën nr. *** prot., datë 4.9.2002, nga Drejtoria e Lojërave të Fatit që konfirmon se shoqëria “****” sh.a. e licensuar me lejen nr. ***, datë 24.6.2002, ka plotësuar detyrimin për hapjen e një salle bingo në Fier; (iv) shkresa nr. *** prot., datë 9.12.2002, nga DR Tatimeve Fier që vërteton se “****” përfaqësuar nga znj. L.N. për filialin në lagjen “****”, Fier, ka paguar detyrimet e sigurimeve shoqërore për vitin 2001 dhe u regjistrua në organet e sigurimeve shoqërore për vitin 2002; (v) vendim nr. ***, datë 12.2.2001, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për regjistrimin e shoqërisë “****” sh.a. si person juridik, me drejtor A.M., objekt veprimtarie lojëra fati; (vi) akt themelimi dhe statuti i shoqërisë “****” sh.a. ku rezulton aksioner i vetëm D.M. (në këto akte nuk rezulton që A.Sh. të jetë drejtor, anëtar i këshillit mbikëqyrës apo aksioner i shoqërisë); (vii) Nipti i shoqërisë “****” sh.a. *** me seli bulevardi “****”, “****”, Tiranë; (viii) vërtetim nr. ***, datë 17.9.2002, nga Drejtoria Tatim Taksave dhe dokument emërimi i zj. L.N. në detyrë nga “****” sh.a., datë 6.12.2002 (si në dosjen e ILDKPKI-së më lart).

2.48 Në pyetësin nr. 5, Komisioni i kërkoi subjektin të shpjegojë: (i) në cilat periudha dhe në çfarë vlerash janë investuar te shoqëria “****” këto të ardhura?; (ii) të provojë pagesat e detyrimeve tatimore të kryera nga bashkëshorti i saj, për të ardhurat e realizuara nga qiraja e pajisjeve të bingos.

2.49 Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar se: (i) me vendim gjyqësor⁵³ bashkëshorti A.Sh. ka regjistruar si person fizik “Agjenci informacioni dhe shërbimesh”. Është regjistruar në Degën e Tatim Taksave Fier. Pas regjistrimit në organin tatimor, ka aplikuar në Entin Rregullator të Telekomunikacioneve (ERT sot AKEP) për ofrimin e shërbimit internet. Për ngritjen e këtij aktiviteti bashkëshorti ka depozituar në “F. Bank”, shumën 6,000,000 lekë, dokumentacioni i paraqitur në ERT për marrjen e licencës për ngritjen e aktivitetit “****” dhe është pajisur me licence nr. ***, datë 1.6.2001. Pas pajisjes me këtë licencë, bashkëshorti ka tërhequr përsëri nga banka shumën dhe është investuar tek “****” shuma 3,100,000 lekë. Deri në nëntor të vitit 2011 që bashkëshorti ka ngritur aktivitetin “****”, ka ushtruar veprimtarinë në qytetin Fier të regjistruar në Degën e Tatim Taksave Fier. Bashkëlidhur përgjigjes, subjekti ka depozituar vendimin gjyqësor për regjistrim si person fizik, aplikimin për licencë dhe licencat nga ERT për “****” sh.p.k., certifikatë regjistrimi tatimor; (ii) pagesat e detyrimeve tatimore të kryera për të ardhurat e realizuara nga qiraja e pajisjeve të bingos, sipas shpjegimeve të bashkëshortit, janë marrë përsipër nga shoqëria “****” sh.a.

2.50 Bashkëlidhur përgjigjes, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale⁵⁴, ku sipas subjektit shoqëria “****” sh.a. ka paguar detyrimet tatimore për marrjen me qira të këtyre pajisjeve.

⁵²Deklaratë noteriale nr. ***, datë 28.8.2021, e z. A.M.

⁵³Vendimi nr. ***, datë 20.3.2001, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

⁵⁴Deklaratë noteriale nr. ***, datë 28.8.2021, të deklaruesit A.M., i cili deklaron se: “Pajisjet e Bingos ishin në pronësi të A.Sh. dhe shoqëria i ka marrë me qira në vlerën 300,000 lekë/muaj nga shkurti 2001 – dhjetor 2002, kurse nga janar 2003 – dhjetor 2003, qiraja ka qenë 150,000 lekë. Pagesa për vitin 2001 u bë totalisht në fillim të kontratës për gjithë vitin në masën 3,000,000 lekë me para në dorë. Shoqëria ka paguar detyrimet tatimore për marrjen me qira të këtyre pajisjeve”.

2.51 Duke qenë se nuk u provua me dokumentacion ligjor marrëdhënia e qirasë dhe pagesa e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat nga qiraja e pajisjeve të bingos, të deklaruar si të paguara nëpërmjet shoqërisë “****” sh.a., ato nuk u përfshinë si të ardhura individuale të personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit. Nga ana tjetër, subjekti ka deklaruar se të ardhurat e përfituara nga qiraja janë përdorur gjatë aktivitetit të “****” dhe, për këtë arsye, Komisioni pasqyroj si shpenzim në vitin 2001 shumën 3,300,000 lekë (*parapagimi në shkurt 2001 për periudhën shkurt 2001- nëntor 2001, si dhe 300,000 lekë për dhjetor 2001*), në vitin 2002 shumën 3,600,000 lekë (*vlera 300,000 lekë në muaj, e përfituar gjatë janar – dhjetor 2002*) dhe për shumën 1,800,000 lekë (*vlera 150,000 lekë në muaj, e përfituar gjatë janar – dhjetor 2003*).

2.52 Komisioni hetoi për ndonjë situatë konflikti interesi midis subjektit dhe shtetasit A.M., por nuk rezultoi të ketë ndonjë situatë të tillë midis tyre⁵⁵.

Komisioni bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i kaloi subjektit barrën e provës për të dhënë argumentet shoqëruar me provat shkresore, në lidhje me sa duket se: (i) nuk provohet ushtrimi i aktivitetit tregtar nga “****”; (ii) nuk provohet me dokumentacion ligjor marrëdhënia e qirasë dhe pagesa e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat nga qiraja e pajisjeve.

Qëndrimi i subjektit

2.53 Subjekti nuk ka dhënë shpjegime dhe nuk provoi ushtrimin e aktivitetit tregtar nga “****”.

2.54 Subjekti ka kundërshtuar konstatimin e dytë, duke ju përmbajtur plotësisht deklaratës noteriale nr. ***, datë 28.8.2021, të administratorit të shoqërisë “****” sh.a., A.M. të depozituar gjatë hetimit dhe ka depozituar si prova të njëjtin dokumentacionin që ka depozituar gjatë hetimit. Subjekti ka depozituar edhe deklaratën noteriale nr. ***, datë 8.11.2021, të deklarueses L.N. ish-punonjëse e shoqërisë “****” sh.a., e cila jo vetëm është depozituar për herë të parë pas rezultateve të hetimit, por as nuk provon aktivitetin tregtar të “****”. Gjithashtu, subjekti i referohet vendimit nr. 14/2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit lidhur me detyrimin e personave juridikë në cilësinë e qiramarrësve, për të llogaritur detyrimin tatimor mbi të ardhurat nga qiraja që realizojnë qiramarrësit, për ta mbajtur në burim dhe për ta paguar në buxhetin e shtetit.

2.55 Gjithashtu, me *e-mail-in* e datës 25.2.2022, subjekti ka përcjellë një opinion nga kontabël i miratuar/E.K., lidhur me interpretimin për të ardhurat nga qiraja e pajisjeve të bingos. Konkretisht në këtë opinion citohet se bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, nenet 33 dhe 35, si dhe bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 5, pika c, sipas të cilit *e drejta për llogaritjen, mbajtjen dhe pagesën e tatimit në burim për qiratë, i takon personit ose subjektit që kryen aktivitet tatimor në atë godinë ose me atë makineri, mjet apo pajisje që lëshohet me qira, që në rastin konkret është qiramarrësi. Çka do të thotë që pavarësisht Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë për kontratat e qirasë, të drejtën dhe detyrimin për pagesën e tatimit të qirasë e ka subjekti që kryen aktivitet tregtar në atë ambient apo me atë makineri, pajisje, mjet etj.*

Vlerësimi i Komisionit

2.56 Në analizë të dokumentacionit të paraqitur, Komisioni vlerëson që të ardhurat e pretenduara nga dhënia e qirasë së pajisjeve të mos konsiderohen në analizën financiare si burim për kryerjen e investimeve/shpenzimeve për biznesin e bashkëshortit.

⁵⁵Sipas shkresës nr. *** prot., datë 18.10.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gyqësor Fier.

2.57 *Së pari*, nuk ka dokument ligjor (kontratë qiraje) që të vërtetojë ekzistencën e marrëdhënies së qirasë ndërmjet palëve për periudhën shkurt 2001 – dhjetor 2003 (në paragrafin e fundit të nenit 803 të Kodit Civil, përcaktohet se kontrata e qirasë, për një kohë më të gjatë se një vit, duhet bërë me shkresë).

Edhe në rast se kjo marrëdhënie ka ekzistuar, nuk mund të ketë filluar në shkurt 2001, siç pretendon subjekti. Referuar dokumentacionit⁵⁶ të paraqitur nga subjekti, shoqëria “****” sh.a. është regjistruar si person juridik me vendim gjykate në shkurt 2001, por në organet tatimore është regjistruar në muajin korrik 2002, referuar certifikatës së regjistrimit në organin tatimor nr. ***.

Po kështu, shoqëria “****” sh.a. e ka filluar ligjërisht aktivitetin në qytetin e Fierit në shtator 2002, referuar njoftimit të datës 9.12.2002, drejtuar zyrës së Tatim Taksave Tiranë nga degës së Tatim Taksave Fier, ku kjo e fundit konfirmon regjistrimin e filialit Fier të shoqërisë “****” sh.a.

2.58 *Së dyti*, nuk u provua pagesa e detyrimeve tatimore për asnjërën prej periudhave të pretenduara nga subjekti. Vërtetimi i bashkëlidhur dokumentacionit të përcjellë nga DRT-ja Fier⁵⁷, citon pagesën e tatimit të qirasë me shtetasin F.K. që mund të jetë pronari i objektit të dhënë me qira dhe jo me bashkëshortin e subjektit. Gjithashtu, DR Tatimore Fier⁵⁸ nuk disponon të dhëna për tatimin në burim për vitin 2001,2003, për subjektin “****” sh.a., me NIPT ***, i regjistruar si filial pranë DR Tatimore Fier me vendim gjykate nr. ***, datë 12.02.2001, me nr. *** prot., datë 9.12.2002.

2.59 *Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti: (i) nuk provon ushtrimin e aktivitetit tregtar nga “****”; (ii) nuk provon me dokumentacion ligjor marrëdhënien e qirasë dhe pagesën e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat nga qiraja e pajisjeve, duke u gjendur në kundërshtim me parashikimet e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.*

*Lidhur me ushtrimin e aktivitetit tregtar të shoqërisë “****” sh.p.k.*

2.60 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, shkresën⁵⁹ e DRT-së Fier, sipas së cilës shtetasi A.Sh. është përfaqësues i shoqërisë “****” sh.p.k., me NIPT ***, regjistruar në datën 13.11.2002, me status pasiv në datën 16.4.2010. Në DIPP-në e vitit 2006, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: *“Të ardhura nga subjekti ‘***’ sh.p.k. regjistruar në emrin tim në DDTK Fier. Vlera: 150,000 lekë”*.

2.61 **QKB-ja**⁶⁰ konfirmon se me vendimin⁶¹ e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është regjistruar shoqëria “****” sh.p.k. me seli në Fier, me ortak të vetëm dhe përfaqësues ligjor H.Sh. Me vendim gjyqësor⁶² është ndërruar emri i kësaj shoqërie në “****” sh.p.k. dhe është shtuar objekti i veprimtarisë. Me emrin “****” sh.p.k. dhe me të njëjtin përfaqësues ligjor H.Sh. rezultojnë dy shoqëri; njëra me NIPT *** dhe seli Qafa e Pazarit-Gj. dhe tjetra me NIPT *** dhe seli lagjja “****”, Fier, por meqë këto nuk kanë kryer plotësim të dhënash, QKB-ja nuk konfirmon dot nëse këto dy shoqëri janë regjistruar mbi bazën e vendimit gjyqësor të

⁵⁶Shkresë nr. *** prot., datë 14.7.2001, nga DRT-ja Fier, drejtuar znj. L.N., paraqitur nga subjekti i rivlerësimit.

⁵⁷Shkresë nr. *** prot., datë 14.7.2001, nga DRT-ja Fier drejtuar znj. L.N., paraqitur nga subjekti i rivlerësimit.

⁵⁸Shkresë nr. *** prot., datë 31.01.2022.

⁵⁹Shkresë nr. *** prot., datë 20.10.2016, e DRT-së Fier.

⁶⁰Shkresë nr. *** prot., datë 3.2.2021, e QKB-së.

⁶¹Vendimi nr. ***, datë 23.10.2002, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁶²Vendimi nr. ***, datë 12.1.2005, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

mësipërm ose jo. Sipas ekstraktit të regjistrimit, datë 2.2.2021, të dy shoqëritë figurojnë me status “Aktiv”.

2.62 Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka paraqitur: (a) vërtetim⁶³ nga Drejtoria Rajonale Tatimore (DRT) Fier, ku konfirmohen këto të dhëna: (i) për vitin 2002 të ardhura në shumën 2,844,729 lekë dhe nuk pasqyrohet as fitim dhe as humbje; (ii) për vitin 2003 qarkullim 1,294,780 lekë dhe humbje -1,071,456 lekë; (iii) për vitin 2004 qarkullim 1,622,205 lekë dhe humbje -1,508,503 lekë; (iv) për vitin 2005 qarkullim 4,487,277 lekë dhe fitim para tatimit 1,474,590 lekë; (v) për vitin 2006 qarkullim 1,396,333 lekë dhe fitim para tatimit 111,957 lekë; (vi) për vitin 2007 qarkullim 1,178,080 lekë dhe fitim para tatimit 67,353 lekë; (vii) për vitin 2008 të ardhura në shumën 690,300 lekë dhe nuk pasqyrohet as fitim dhe as humbje; dhe (viii) për vitin 2009 dhe 2010 nuk pasqyrohen të ardhura. Gjithashtu, në vijim konfirmohet se ky subjekt tregtar nuk ka shpërndarë dividend: (b) vërtetimin⁶⁴ nga DRT-ja Fier që konfirmon identitetin e personit juridik “****” sh.p.k., regjistruar pranë DRT-ja Fier me aktivitet në fushën informatike dhe të tjera të lidhura me to.

2.63 Për sa më lart, duket se nuk provohet shpërndarja e dividendit dhe, për rrjedhojë, as përfitimi i të ardhurave nga ushtrimi i aktivitetit tregtar i shoqërisë “****” sh.p.k.

2.64 Lidhur me investimin fillestar për këtë shoqëri, konstatohet se në DIPP-në e vitit 2003 personi i lidhur/A.Sh. ka deklaruar: “ ****’ sh.p.k., vlera 3,100,000 lekë, regjistruar në dhjetor të vitit 2002, në emër të A.Sh., me adresë lagjja ‘****’ pranë Prefekturës Fier. Burim krijimi: kursimet familjare, të ardhurat vjetore 70,000 lekë”.

2.65 Me procesverbalin, datë 9.2.2016, subjekti është pyetur nga ILDKPKI-ja⁶⁵ se çfarë nënkupton vlera 3,100,000 dhe deri kur e ka ushtruar këtë aktivitet. Subjekti ka shpjeguar se: “Shuma 3,100,000 është vlera e blerjes së pajisjeve kompjuterike për firmën ‘****’ sh.p.k. Burimi i kësaj vlere janë të ardhurat nga emigracioni i bashkëshortit në Greqi ku ai ka punuar në të zezë. Firma është hapur në vitin 2001 dhe ka zhvilluar aktivitetin deri në vitin 2010”.

2.66 Bashkëlidhur shpjegimeve subjekti ka depozituar dokumentacion që vërteton regjistrimin e këtij aktiviteti në organet tatimore⁶⁶.

2.67 Sa më lart, rezulton se për burimin e krijimit të aktivitetit “****” sh.p.k., në DIPP e vitit 2003, personi i lidhur ka deklaruar kursime familjare, kurse në procesverbalin e datës 9.2.2016, në ILDKPKI, subjekti ka deklaruar të ardhurat nga emigracioni i bashkëshortit në Greqi, ku ka punuar në të zezë. Për këtë mospërputhje, ju kërkuan shpjegime subjektit në pyetësorin nr. 3. Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar se ky aktivitet është ngritur me kursime familjare dhe të ardhurat e bashkëshortit nga emigracioni informal, por mospërputhja ka ndodhur nga koha e gjatë që nga deklarimi nga bashkëshorti në vitin 2003 deri në momentin e deklarimit të subjektit në ILDKPKI.

2.68 Komisioni bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenet Ç e D të Aneksit Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i kaloi subjektit barrën e provës për sa duket se: (i)

⁶³Vërtetimin nr. ****, datë 20.10.2016, nga DRT-ja Fier.

⁶⁴Vërtetimin nr. ****, datë 16.4.2007, nga DRT-ja Fier.

⁶⁵Dërguar pranë Komisionit me shkresën nr. **** datë 3.2.2021 të ILDKPKI

⁶⁶Dokumentacioni i depozituar: licencë nr. ****, datë 1.6.2001, të ofrimit të shërbimit internet nga “****” sh.p.k., Fier; vendim për regjistrimin si person juridik të “****”, Fier, me ortak të vetëm dhe administrator H.Sh.; vërtetim nga DPT-ja Fier, sipas të cilit personi juridik “****” sh.p.k. është regjistruar me seli në Fier, lagjja “****” dhe ushtron aktivitet privat në fushën “aktivitete informatike dhe aktivitete të lidhura me to”; certifikatë regjistrimi tatimor e kësaj shoqërie tregtare sipas së cilës “****” sh.p.k. është regjistruar në organet tatimore në datën 13.11.2002; nipti i “****” sh.p.k. ****; licencën⁶⁶ e ofrimit të shërbimit Internet nga “****” sh.p.k., si dhe ISP-ja rajonale në Gjirokastër, Tepelenë, etj.

subjekti nuk provon me dokumentacion ligjor të ardhurat në shumën 600,000 lekë të përfituara nga aktiviteti tregtar, që kanë shërbyer për pagesën e këstit të parë (2,500,000 lekë) të apartamentit me sip. 180.3 m², pasi: nuk provohet ushtrimi i aktivitetit tregtar i shoqërisë “****” dhe fitimi i realizuar; shoqëria “****” sh.p.k. në vitet 2003-2004 rezulton me humbje dhe në vijim nuk ka shpërndarë dividend dhe, për rrjedhojë, ka mungesë të burimeve të ligjshme në vlerën 600,000 lekë, për kryerjen e pagesës së këstit të parë prej 2,500,000 lekësh të apartamentit; (ii) personi i lidhur me subjektin/bashkëshortin nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor provues për të ardhurat e tij nga emigracioni (që vetë subjekti ka pranuar se ka qenë informal), që kanë shërbyer për blerjen e pajisjeve kompjuterike të “****” sh.p.k., në vlerën 3,100,000 lekë; (iii) në përfundim, subjekti dhe personat e lidhur kanë mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 2,500,000 lekë, për pagesën e këstit të parë, duke u ndodhur kështu në kushtet e pikave 5/a, 5/b, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

2.69 Me e-mail-in e datës 25.2.2022, subjekti ka përcjellë në Komision një interpretim të të ardhurave të aktivitetit të shoqërisë “****” sh.p.k. në pronësi të bashkëshortit të saj, nga kontabël i miratuar, z. E.K.

2.70 Konkretisht në këtë dokument citohet se: *“Të ardhurat monetare të siguruara nga aktiviteti i ‘****’ sh.p.k. që nga fillimi i zhvillimit të biznesit e në vazhdim deri në vitin 2006 janë arkëtuar në një nga llogaritë personale të bashkëshortit. Arsyeja e përdorimit të kësaj llogarie ishte për faktin se aktiviteti i shoqërisë për shkak të xhiros trajtohej nga administrata tatimore si subjekt me përgjegjësi tatimore të statusit person fizik i thjeshtë. Mjetet monetare neto të siguruara nga ky aktivitet, duke qenë se janë arkëtuar në llogarinë personale, familja i ka përdorur ato sipas nevojave që kanë pasur, njëkohësisht edhe ato mjete monetare që ishin papërdorur janë pasqyruar në këto llogari likuiduese personale. Nga statement i bankës së kësaj llogarie likuiduese duken qartë lëvizjet e shtesave të kësaj llogarie janë nga të ardhurat e realizuara nga ky biznes dhe tërheqjet në të shumtat e rasteve janë tërheqje cash nga ana e bashkëshortit, veprime këto që tregojnë qartë që ato janë përdorur nga ana e familjes së Violeta Shkurta”.*

2.71 Gjithashtu, në këtë dokument janë dhënë sqarime lidhur me situatën e fitimeve të realizuara nga subjekti i regjistruar me statusin person fizik i thjeshtë, duke përmendur edhe bazën ligjore përkatëse.

Vlerësimi i Komisionit

2.72 Referuar dokumentacionit të administruar, forma ligjore e shoqërisë “****” sh.p.k., është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, konkretisht në vendimin e gjykatës për formimin e saj.

2.73 Sa më lart, për sa kohë nuk konfirmohet shpërndarja e dividendit, nuk mund të justifikohet fitimi i të ardhurave të ligjshme prej personit të lidhur në kuptim të ligjit “Për të ardhurat personale”. Po kështu, në deklaratën *Vetting* subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë pretenduar të ardhura të fituara nga aktiviteti tregtar, përveçse të ardhurave nga paga si administrator i shoqërisë.

2.74 Lidhur me pretendimin se tërheqjet nga llogaritë bankare në emrin e bashkëshortit si individ (llogari të përdorura në funksion të aktivitetit tregtar), kanë shërbyer për nevojat familjare, Komisioni vlerëson se për sa kohë që subjekti nuk paraqiti asnjë provë për të mbështetur deklarin e tij, nuk mund të konkludohet me siguri mbi destinacionin e përdorimit të fondeve të tërhequra dhe ato supozohet t’i kenë shërbyer aktivitetit tregtar (për pagesat e furnitorëve apo kryerjen e shpenzimeve).

Si përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk provoi të ardhurat e përfituara në vlerën 600,000 lekë nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit, duke u gjendur në kushtet e

një deklarami të pamjaftueshëm sipas parashikimeve të pikës 5/b, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Pagesa e dytë – shuma 800,000 lekë, datë 31.1.2006

2.75 Në dokumentacionin e përcjellë nga “Raiffeisen Bank”⁶⁷, konfirmohet se në datën 31.1.2006 është transferuar shuma 800,000 lekë nga llogaria e subjektit në favor të shoqërisë “***” sh.p.k. me përshkrim “pagesë për shlyerje kësti Violeta Shkurta”.

2.76 Nga analizimi i origjinës së kësaj shume konstatohet se për periudhën 1.4.2005 (data e çeljes së llogarisë bankare) – 31.1.2006 (data e transfertës), në llogarinë e subjektit është kredituar shuma 691,205 lekë nga pagat, nga e cila është tërhequr shuma 49,000 lekë dhe shuma e mbetur prej 642,000 lekësh, së bashku me një *overdraft* prej rreth 158,000 lekësh, kanë shërbyer si burim për pagesën e këstit në vlerën prej 800,000 lekësh.

2.77 Ndërkohë që në procesverbalin e ILDKPKI-së subjekti ka deklaruar: “Në janar të vitit 2006 kam pakësuar llogarinë e pagës në ‘Raiffeisen Bank’, në vlerën 700,000 lekë dhe 100,000 lekë nga bashkëshorti dhe kemi kryer likuidimin e vlerës 800.000 lekë ndaj shoqërisë ‘***’ sh.p.k”.

Lidhur me deklaramin e mësipërm, Komisioni konstaton se mandati bankar i tërheqjes së vlerës 697,000 lekë nga “Raiffeisen Bank” dhe i paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting*, mban datën 17.10.2006, prandaj nuk mund të ketë shërbyer për pagesën e këstit prej 800,000 lekësh për sa kohë që ky këst është paguar në datë 31.1.2006 me transfertë bankare dhe ka origjinë pagat dhe *overdraft*-in dhe jo ndonjë depozitim. Në lidhje me këtë mospërputhje, subjekti ka shpjeguar se të ardhurat nga paga e saj janë përdorur për pagesën e apartamentit. Kalimi i shumës në favor të shoqërisë “***” sh.p.k. është kryer nëpërmjet llogarisë së pagës. Fakti që nuk është thënë shprehimisht ka qenë harresë. Shuma prej 697,000 lekësh është tërhequr prej saj dhe është përdorur 300,000 lekë për mobilim, si dhe për shlyerje kredie dhe për nevoja ushqimore.

2.78 Referuar deklaramit të subjektit se nga tërheqja prej 697,000 lekë, vlera 300,000 lekë është shpenzuar për mobilim, si dhe faktit që në fund të vitit 2006 nuk janë deklaruar likuiditete *cash* jashtë sistemit bankar, nënkupton që këto fonde janë shpenzuar brenda vitit, dhe, për rrjedhojë, vlera prej 300,000 lekësh u paraqit si shpenzim në analizën financiare të vitit 2006. Ndërkohë në pyetësonin standard subjekti ka deklaruar: “Për mobilimin e shtëpisë kam shpenzuar në vitet 2007 – 2009, shumën rreth 300,000 lekë.

Komisioni kreu analizën financiare për vitin 2005, për të verifikuar burimin e ligjshëm të shtesës së likuiditeteve në llogarinë bankare të subjektit që kanë shërbyer për pagesën e këstit në vlerën 800,000 lekë.

Tabela nr. 2 – Analiza financiare për vitin 2005

Përshkrim	Vlera në lekë
Gjendje <i>cash</i> , datë 1.1.2005	0
Gjendje likuiditete në bankë, datë 1.1.2005	19,045
Likuiditete në datën 1.1.2005	19,045
Gjendje <i>cash</i> , datë 31.12.2005	0
Gjendje likuiditete në bankë, datë 31.12.2005	639,989
Likuiditete në datën 31.12.2005	639,989
Të ardhura nga pagat subjekti	872,666
Të ardhura nga pagat bashkëshorti	297,906
Të ardhura nga aktiviteti tregtar bashkëshorti	0
Të ardhura nga shitja e bingos	0

⁶⁷Shkresë nr. *** prot., datë 7.7.2021.

Total të ardhura	1,170,572
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT	438,228
Shpenzime qiraje	60,000
Shpenzime për udhëtime nga sistemi <i>TIMS</i>	300,223
Pagesë kësti i parë për apartamentin	2,500,000
Total shpenzime	3,298,451
Balanca e fondeve (të ardhura + shpenzime - likuiditete në fund + likuiditete në fillim)	-2,748,824

2.79 Komisioni bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016 dhe në Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i kaloi barrën e provës për sa duket se subjekti dhe personat e lidhur me të kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare në vlerën 2,748,824 lekë gjatë vitit 2005, për kryerjen e shpenzimeve, pagesën e apartamentit, si edhe për shtesën e kursimeve në likuiditetet bankare, të cilat kanë shërbyer si burim për kryerjen e pagesës së këstit në vlerën 800,000 lekë.

Qëndrimi i subjektit

2.80 Subjekti e ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit, duke shpjeguar se: në vitin 2005 u shitën pajisjet e “****” te shoqëria “****” sh.p.k., në vlerën 1,900,000 lekë; për vitin 2005 shoqëria “****” sh.p.k. me NIPT *** ka realizuar fitim ushtrimor *neto* në vlerën 1,474,590 lekë; bashkëshorti i subjektit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2005, të ardhura nga filiali “Lloto Sport nr. ****”, i regjistruar në degën e tatimeve për 6 muaj dhe që ushtrohej në një lokal me qira nga shtetasi S.P., Fier, në shumën 600,000 lekë, që duhet të përfshihen në analizën financiare. Subjekti ka pretenduar që Komisioni nuk duhet të përfshinte në analizë financiare, detyrimet ndaj shoqërisë Telekom (në vlerën 400,000 lekë) dhe detyrimet ndaj ERRT-së (në vlerën 150,000 lekë), sepse janë detyrime të shoqërisë “****” sh.p.k. Sipas audituesit ligjor, subjekti pretendon se analiza financiare e vitit 2005 rezulton me balancë pozitive në vlerën 67,777 lekë.

Vlerësimi i Komisionit

2.81 Komisioni vëren se në analizën financiare të pasqyruar në raportin e audituesit ligjor të paraqitur nga subjekti janë konsideruar: (i) të ardhura nga shitja e bingos në vlerën 1,900,000 lekë përkundrejt vlerës 0 (zero) të përlllogaritur nga Komisioni; (ii) të ardhura nga shpërblimi në bingo në vlerën 600,000 lekë, sipas deklarimit në DIPP-në e vitit 2005; (iii) detyrim nga subjekti “****” sh.p.k. tërheqje nga llogaria e subjektit për pagesë agjencinë turistike dhe qiranë e banesës në shumën 315,000 lekë, duke shpjeguar se kjo llogari është individuale, e cila është përdorur nga subjekti dhe në funksion të veprimtarisë së biznesit të tij.

2.82 *Lidhur me të ardhurat nga shitja e bingos në vlerën 1,900,000 lekë*, Komisioni i qëndroi arsyetimit në pikën (i) (paragrafët 2.17 – 2.39).

2.83 *Lidhur me të ardhurat nga filiali “Lloto Sport”, në vlerën 600,000 lekë*, subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor për të provuar këto të ardhura dhe, për rrjedhojë, pretendimi i tij mbetet në nivel deklarativ.

2.84 *Lidhur me pretendimin dhe shpjegimet për sa i përket shumës 315,000 lekë* si detyrim nga subjekti “****” tërheqje nga llogaria e subjektit për pagesë agjencinë turistike dhe qiranë e banesës, subjekti nuk paraqiti dokumentacion për të mbështetur deklaratimet e tij dhe, për rrjedhojë, pretendimi i tij mbeti në nivel deklarativ.

2.85 Në lidhje me deklarin e subjektit se Komisioni ka përlllogaritur edhe detyrimet ndaj shoqërisë “****”, në vlerën 400,000 lekë dhe detyrimin ndaj ERT-së në vlerën 150,000 lekë, ndërkohë që ato nuk duhet të përfshihen pasi janë detyrime të shoqërisë “****” sh.p.k.,

Komisioni thekson se këto detyrime nuk janë përfshirë në analizën financiare të paraqitur në relacionin mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

Për sa më lart, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare në vlerën 2,748,824 lekë gjatë vitit 2005, e përbërë kjo nga vlera 2,500,000 lekë dhe vlera 248,824 lekë për pagesën e apartamentit, si edhe për shtesën e kursimeve dhe kryerjen e shpenzimeve gjatë vitit, duke u gjendur në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 5/b të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

Pagesa e tretë – shuma 4,500,000 lekë, datë 18.6.2006, me burim nga kredia e marrë në BKT

Në deklaratën *Vetting* bashkëshorti i subjekti, A.Sh., ka deklaruar: “*Kredi në BKT, dega Fier, në shumën 4,450,000 lekë, në datën 18.5.2006, me kontratë nr. ***, datë 17.5.2006, me afat 20 vjet, e mbyllur në datën 15.11.2011*”.

2.86 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: (i) kontratë hipotekimi,⁶⁸ datë 17.5.2006, për hipotekimin e apartamentit në pronësi të subjektit dhe bashkëshortit në favor të BKT-së, dega Fier, si garanci për kredinë e marrë në vlerën 4,500,000 lekë, për blerjen e këtij apartamenti; (ii) vërtetimin⁶⁹ nga BKT-ja, sipas të cilit subjekti ka marrë në datën 18.5.2006 vlerën 4,450,000 lekë dhe e ka mbyllur në datën 15.11.2011.

2.87 Nga dokumentacioni i administruar nga BKT-ja⁷⁰, konfirmohet kontratë kredie bankare⁷¹ me kredimarrës Violeta Shkurta, dorëzanës A.Sh., në shumën 4,500,000 lekë për blerjen e një banese, për 20 vjet me normë interesi 9%, për 12 këstet e para dhe më pas me normën 1-vjeçare të bonove të thesarit plus 3,5%. Si kolateral është vendosur apartamenti me sip.180.3 m².

2.88 Referuar lëvizjeve të llogarisë së subjektit⁷², konstatohet se kredia është lëvruar në datën 18.5.2006 dhe po në të njëjtën datë subjekti ka kryer një tërheqje në vlerën 4,423,000 lekë me përshkrim “Violeta Shkurta sa tërheq nga llogaria”.

2.89 Sipas kontratës së shitblerjes⁷³, subjekti dhe personi i lidhur i kanë paguar palës shitëse jashtë zyrës noteriale vlerën 8,460,000 lekë, por bazuar në dokumentacionin e administruar nga BKT-ja, shuma e disbursuar nga kredia është tërhequr nga subjekti në datën 18.5.2006, pra, 1 muaj pas lidhjes së kontratës. Në lidhje me këtë mospërputhje, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se kontrata e shitblerjes së apartamentit me sip.180,5 m² është nënshkruar në datën 18.4.2006, me qëllim që të realizohej marrja e kredisë në BKT-në Fier, për shkak se nuk kishim të ardhura të mjaftueshme për të shlyer apartamentin e porositur. Për të marrë kredi duhej lënë garanci/hipotekë një pasuri e paluajtshme dhe vendosën këtë apartament për të cilin nënshkruan kontratën e shitjes në mirëbesim me shitësin dhe pronësia e apartamentit kaloi në emrin e subjektit dhe të bashkëshortit. Në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së apartamentit ishte kryer pagesa në vitin 2005 në vlerën 2,500,000 lekë, si dhe në janar të vitit 2006, në vlerën 800,000 lekë, me burim kursimet nga paga (nr. llogarie *** “Raiffeisen Bank”, datë 31.1.2006).

⁶⁸Kontratë hipotekimi nr. ***, datë 17.5.2006.

⁶⁹Vërtetim nr. *** prot., datë 23.1.2017, nga BKT-ja.

⁷⁰Shkresë nr. *** prot., datë 19.7.2021, nga BKT-ja.

⁷¹Kontratë kredie bankare nr. ***, datë 17.5.2006.

⁷²Shkresë nr. *** prot., datë 8.2.2021, nga BKT-ja.

⁷³Kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 18.4.2006.

2.90 Komisioni konstaton se subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor që provon shumën dhe datën e pagesës që i ka kryer shitësit me shumën e kredisë së marrë në BKT në vitin 2006 (sipas deklaramentit të subjektit), pra, nuk provohet destinacioni përfundimtar i shumës së tërhequr prej 4,423,000 lekësh.

2.91 Me anë të pyetësorit nr. 2, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë dokumentacion përkatës për të provuar pagesën e këtij kësti. Në përgjigje, subjekti ka depozituar vërtetimin, datë 28.8.2021, të shoqërisë “****” sh.p.k., sipas të cilit konfirmohet pagesa e shumës prej 4,500,000 lekësh me mandatin nr. ***, datë 18.6.2006, të shoqërisë “****” sh.p.k. dhe ka bashkëlidhur këtë mandat.

2.92 Komisioni vëren se mandati nr. ***, datë 18.6.2006, në vlerën 4,500,000 lekë është lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k. pas hartimit të kontratës së shitjes në datën 19.4.2006, ku si palë blerëse janë E. dhe A.Xh., si individë dhe jo si përfaqësues të shoqërisë “****” sh.p.k.

2.93 Referuar ekstraktit historik të shoqërisë “****” sh.p.k., gjeneruar nga faqja zyrtare e internetit të QKB-së, konstatohet se në datën e lëshimit të këtij mandati, shtetasi E.Xh. ishte ortak i kësaj shoqërie me vetëm 50 % të kuotave.

2.94 Sa më lart, nuk provohet se shuma e tërhequr nga BKT-ja (nga lëvrimi i kredisë) prej 4,423,000 lekësh, të ketë shërbyer si burim për pagesën e apartamentit dhe nuk provohet destinacioni i përdorimit së kësaj shume. Për sa kohë që në DIPP-në e vitit 2006 nuk janë deklaruar likuiditete *cash* të disponuara në banesë, shuma 4,423,000 lekë konsiderohet si shpenzim për efekt të analizës financiare.

2.95 Komisioni kreu analizën financiare në vitin 2006 për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit dhe personave të lidhur, të paraqitur në tabelën në vijim (referuar metodikës së kryerjes së analizës financiare detajuar në Aneks 02).

Tabela nr. 3 – Analiza financiare e vitit 2006

Përshkrim	Vlera në lekë
Gjendje <i>cash</i> , datë 1.1.2006	0
Gjendje likuiditete në bankë, datë 1.1.2006	639,989
Likuiditete në datën 1.1.2006	639,989
Gjendje <i>cash</i> , datë 31.12.2006	0
Gjendje likuiditete në bankë, datë 31.12.2006	-2,485
Likuiditete në datën 31.12.2006	-2,485
Kredi BKT, datë 17.5.2006 , në vlerën 4,500,000 lekë	4,500,000
Total detyrime	4,500,000
Të ardhura nga pagat subjekti	863,705
Të ardhura nga pagat bashkëshorti	157,560
Total të ardhura	1,021,265
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT	438,228
Shpenzime qiraje	35,000
Shpenzime për udhëtime nga sistemi <i>TIMS</i>	12,370
Shpenzime për pagesën e kredisë (principal, interesa, shpenzime të tjera)	361,762
Shpenzime për arredim	300,000
Pagesa për apartamentin	5,300,000
Shpenzim shuma e kredisë së tërhequr nga BKT	4,423,000
Total shpenzime	10,870,360
Balanca e fondeve (Të ardhura + detyrime – shpenzime - likuiditete në fund + likuiditete në fillim)	-4,706,621

2.96 Komisioni bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenet Ç dhe D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i kaloi barrën e provës për sa duket se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 4,706,621 lekë, në vitin 2006, për pagesën e apartamentit dhe për kryerjen e shpenzimeve.

Qëndrimi i subjektit

2.97 Subjekti ka dhënë shpjegime se për të marrë kredi duhej lënë garanci/hipotekë një pasuri e paluajtshme dhe meqë nuk kishin pasuri tjetër ranë dakord me shitësin që të realizonin kontratën e shitjes, duke shënuar në mirëbesim shlyerjen e apartamentit me qëllim që të merrej kredia. Shënimi në kontratë i shprehjes “blerësit i kanë paguar palës shitëse jashtë zyrës noteriale, vlerën 8,460,000 lekë” është bërë në funksion të regjistrimit të apartamentit dhe vendosjes së tij si garanci për marrjen e kredisë. Këtë fakt subjekti e ka pasqyruar në DIPP-në e vitit 2007 dhe në deklaratën noteriale⁷⁴, datë 13.4.2007, kurse pagesën e shumës 4,500,000 lekë, subjekti e provon me konfirmimin e znj. A.Xh. në deklaratën noteriale të datës 28.8.2021 dhe me mandatar-këtimin nr. ***, datë 18.6.2006, të depozituara gjatë hetimit administrativ.

2.98 Në vijim, subjekti shpjegon se ka tërhequr shumën 4,423,000 lekë të lëvruar nga kredia në BKT në datë 18.5.2006 dhe po në këtë datë (jo në datë 18.6.2006) ka dorëzuar për llogari të shoqërisë “****” sh.p.k., shumën 4,500,000 lekë. Për këtë arsye, nuk mund të deklaronte likuiditete *cash* në banesë në vitin 2006, sepse e njëjta shumë u përdor për blerjen e apartamentit, prandaj kjo shumë nuk mund të konsiderohet si shpenzim për efekt të analizës financiare.

2.99 Në përfundim, subjekti shpjegon se sipas raportit të audituesit që ka paraqitur, analiza financiare për vitin 2006 del me balancë pozitive në vlerën 151,378 lekë dhe, si rrjedhojë, ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e apartamentit.

Vlerësimi i Komisionit

2.100 Në lidhje me përdorimin e kredisë së marrë pranë BKT-së si burim për blerjen e apartamentit, Komisioni e gjen të bazuar pretendimin e subjektit, duke konsideruar se: (i) në datën 18.5.2006 është kryer tërheqja e vlerës 4,423,000 lekë dhe referuar mandatit të paraqitur në pyetësin nr. 2, po në të njëjtën datë është paguar shuma 4,500,000 lekë pranë shoqërisë “****” sh.p.k.; (ii) apartamenti me sip.180.3 m² është vendosur si kolateral për kredinë e marrë; (iii) objekti i kredisë është “për blerje shtëpie”; (iv) kontrata e shitjes është lidhur në datën 19.4.2006, është regjistruar në ZVRPP-në Fier në datën 16.5.2006 dhe një ditë më pas është lidhur kontrata e kredisë (datë 17.5.2006).

2.101 Për rrjedhojë, Komisioni vlerësoi që të marrë në konsideratë kredinë si burim për blerjen e apartamentit dhe të mos paraqesë vlerën 4,423,000 lekë në analizën financiare në zërin “shpenzim shuma e kredisë së tërhequr nga BKT”.

2.102 Për sa i përket analizës financiare të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, ku pasqyrohen të ardhura nga shpërblimi në “Loto Sport”, në vlerën 480,000 lekë, Komisioni vlerëson se pavarësisht se këto të ardhura janë deklaruar në DIPP-në e vitit 2006, mungon dokumentacioni ligjor për të provuar këto të ardhura dhe, si të tilla, ato nuk mund të konsiderohen në analizën financiare dhe, për rrjedhojë, pretendimi i subjektit mbetet në nivel deklarativ.

Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 283,621 lekë⁷⁵, për kryerjen e shpenzimeve në vitin 2006, duke u gjendur në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm

⁷⁴Deklaratën noteriale nr. ***, datë 13.4.2007.

⁷⁵Balanca negative prej në vlerën 4,706,621 lekë, korrigjuar me reduktimin e vlerës 4,423,000 lekë.

sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 5/b, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me shlyerjen e kredisë ekzistuese me një kredi tjetër me kushte lehtësuese

2.103 Në datën 14.11.2011 kjo kredi është shlyer plotësisht duke paguar pjesën e mbetur prej 4,051,332 lekësh, me burim kredinë me kushte lehtësuese, lëvruar në shumën 3,554,100 lekë (*trajtuar në vijim*) dhe një depozitim në vlerën 520,000 lekë (*me burim huan nga shtetasja A.G., trajtuar në pasurinë e parë*). Subjekti i rivlerësimit, në DIPP-në e vitit 2011 ka deklaruar: “*Në prill 2011 kam përfituar kredi me kushte lehtësuese në shumën 4,404,960 lekë për blerje apartamenti. Kreditë e kam përdorur për të shlyer kredinë e mëparshme që kisha marrë në BKT, dega Fier, në vitin 2006, për të blerë të njëjtin apartament të ndodhur në lagjen ‘***’, Fier. Duke përdorur kredinë e marrë me kushte lehtësuese, e likuidova kredinë e vitit 2006 në datë 15.12.2011. Kredia e re në shumën 3,590,000 lekë ka afat shlyerje 20 vjet, me këst 20,000 lekë/muaj. Kam paguar për kredinë gjithsej 548,000 lekë (për kredinë e vitit 2006)... Gjendja e detyrimit të mbetur pa shlyer deri në datën 31.12.2011 është 4,146,770 lekë”*

2.104 Në deklaratën *Vetting* subjekti dhe bashkëshorti kanë deklaruar: “*Kredi në BKT, dega Fier, përfituar nga Bashkia Fier me kushte lehtësuese, në datën 14.11.2011, në shumën 3,590,000 lekë, me afat shlyerje 20 vjet, me këst mujor 20,000 lekë”*.

2.105 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, vërtetimin⁷⁶ nga BKT-ja, sipas të cilit subjekti ka marrë në datën 14.11.2011, kredi me vlerën 3,590,000 lekë, e cila ka zëvendësuar kredinë e parë prej 4,450,000 lekësh. Kolateral për këtë kredi është pasuria nr. ***, apartamenti me sip. 180,3 m², në Fier.

2.106 Në DIPP-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar: “*Në prill të vitit 2011 kam përfituar nga Bashkia Fier një kredi me kushte lehtësuese në shumën 4,404,960 lekë për blerje apartamenti. Kreditë e kam marrë në BKT, dega Fier. Shuma e kredisë është 3,590,000 lekë, ka afat shlyerje 20 vjet, me këst mujor 20,000 lekë. Paguar për kredinë, për periudhën 1.1.2012 – 31.12.2012, gjithsej shumën 239,889 lekë. Detyrimi i mbetur deri në datën 31.12.2012 është në shumën 3,447,305 lekë”*.

2.107 ILDKPKI-ja ka dërguar⁷⁷ në Komision: (i) kontratën e kredisë⁷⁸ lidhur midis BKT-së dhe kredimarrësve Violeta Shkurta e R.Sh. dhe dorëzanësit A.Sh. për dhënien e kredisë me vlerë 3,590,000 lekë për blerje banese; (ii) kontratë hipotekimi⁷⁹ lidhur midis BKT-së dhe hipotekuesve Violeta Shkurta dhe A.Sh. për hipotekimin e pasurisë nr. ***, apartament me sip.180,3 m², me qëllim garantimin e kredisë në shumën 3.590.000 lekë.

2.108 Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka shpjeguar se në vitin 2011 për shkak të vështirësive ekonomike ka aplikuar në Bashkinë Fier dhe ka përfituar kredi të butë. Kreditë që kishte marrë në vitin 2006, në BKT e ka mbyllur dhe ka vazhduar të shlyejë kredinë e butë që prej vitit 2011, e cila është përdorur për të mbyllur kredinë e mëparshme për të njëjtin apartament.

2.109 Subjekti i ka bashkëlidhur shpjegimeve të tij, ndër të tjera, shkresën⁸⁰ e Bashkisë Fier në lidhje me plotësimin e listës së familjeve të pastreha të miratuara me vendim nr. ***, datë

⁷⁶Vërtetimin nr. *** prot., datë 23.1.2017, nga BKT-ja.

⁷⁷Me shkresën nr. *** prot., datë 3.2.2021.

⁷⁸Kontratën e kredisë nr. ***, datë 8.11.2011.

⁷⁹Kontratën e hipotekimit nr. ***, datë 8.11.2011.

⁸⁰Shkresë nr. *** prot., datë 29.4.2011, nga Bashkia Fier.

1.7.2010, të Këshillit Bashkiak, ku emri i subjektit “Violeta Shkurta” figuron “familje e pastrehë, me sipërfaqe nën normën e strehimit, banon me qira dhe përfiton vlerën maksimale të apartamentit prej 4,404,960 lekësh”. Lista mban vitin 2011.

2.110 Rezulton se në datën 23.2.2011 subjekti ka blerë me privatizim apartamentin me sip. 36.5 m², të cilin e ka lëshuar me qira. Gjithashtu, në datën 9.4.2006 ka blerë apartamentin me sip. 180,3 m². Ndërkohë subjekti ka marrë kredinë lehtësuese me destinacion blerje apartamenti me afat shlyerje 240 muaj, por e ka përdorur për të shlyer kredinë që ka marrë në datën 17.5.2006, e cila ishte me afat shlyerje 20 vjet dhe që subjekti e ka mbyllur në datën 15.11.2011, pra, për 5 vjet, pikërisht, duke përdorur kredinë lehtësuese. Në lidhje me këtë situatë, subjektit i është kërkuar në pyetësonin nr. 2, të paraqesë dokumentacionin e depozituar pranë Bashkisë Fier mbi bazën e të cilit ka përfituar këtë kredi lehtësuese dhe të japë shpjegime mbi statusin nën të cilin e ka përfituar këtë kredi duke bashkëlidhur aktet që kanë miratuar statusin dhe kredinë lehtësuese.

2.111 Në përgjigje të pyetësonit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se Komiteti Ekzekutiv Pluralist i kohës i ka dhënë bashkëshortit A.Sh., dhomën nr. *** për strehim me autorizimin (vendim nr. ***, datë 23.7.1992) të ish-hotel “****”. Kanë pasur në përdorim vetëm një dhomë me përmasa 5 x 5m. Pas lidhjes së martesës, kanë jetuar në këtë dhomë deri në vitin 2002 bashkë me fëmijët. Në vitet 1999 – 2011, Bashkia Fier vazhdimisht ka verifikuar gjendjen e strehimit të familjeve në hotel. Për shkak se sipërfaqja e kësaj dhome ishte e pamjaftueshme për familjen e tyre me 4 persona dhe në vitin 2002 filluan proceset gjyqësore lidhur me pronësinë e kësaj dhome, menduan blerjen e një apartamenti tjetër. Në vitin 2005 porositën një apartament dhe në 2006 morën kredi për blerjen e tij. Në kushte pasigurie për dhomën e ndodhur në ish-hotel “****” (juridikisht vazhonte të ishte në pronësi të bashkisë dhe në përdorim të subjektit) kanë blerë apartamentin që disponojnë aktualisht me kredi bankare. Blerja e këtij apartamenti ishte e domosdoshme, por në kushtet kur kursimet nuk u mundësonin blerjen e apartamentit, aplikuan për kredi në BKT. Në vitet 2007 – 2011 për shkak të disa problemeve bashkëshortore, u gjendën në vështirësi financiare që solli pasiguri dhe vështirësi në shlyerjen e kredisë. Në 2011 kanë aplikuar për kredi të butë⁸¹. Kështu Bashkia rimori në shqyrtim problemin të strehimit bazuar në aplikimin për kredi me kushte lehtësuese, të cilën e konsideroi si vazhdim i procedurës së vitit 1992 dhe miratoi kredinë e butë që jepej në BKT. Gjatë kërkesës për kredi të butë kanë depozituar në Bashki edhe vërtetimin hipotekor të ZVRPP-së Fier që vërteton se zj. Violeta Shkurta ka të regjistruar në nr. hipotekor ***, datë 16.5.2006, pasurinë apartament me nr. ***, me sip. 180,3 m² në z. k. ***, lagjja “****”, Fier dhe se pasuria është inskriptuar në favor të BKT me nr. inskriptimi ***, datë 18.5.2006. Banka ofroi si mundësi zëvendësimin e kredisë për të njëjtin apartament.

2.112 Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti ka depozituar dosjen e kredisë⁸² të përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 1.7.2021, të Bashkisë Fier, e cila përmban: kërkesën e subjektit për strehim; certifikatë familjare të shtetasit A.Sh., datë 22.4.2011 (4 anëtarë); vërtetim, datë 4.3.2011, nga Prokuroria Rrethit Fier për pagën e subjektit; vërtetim datë __. __2011 (pa datë, por vetëm viti 2011) nga ZVRPP-ja Fier, sipas të cilit subjekti ka të regjistruar në emër të saj dhe bashkëshortit apartamentin me sip.180,3 m², pasuri e transkriptuar në favor të BKT-së me nr.inskripti ***, datë 18.5.2006; certifikatë familjare Violeta Shkurta pa datë (2 anëtarë); vendim nr. ***, datë 1.7.2010 i Këshillit të Bashkisë Fier “Për disa ndryshime në vendimin nr. ***, datë 30.1.2009” dhe lista e familjeve bashkëlidhur, ku familja e subjektit figuron në grupin e familjeve të pastreha që do të jenë në pritje për t’u trajtuar me kredi me kosto të ulët në rast se familjet e miratuara tërhiqen për arsye të ndryshme, si dhe lista e familjeve që kanë

⁸¹Referojuni edhe të shpjegimet e subjektit në pikën 1.5 të relacionit, lidhur me çështjet gjyqësore për dhomën nr. ***, në ish-hotel “****”, Fier.

⁸²Sipas shkresës përcjellëse nr. *** prot., datë 1.7.2021 të Bashkisë Fier.

lidhur me Bashkinë Fier kontrata me 3% gjatë vitit 2010-2011, ku është renditur edhe emri i subjektit që të ketë lidhur kontratë në datën 4.1.2011, në vlerën 3,590,000 lekë.

2.113 Bashkia Fier ka depozituar⁸³ në Komision dosjen e aplikantit Violeta Shkurta për kredi me kushte lehtësuese. Dosja përmban të njëjtat dokumente që ka paraqitur subjekti edhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2. Nga dosjet⁸⁴ për trajtimin e subjektit si familje e pastrehë nuk rezulton data kur subjekti ka aplikuar në Bashkinë Fier për të përfituar statusin e familjes së pastrehë, por është përgjigjur në pyetësorin nr. 2 se ka aplikuar në vitin 2011. Edhe në dosjen e administruar nga Komisioni me shkresën⁸⁵, datë 25.10.2012, të BKT-së, ndodhen të njëjtat dokumente përfshirë kontratën e kredisë dhe atë të hipotekimit që subjekti ka lidhur me BKT-në, si dhe shkresa, datë 29.4.2011, “Plotësim liste”, e Bashkisë Fier⁸⁶ (nënshkruar nga kryetari i Bashkisë Fier, z. B.Z.) të cilës i bashkëlidhet lista me emrin e subjektit miratuar me vendimin nr. ***, datë 1.7.2010, të Këshillit Bashkiak Fier. Lista mban datën 29.9.2011.

2.114 Komisioni hetoi për ndonjë situatë konflikti interesi të subjektit me shtetasin A.Sh., por nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë⁸⁷.

2.115 Neni 4 i ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane”, i ndryshuar, ka përcaktuar: “*Familjet, që klasifikohen për t’u trajtuar me programe sociale të strehimit, miratohen me vendim të këshillit bashkiak, sipas kriterëve të mëposhtme: (a) nuk kanë në pronësi një banesë; (b) zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike, ku bëjnë pjesë këto familje; (c) kanë mbetur të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore*”. Përfshihen në një nga germat “a”, “b” dhe “c” vetëm ato familje që kanë të ardhura të pamjaftueshme, sipas përcaktimeve të nenit 6 të këtij ligji.

2.116 Komisioni bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenet Ç e D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i ngarkoi subjektin barrën e provës për të provuar të kundërtën për sa duket që: (i) subjekti nuk plotësonte kriteret e kërkuara nga ligji nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane”, i ndryshuar, për të përfituar kredi lehtësuese nga Bashkia Fier, për arsye se ka pasur në pronësi një apartament me sip. 180,3 m² të blerë në datën 19.4.2006, edhe pse me kredi afatgjatë. Gjithashtu, në datën 23.2.2011, pra, 2 muaj përpara shkresës së Bashkisë Fier dhe 7 muaj përpara marrjes së kredisë lehtësuese, ka privatizuar apartamentin me sip. 36,5 m², i cili i është dhënë në përdorim nga shteti që në vitin 1992 dhe që e ka dhënë me qira qysh në vitin 2011 menjëherë sapo e ka privatizuar; (ii) subjekti i ka ndryshuar destinacionin kredisë lehtësuese, datë 8.11.2011, që ka përfituar nga Bashkia Fier, duke e përdorur për shlyerjen e një kredie të mëparshme.

Qëndrimi i subjektit

2.117 Subjekti ka kundërshtuar konkluzionin e parë duke shpjeguar se nga provat e administruara gjatë hetimit provohet ligjshmëria e aplikimit të përfitimit të statusit si i pastrehë në përputhje me ligjin nr. 9232, datë 13.5.2004, në momentin kur ka filluar aplikimi. Subjekti shpjegon se ka aplikuar për kredi për shkak të nevojave për strehim (pasi apartamenti te hotel “****” nuk përmbushte nevojat e familjes për strehim) dhe vështirësive të mëdha financiare në momentin e aplikimit. Në vijim, subjekti citon shpjegimet që ka dhënë gjatë

⁸³Me shkresën përcjellëse nr. *** prot., datë 10.9.2021.

⁸⁴Depozituar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2 dhe nga Bashkia Fier me shkresën nr. *** prot., datë 10.9.2021.

⁸⁵Shkresë nr. *** prot., datë 25.10.2012, të BKT-së.

⁸⁶Shkresë nr. *** prot., datë 29.04.2021, “Plotësim liste”, e Bashkisë Fier.

⁸⁷Shkresë nr. *** prot., datë 18.10.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gyqësor Fier.

hetimit dhe shton se për të hequr çdo lloj dyshimi për veprime fiktive, ka depozituar në dosjen e aplikimit për kredi edhe vërtetimin e ZVRPP-së Fier, ku figuron pronare e apartamentit me sip. 180,3 m² të inskriptuar në favor të BKT-së. Sipas subjektit, vendimi i Këshillit Bashkiak për miratimin e kredisë daton në vitin 2010, kur subjekti ishte divorcuar dhe pjesën më të madhe të të ardhurave për shlyerjen e kredisë e mbulonin kontributi i bashkëshortit dhe kredia e vitit 2006.

2.118 Subjekti ka kundërshtuar konkluzionin e dytë, duke shpjeguar se kredia është marrë për të zgjidhur problemin e strehimit.

2.119 Bashkëlidhur prapësimeve, për të provuar që nuk është favorizuar në përfitimin e kredisë, subjekti ka depozituar edhe shkresën nr. *** prot., datë 4.22.2021, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, ku rezulton se subjekti nuk ka trajtuar asnjë çështje penale ndaj Bashkisë Fier apo funksionarëve të saj përfshirë edhe kryetarin B.Z.

Vlerësimi i Komisionit

2.120 Referuar akteve të administruara gjatë hetimit, Komisioni vëren se nga vendimi nr. ***, datë 1.7.2010, të Këshillit të Bashkisë Fier, “Për disa ndryshime në vendimin nr. ***, datë 30.1.2009” dhe listën e familjeve bashkëlidhur, ku familja e subjektit figuron në grupin e familjeve të pastreha që do të jenë në pritje për t’u trajtuar me kredi me kosto të ulët në rast se familjet e miratuara tërhiqen për arsye të ndryshme, kuptohet që subjekti ka aplikuar për kredi në vitin 2010 dhe jo në vitin 2011 siç ka deklaruar në përgjigje të pyetësorit standard. Vetë subjekti është kontradiktor në deklaratimet e saj, pasi në përgjigjen e pyetësorit standard deklaron se ka aplikuar për kredi të butë në vitin 2011, kur Bashkia mori në shqyrtim kërkesën e saj, ndërsa në prapësimet e barrës së provës deklaroi se vendimi i Këshillit Bashkiak për miratimin e kredisë daton në vitin 2010. Në vitin 2010 subjekti ishte divorcuar dhe në prapësimet e barrës së provës ka pretenduar se pjesën më të madhe të të ardhurave për shlyerjen e kredisë e mbulonin kontributi i bashkëshortit dhe kredia e vitit 2006, kur ndërkohë gjatë hetimit ka shpjeguar se kredia gjatë divorcit shlyhej 6 muaj prej saj dhe 6 muaj nga bashkëshorti, pra, kishin të ardhura të mjaftueshme për shlyerjen e kredisë së parë që ishte afatgjatë.

2.121 Gjithashtu, edhe në shkresën nr. *** prot., datë 29.4.2011, të Bashkisë Fier drejtuar BKT-së, citohet: “...po plotësojmë listën me familjet e listës bashkëlidhur shkresës, familje të miratuara në vendimin nr. ***, datë 1.7.2010, të Këshillit të Bashkisë konfirmuar nga prefekti i qarkut...” dhe në listën bashkëlidhur kësaj shkrese citohet: “Violeta Shkurta, përbërja familjare 4 anëtarë, struktura e apartamentit që përfiton 3+1, familje e pastrehë nën normat e strehimit dhe banon me qira, kredia maksimale që përfiton 4,404,960 lekë, të ardhurat mujore të deklaruara 85,000 lekë”.

2.122 Pra, nga këto akte duket qartë se subjektit ka marrë statusin “familje e pastrehë” me vendim të Këshillit Bashkiak në datën 1.7.2010, por në vitin 2010 familja e subjektit përbëhej nga 2 anëtarë, subjekti dhe djali i saj (sepse subjekti ishte divorcuar nga bashkëshorti me të cilin ka rilidhur martesën në datën 22.4.2011⁸⁸ siç rezulton nga certifikatat familjare që subjekti ka depozituar në dosjen e aplikimit për kredi pranë Bashkisë Fier⁸⁹), ndërkohë që në listën bashkëlidhur shkresës nr. *** prot., datë 29.4.2011, të Bashkisë Fier, familja e subjektit figuron me 4 anëtarë banues me qira.

2.123 Referuar dosjes⁹⁰ së aplikimit për statusin “familje e pastrehë”, rezulton se përveç vërtetimit nga ZVRPP-ja Fier që vërteton se në pronësi të saj figuron apartamenti me sip.

⁸⁸Sipas certifikatës së martesës datë 18.6.2020 dhe certifikatës datë 10.7.2020.

⁸⁹Sipas shkresës përcjellëse nr. *** prot., datë 1.7.2021, të Bashkisë Fier.

⁹⁰Sipas shkresës përcjellëse nr. *** prot., datë 1.7.2021, të Bashkisë Fier.

180,3 m² dhe certifikatës familjare ku figuron familje me 2 anëtarë (subjekti dhe djali), gjatë kohës që subjekti ishte në listë pritje, pasi kishte marrë statusin “familje e pastrehë” ka depozituar edhe certifikatën familjare, datë 22.4.2011, me 4 persona të familjes së saj, por nuk është depozituar vërtetimi i pronësisë, datë 28.2.2011, lëshuar nga ZVRPP-ja që vërteton se në pronësi të subjektit dhe bashkëshortit është regjistruar apartamenti me sip. 35 m².

2.124 Sa më sipër, rezulton se jo vetëm që statusi “familje e pastrehë“ në vitin 2010 kur subjekti ishte familje me 2 anëtarë, kishte të ardhura mujore 85,000 lekë nga paga e saj, kishte të ardhura nga qiraja e apartamentit me sip. 35 m², në ish-hotel “****”, si dhe një apartament me sip. 180 m² në pronësi, është në kundërshtim me ligjin nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane”, i ndryshuar, por edhe ndryshimet në përbërjen familjare (nga 2 në 4 persona) dhe, si rrjedhojë, edhe në statusin “familje e pastrehë” të subjektit, nuk janë shqyrtuar dhe miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak, por janë cituar vetëm në listën bashkëlidhur shkresës nr. *** prot., datë 29.4.2011, të Bashkisë Fier, listë që mban datën 29.9.2011, pra, 5 muaj pas datës 29.4.2011 të shkresës së Bashkisë Fier. Gjithashtu, edhe lidhja e kontratës së kredisë dhe disbursimi i saj janë bërë pas martesës përsëri të subjektit me bashkëshortin.

Për sa më lart, Komisioni i vlerëson jobindëse shpjegimet e subjektit dhe arrin në përfundimin se:

- **Subjekti nuk plotësonte kriteret e kërkuara nga ligji nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane”, i ndryshuar, për të përfituar kredi lehtësuese nga Bashkia Fier, për arsye se ka pasur në pronësi një apartament me sip. 180,3 m², të blerë në datën 19.4.2006 edhe pse me kredi afatgjatë. Gjithashtu, në datë 23.2.2011, pra, 2 muaj përpara shkresës së Bashkisë Fier dhe 7 muaj përpara marrjes së kredisë lehtësuese, ka privatizuar apartamentin me sip. 36,5 m², i cili i është dhënë në përdorim nga shteti që në vitin 1992 dhe që e ka dhënë me qira që prej vitit 2011, menjëherë sapo e ka privatizuar.**
- **Subjekti i ka ndryshuar destinacionin kredisë lehtësuese për strehim, datë 8.11.2011, që ka përfituar nga Bashkia Fier, duke e përdorur për shlyerjen e një kredie të mëparshme të dhënë në kushte normale.**
- **Marrë shkas nga fakti se aplikimide përfitimi i statusit të të pastrehut nga ana e subjektit, janë bërë gjatë periudhës së divorcit, Komisioni vlerëson se problematika e konstatuar në lidhje me këtë kredi, nuk arrin deri në atë nivel saqë ndaj subjektit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra për shkak të cënimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.**

Pagesa e katërt – shuma 400,000 lekë, datë 31.12.2006

2.125 Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 9.2.2016 dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti ka paraqitur mandatin nr. ***, datë 31.12.2006, vlera 400,000 lekë, e arkëtuar nga A.Sh., lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k., me përshkrim “kësti ap. ***, kati *** i banimit”, nënshkruar nga A.Sh. dhe K.Xh. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, mbi kështet e paguara për blerjen e apartamentit dhe në vërtetimin e paraqitur nga shoqëria “****” sh.p.k., nuk përfshihet mandatarëkëtimi i përshkruar më lart.

2.126 Në lidhje me këtë problematikë të konstatuar nga Komisioni, subjekti ka shpjeguar se mandati nr. ***, datë 31.12.2006, është dërguar gabimisht prej tij në deklaratën *Vetting* dhe se ky mandat është anuluar me mandatin nr. ***, datë 31.12.2006. Me deklaratë noteriale nr. ***, datë 13.4.2007, vijon subjekti, u pasqyrua fakti se një pjesë e punimeve nuk u kryen (fakt

i dakordësuar në vitin 2006). Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti ka depozituar mandatin nr. ***, datë 31.12.2006.

2.127 Bazuar dhe në deklarinimin e subjektit në DIPP-në e vitit 2006, Komisioni i mori në konsideratë shpjegimet e subjektit dhe paraqiti vlerën 5,300,000 lekë si pagesë totale në vitin 2006.

Zbritja në vlerën 400,000 lekë, referuar deklaratës noteriale të datës 13.4.2007

2.128 Duke marrë parasysh deklaratën noteriale⁹¹, sipas së cilës shitësi dhe blerësi deklarojnë se nga vlera totale e apartamentit prej 8,460,000 lekësh, është zbritur vlera 400,000 lekë, për shkak të ndryshimit të projektit, si dhe deklarinimin dhe shpjegimin e kësaj rrethane në DIPP-në e vitit 2006 dhe në deklaratën *Vetting*, Komisioni zbriti vlerën 400,000 lekë nga çmimi i apartamentit, duke e konsideruar çmimin përfundimtar në vlerën 8,060,000 lekë.

3. Automjet tip “Audi”, me targa *, regjistruar në DRSHTRR-në Fier, datë 8.8.2014, në pronësi të bashkëshortit. Vlera: 1,700 euro, paguar dogana në vlerën 34,600 lekë. Burimi i krijimit:** të ardhurat nga pagat dhe shitja e automjetit të mëparshëm.

3.1 Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti deklaroi: “*Blerje automjeti në Gjermani, eksportuar nga shtetasi G.E., adresa Lushnjë, datë 7.8.2014. Regjistruar dhe targuar në DRSHTRR-në Fier, datë 8.8.2014. Vlera: 1,700 euro, paguar doganë në vlerën 34,600 lekë*”.

3.2 Sipas dosjes dhe shkresës shoqëruese të DPSHTRR-së⁹², rezulton se në pronësi të z. A.Sh. është automjeti me targa ***. DPSHTRR-ja⁹³ ka depozituar në Komision dosjen e këtij automjeti me këto dokumente: (i) certifikatë automjeti tip “Audi”, në emër të J.F., me vit prodhimi 2001; (ii) kontratë shitblerje automjeti me datë 5.7.2014; (iii) aktzhdoganimi, datë 7.8.2014, me eksportues J.F. - Gjermani dhe importues A.Sh., vlera e automjetit 950 euro (kursi këmbimit 139), vlera e zhdoganimit 30.722 lekë; (iv) leje qarkullimi e automjetit, datë 8.8.2014, në emër të A.Sh.

3.3 Sipas këtyre dokumenteve, rezulton se automjeti në momentin e zhdoganimit kishte vlerën totale 162,772 lekë (950 euro x 139 kursi këmbimit = 132,050 lekë + 34,317 vlera zhdoganimit = 166,367 lekë). Subjekti ka deklaruar vlerën e automjetit 1,700 euro ose 236,300 lekë dhe 34.600 lekë shpenzime doganore, në total 270,900 lekë⁹⁴.

3.4 Komisioni me anë të pyetësorit nr. 2, i kërkoi subjektit të shpjegojë: (i) mospërputhjen e çmimit të deklaruar dhe çmimit të kontratës; (ii) të dhëna për automjetin të ardhurat nga shitja e të cilit kanë shërbyer si burim; të paraqesë kontratën e blerjes dhe atë të shitjes së tij; (iii) kush është shtetasi G.E. dhe lidhjen e subjektit apo të bashkëshortit me të.

3.5 Në përgjigje subjekti ka shpjeguar se: “*Me kontratën e shitblerjes⁹⁵, djali R.Sh. ka blerë automjetin tip ‘Opel Corsa’, në shumën 50,000 lekë dhuratë (me lekët e dhuruara nga tezet, hallat, dajat për ditëlindjen e tij në datën 19.12.2013)... Po këtë vit ka shitur këtë automjet në shumën 2,000 euro. Në vitin 2012, bashkëshorti punonte në Komisariatën e Policisë Lushnjë dhe e kishte të nevojshme automjetin për të shkuar në punë. Kishte rënë në dijeni se shtetasi G.E. blinte automjete jashtë shtetit dhe i shiste në Shqipëri dhe ka kërkuar prej këtij blerjen e një automjeti Audi. G.E. e ka sjellë automjetin nga Gjermania ku e ka blerë për 950 euro dhe bashkëshortit tim ia ka shitur për 1,700 euro... Bashkëshorti ka paguar edhe vlerën e doganës.*

⁹¹Deklaratë noteriale nr. ***, datë 13.4.2007.

⁹²Shkresë nr. ***, datë 21.7.2017, e DPSHTRR-së.

⁹³Me shkresën nr. *** prot., datë 26.1.2021.

⁹⁴Vlera 1,700 euro e vlerësuar me kursin e këmbimit në deklaratën doganore 1 euro = 139 lekë.

⁹⁵Kontratë shitblerje automjeti nr. ***rep., datë 31.1.2014, e depozituar bashkëlidhur deklaratës *Vetting* (lidhur midis shitësit R.Sh. dhe blerësit D.G. për shitjen e automjetit tip “Opel Corsa”, me targa ***, kundrejt çmimit 2.000 euro (139.6 x 2.000 euro = 279.200 lekë) të likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale.

Bashkëshorti sqaron se në vitin 2014, nga kolegët e punës në Komisarlatin e Policisë Lushnjë ka mësuar për këtë veprimtari të G.E., e ka kontaktuar dhe kanë rënë dakord për blerjen e automjetit në Gjermani. Kaq ka qenë njohja me këtë shtetas që ushtronte aktivitet në Lushnjë”.

3.6 Bashkëlidhur përgjigjes, subjekti ka depozituar: (i) mandat, datë 7.8.2014, i BKT-së, sipas të cilit A.Sh. ka paguar shumën 34,600 lekë shpenzime doganore; (ii) kontratë shitblerje automjeti, datë 5.7.2014, ku shitësi “****” i shet blerësit G.E. automjetin tip “Audi”, me çmim total 1,700 euro, për eksport në Shqipëri; (iii) dokument regjistrimi i automjeteve me targa afatshkurtra në Gjermani, datë 6.7.2014, për automjetin tip “Audi”, në emër të shtetasit G.E.

3.7 Për sa më lart, rezulton se ka mospërputhje midis dokumentacionit të dërguar nga DPSHTRr-ja⁹⁶, ku rezulton se automjeti tip “Audi” është blerë nga bashkëshorti i subjektit prej ish-pronarit J.F., në Gjermani, me vlerë 950 euro plus shpenzimet doganore dhe përgjigjes së subjektit në pyetësin nr. 2, ku sqaron se *G.E. e ka sjellë automjetin nga Gjermania ku e ka blerë për vlerën 950 euro dhe ia ka shitur bashkëshortit të saj për vlerën 1,700 euro* me dokumentacionin bashkëlidhur⁹⁷, ku rezulton se automjeti tip “Audi” është blerë në Gjermani nga shtetasi G.E. prej shitësit “****”, në vlerën 1,700 euro.

3.8 Për efekt të analizës financiare, Komisioni konsideroi vlerën 270,900 lekë. Për sa i përket burimit financiar të krijimit, shitjes së automjetit me targa ***, në shumën 2,000 euro. Komisioni vëren se këto të ardhura nuk mund të kenë shërbyer si burim për sa kohë kontrata e shitjes nr. ***, mban datën 4.9.2014, pra 2 muaj pas kontratës së shitblerjes dhe 1 muaj pas zhdoganimit të automjetit tip “Audi”, me targa ***. Për më tepër, rezulton se nuk është kryer pagesa e detyrimeve tatimore për vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e automjetit me targa *** dhe për këtë arsye, vlera e fitimit të realizuar prej 229,280 lekësh⁹⁸ vlerësohet si e ardhur e paligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr.84/2016, prandaj kjo vlerë i zbritet të ardhurës së arkëtuar për efekt të analizës financiare (trajtuar në pikën 30 më poshtë).

3.9 Komisioni hetoi për ndonjë situatë konflikti interesi të subjektit me shtetasin G.E. dhe nga hetimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë⁹⁹.

3.10 Komisioni bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën për sa duket se: (i) nuk përputhet vlera e automjetit të deklaruar në deklaratën Vetting dhe në pyetësin nr. 2, me vlerën e automjetit që është përcaktuar në kontratën e shitblerjes, datë 5.7.2014; (ii) ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën 270,900 lekë për blerjen e automjetit tip “Audi”, me targa ***, në vitin 2014, pasi subjekti deklaroi si burim të ardhurave nga shitja e automjetit me targa ***, ndërkohë që kontrata e shitjes për këtë të fundit është lidhur rreth 1 muaj më vonë nga dita e zhdoganimit.

Qëndrimi i subjektit

3.11 Subjekti ka dhënë shpjegime për konkluzionin e parë, duke shpjeguar se vlera e deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe gjatë hetimit administrativ, pasqyron vlerën reale të këtij automjeti, sepse në këtë vlerë janë përfshirë shpenzimet e paguara që ky automjet të vinte nga Gjermania. Bashkëlidhur, subjekti ka depozituar: (i) deklaratën noteriale nr. ***, datë 4.11.2021, ku shtetasi G.E. deklaroi se me kërkesë të A.Sh. ka blerë dhe transportuar nga Gjermania në Shqipëri automjetin tip “Audi” dhe shpenzimet për këtë shërbim kanë qenë 750 euro (udhëtim,

⁹⁶Shkresë nr. *** prot., datë 21.7.2017, e DPSHTRr-së.

⁹⁷Pas kërkesës së Komisionit, dokumentacioni është dërguar i përkthyer nga subjekti me anë të e-mail datë 20.9.2021.

⁹⁸Diferenca midis ekuivalentit të vlerës 279,280 lekë (2,000 euro e vlerësuar me kursin zyrtar të këmbimit 1 euro = 139,64 lekë) me 50,000 lekë.

⁹⁹Shkresë nr. *** prot., datë 18.10.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gyqësor Fier.

karburant, biletë avioni, taksa autostrade). Në Gjermani automjetin e ka blerë në vlerën 950 euro dhe ia ka shitur shtetasit A.Sh. për vlerën 1,700 euro që e ka marrë me vonesë; (ii) ekstraktin historik të personit fizik G.E. me NIPT ***, ku në korrik të vitit 2014 figuron “aktiv”, me objekt aktiviteti “pjesë këmbimi”.

3.12 Në lidhje me konstatimin e dytë, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 12.11.2021, e bërë nga personi i lidhur A.Sh., i cili deklaron se djali ka qenë pronar i automjetit “Opel Corsa”, me targa ***, që ja kanë blerë të përdorur në vlerën 50,000 lekë. Si mjet i përdorur ka pasur defekte prandaj i janë bërë shërbime pranë servis “****”, në vlerën 110,000 lekë dhe e shitën në vlerën 2,000 euro, për të përfituar investimin e bërë. Me vlerën e shitjes është blerë automjeti tip “Audi”, me targa ***.

3.13 Bashkëlidhur, subjekti ka depozituar: (i) një deklaratë (pa datë) nga përfaqësuesi i shoqërisë “****” sh.p.k., për kryerjen e servisit të automjetit tip “Opel Corsa”, me targa ***, në vitin 2004, në vlerën 110,000 lekë; (ii) ekstraktin historik të shoqërisë “****” sh.p.k. aktive në vitin 2004.

Vlerësimi i Komisionit

3.14 Në lidhje me konstatimin e parë, Komisioni nisur nga: DIPP-ja e vitit 2004, ku subjekti ka deklaruar se e ka blerë automjetin nga shtetasi G.E., i cili ka vepruar si eksportues i automjetit nga Gjermania me vlerë totale 1,700 euro, vlerë të cilën e ka deklaruar njësoj; nga fakti që kontrata e shitblerjes së automjetit e lidhur midis blerësit A. Sh. dhe shitësit J.F. është lidhur në gjuhën gjermane në Gjermani dhe mban datën 5.7.2014, ndërkohë që sipas sistemit *TIMS*¹⁰⁰ në këtë datë apo një datë të përafërt me këtë, nuk rezulton që shtetasi A.Sh. të ketë dalë nga Shqipëria; fakti që edhe kontrata e blerjes së automjetit që ka lidhur G.E. për blerjen e këtij automjeti është lidhur në datën 5.7.2014 dhe në kontratë citohet që “blerësi është lidhur me këtë kontratë vetëm për një javë”, krijohet bindja se G.E. ka qenë në rolin e ndërmjetësit dhe transportuesit të automjetit, i cili është blerë në vlerën 1,700 euro.

3.15 Komisioni vlerëson të marrë në konsideratë, duke e konsideruar bindëse deklaratën noteriale të shitësit G.E. se vlerën e shitjes së automjetit tip “Audi” e ka marrë me vonesë çka do të thotë se kjo vlerë ka si burim të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Opel Corsa”.

3.16 Në lidhje me vlerën e përfituar nga shitja e automjetit tip “Opel Corsa”, Komisioni vëren se deklarata e shoqërisë “****” sh.p.k., për kryerjen e servisit të këtij automjeti në vitin 2004, në vlerën 110,000 lekë, e pashoqëruar me faturë tatimore dhe situacion për pagesën e kryer të punimeve, nuk arrin të provojë bindshëm rritjen e vlerës së automjetit dhe shitjen e tij me vlerën 2,000 euro.

3.17 Veç sa më sipër, subjekti nuk arriti të provojë pagesën e detyrimeve tatimore mbi fitimin e realizuar nga shitja e këtij automjeti, të blerë për vlerën 50,000 lekë dhe shitur për vlerën 2,000 euro. Kështu, Komisioni mori në konsideratë si burim të ligjshëm për blerjen e automjetit tip “Audi” vetëm vlerën e blerjes së automjetit tip “Opel Corsa”, prej 50,000 lekësh.

3.18 Komisioni kreu analizën financiare në datën 5.7.2014, si në tabelën më poshtë, nga ku rezultoi një balancë pozitive në vlerën 61,617 lekë.

Përshkrim	Datë 5.7.2014
Automjet me targa ***	50,000
Automjet me targa *** (1.700 euro)	236,300
Total pasuri	286,300

¹⁰⁰*TIMS* i përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 30.6.2020.

Tërheqje subjekti nga “Raiffeisen Bank” (1.1.2014 - 5.7.2014) ¹⁰¹	552,000
Tërheqje bashkëshorti nga BKT (1.1.2014 - 5.7.2014) ¹⁰²	296,500
Të ardhura nga shitja e automjetit me targa ***	50,000
Total tërheqje	898,500
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT ¹⁰³	454,663
Shpenzime qiraje fëmijët në Tiranë ¹⁰⁴	70,000
Shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS ¹⁰⁵	25,920
Total shpenzime¹⁰⁶	550,583
Balanca e fondeve (tërheqje – pasuri - shpenzime)	61,617

Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme në datën 5.7.2014, për pagesën e vlerës 236,300 lekë (ekuivalenti i 1,700 euro) dhe në datën 5.8.2014, për pagesën e detyrimeve doganore në vlerën 34,600 lekë¹⁰⁷.

4. Automjet tip “Fiat”, me targa *, blerë nga bashkëshorti me kontratën nr. ***, datë 16.11.2009. Vlera: 290,000 lekë. Burimi i krijimit: nuk ka deklaruar burim krijimi.**

4.1. Në DIPP-në e vitit 2011, personi i lidhur me subjektin, shtetasi A.Sh. ka deklaruar: “Automjeti tip ‘Fiat’, me targa ***, blerë në tetor të vitit 2009 nga shoqëria ‘***’, Fier. Vlera: 290,000 lekë. Pjesa: 100%”. Komisioni vëren se në vitin e blerjes së këtij automjeti, subjekti ka qenë i divorcuar dhe personi i lidhur, A.Sh. nuk ka pasur detyrim për deklarim. Deklarimi është kryer në vitin 2011, pasi u martuan sërish¹⁰⁸.

4.2. DPSHTRr-ja ka depozituar¹⁰⁹ në Komision dosjen e këtij automjeti me këto dokumente: (i) aktzhdoganimi, datë 1.8.2008, automjetit tip “Fiat”, vit prodhimi 2008, ku figuron dërgues “***”, marrës “***” sh.p.k., vlera automjetit 9,216 euro (kurs këmbimi 122.05), vlerë zhdoganimi 224,962 lekë; (ii) kontratë shitblerje automjeti, datë 30.7.2008, me shitës “***” sh.p.k. dhe blerës “***” sh.p.k., për automjetin tip “Fiat 500” në vlerën 12,200 euro (1.488.400 lekë); (iii) kontratë shitblerje automjeti, datë 6.11.2009, me shitës shoqërinë “***” sh.p.k. dhe blerës A.Sh., në vlerën 290,000 lekë. Në këtë kontratë palët nuk kanë deklaruar ndonjë gjendje të parregullt apo dëmtim të automjetit. Nga dokumentacioni i mësipërm rezultoi se bazuar në numrin e shasisë, automjeti me targa *** është i njëjti automjet me targa aktuale ***.

4.3. Sipas këtyre dokumenteve, rezultoi se automjeti në datën e zhdoganimit më 1.8.2008 ka pasur vlerën totale 1,349,314 lekë. Blerësi i dytë shoqëria “***” sh.p.k. e ka blerë automjetin në datën 31.7.2008 (data e faturës së shitjes) në vlerën 1,488,400 lekë. Shtetasi A.Sh. e ka blerë automjetin në datën 6.11.2009, me vlerë 290,000 lekë. Gjithashtu, nga dokumentacioni konstatohet se ky automjet është prodhuar në vitin 2008 dhe në momentin e zhdoganimit ka qenë në gjendje të re¹¹⁰.

¹⁰¹Burim i këtyre tërheqjeve janë kreditimet e pagave.

¹⁰²Burim i këtyre tërheqjeve janë kreditimet e pagave.

¹⁰³Përpjesëtimore për 6.2 muaj

¹⁰⁴Për 7 muaj

¹⁰⁵Udhëtime të datave 5.3.2014 dhe 21.3.2014

¹⁰⁶Shpenzimet për shlyerjen e kredisë nuk janë konsideruar pasi janë kryer me transferta midis llogarive (jo me depozitime).

¹⁰⁷Referuar balancës pozitive të datës 5.7.2014, e mjaftueshme për pagesën e detyrimeve doganore.

¹⁰⁸Referuar shkresës nr. *** prot., datë 1.7.2021, të DPGJC, subjekti dhe shtetasi A.Sh. janë martuar në datën 15.6.1992, divorcuar në datën 14.5.2007 dhe martuar sërish në datën 22.4.2011.

¹⁰⁹Me shkresën nr. *** prot., datë 26.1.2021, të DPSHTRr-së.

¹¹⁰Referuar deklaratës doganore ***, datë 1.8.2008, në kutinë 31 përshkruhet: “Veturë 5 vende, e re, benzinë [...]”

4.4. Komisioni i kërkoi subjektit nëpërmjet pyetësorit nr.2 që: (i) të shpjegojë se në çfarë rrethanash e ka përfituar këtë çmim preferencial duke konsideruar faktin që automjeti është prodhuar në vitin 2008 (pra, një vit përpara blerjes nga ana e tij), është blerë nga shoqëria “***” sh.p.k., në datën 31.7.2008, për çmimin 1,488,400 lekë dhe pas 1 vit e 3.5 muaj është blerë nga bashkëshorti i subjektit me vlerën 290,000 lekë, pra, në vlerën 1,198,400 lekë më pak; (ii) të deklarojë burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e këtij automjeti.

4.5. Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar: *“Bashkëshorti im më ka shpjeguar se ka qenë shok shkollë me shtetasin E.K., bashkëshortja e të cilit L.K. ka qenë administratore e shoqërisë ***’. Automjeti tip ‘Fiat’ është aksidentuar dhe shoq*

4.6.ëria ‘***’ ia ka shitur bashkëshortit, fakt që e vërtetoj me deklaratën noteriale të shtetasit¹¹¹ E.K. Të ardhurat për blerjen e automjetit, kanë qenë nga puna e bashkëshortit. Gjatë viteve 2007 – 2011 kam qenë e divorcuar me bashkëshortin dhe gjatë kësaj periudhe nuk kam patur asnjë djeni për veprimtarinë e tij. Bashkëlidhur vendimi nr. ***, datë 14.5.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për zgjidhje martese dhe deklarata noteriale e shtetasit E.K.”.

4.7. Komisioni hetoi mbi ndonjë situatë konflikti interesi të subjektit me shtetasin L.K. administratore e shoqërisë “***” sh.p.k. dhe shtetasin E.K. dhe nga hetimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë.¹¹²

4.8. Në kushtet që subjekti nuk paraqiti dokumentacion ligjor për të provuar dëmtimin e automjetit për të argumentuar një ulje të tillë të vlerës së tij, Komisioni vlerësoi që nga vlera 12,200 euro (1,488,400 lekë), me të cilën shoqëria “***” sh.p.k. ka blerë automjetin në datën 20.7.2008 të zbritet vlera e amortizimit deri në datën 16.11.2009, kur kjo shoqëri ia ka shitur personit të lidhur me subjektin, A.Sh.

4.9. Duke aplikuar një normë amortizimi vjetore në masën 20% (si referencë u përdor pika 5/b, e nenit 22, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar), rezulton një vlerë prej 1,121,261 lekësh¹¹³.

4.10. Pika 13, e nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, parashikon se: *“Person i lidhur është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit,..., i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit, komisionerët, gjyqtarët dhe komisionerët publikë për periudhën e rivlerësimit”.*

4.11. Sa më lart, bazuar në nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, duke qenë se kjo është një pasuri e deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe z. A.Sh. është deklaruar si person i lidhur në këtë deklaratë, Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën 2007 - 2010. Bashkëshorti nuk ka deklaruar likuiditete *cash* në DIPP-në e vitit 2011.

4.12. Referuar shkresës¹¹⁴ së DPGJ-së Civile, subjekti me shtetasin A.Sh. janë martuar në datën 15.6.1992, divorcuar më 14.5.2007 dhe martuar sërish në datën 22.4.2011.

¹¹¹Bashkëlidhur përgjigjes: (i) deklarata noteriale nr. ***, datë 27.8.2021, ku E.K. deklaroi se automjeti është blerë në vitin 2008 në emër të shoqërisë “***” sh.p.k. dhe është përdorur nga ish-bashkëshortja L.K., e cila pas një aksidenti ku automjeti u dëmtua rëndë u dogj motori, nuk ishte më e interesuar për këtë mjet dhe ia shiti A.Sh. që e kam pasur shok shkollë; (ii) vendimi nr. ***, datë 14.5.2007, sipas të cilit divorcohet subjekti me bashkëshortin e saj A.Sh.

¹¹²Shkresat nr. *** prot., datë 10.9.2021 dhe nr. *** prot., datë 18.10.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

¹¹³Nga vlera 1.488.400 lekë u zbrit vlera e amortizimit prej 367,139 lekë.

¹¹⁴Shkresë nr. *** prot., datë 1.7.2021, të DPGJC-së.

4.13. Në këtë analizë janë përfshirë: (i) të ardhura nga pagat në shoqëria “****”¹¹⁵ (për muajt qershor, korrik, shtator, tetor, nëntor, dhjetor 2007 dhe janar 2008, nuk ka listëpagesa); (ii) shpenzimet jetike për 2 persona, pasi në pyetësin standard subjekti ka deklaruar: “Në momentin e zgjidhjes të martesës shpenzimet janë përballuar nga secili. Unë kam përballuar shpenzimet për vete dhe djalë, pagesat për 6 muaj kredi. Bashkëshorti ka përballuar pagesat e kredisë për gjashtë muaj, shpenzimet e tij dhe të vajzës. Pas vitit 2011 me rilidhjen e martesës, shpenzimet kemi vazhduar t’i përballojmë të dy bashkë”; (iii) gjysma (1/2) e shpenzimit total vjetor të kryer për pagesën e kredisë (duke përfshirë principal, interesa, prime etj.), pasi ndër vite, në DIPP-të e viteve 2007, 2008, 2009 dhe 2010, subjekti ka deklaruar pagesën e kredisë, 6 muaj nga ish-bashkëshorti dhe 6 muaj prej tij, duke dhënë edhe vlerat përkatëse; (iv) shpenzime për blerjen e automjetit në vlerën 1,121,261 lekë.

Tabela nr. 4 – Analiza financiare e bashkëshortit të subjektit gjatë periudhës së divorcit

Përshkrim	2007	2008	2009	2010	TOTAL
Të ardhura nga pagat “****”	180,576	197,000			377,576
Shpenzime jetese (2 persona)	219,114	273,240	273,240	273,240	1,038,834
Shpenzime për blerje automjeti			1,121,261		1,121,261
Shpenzime për kredinë (1/2)	272,804	292,261	304,302	299,761	1,169,128
Ndryshim i likuiditeteve	352	-159	605	1,095	1,893
Balanca vjetore	- 311,694	-368,343	-1,699,407	- 574,096	-2,953,539

4.13 Komisioni bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenet Ç e D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën për sa duket që: (i) çmimi me të cilin është blerë automjeti nga bashkëshorti i subjektit (në vlerën 290,000 lekë), nuk pasqyron vlerën reale të blerjes, duke konsideruar çmimin me të cilin e ka blerë vetë shitësi (12,200 euro), vitin e prodhimit të automjetit (2008), vitin në të cilin e ka blerë bashkëshorti (2009), faktin që automjeti sipas aktzhdoganimit ka qenë “i ri”, si dhe faktin se në kontratën e shitblerjes së automjetit nga shtetasi A.Sh. nuk citohet ndonjë gjendje e parregullt/dëmtim i automjetit; (ii) duket se bashkëshorti i subjektit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për kryerjen e shpenzimeve (blerjen e makinës, shlyerjen e kredisë dhe shpenzimet për jetesë) gjatë periudhës 2007 – 2010, në shumën 2,953,539 lekë; (iii) subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën Vetting burimin e krijimit të automjetit me targa ***.

Qëndrimi i subjektit

4.14 Në lidhje me konstatimin e parë, subjekti ka shpjeguar në periudhën 2007 – 2011 ka qenë e divorcuar nga shtetasi A.Sh., prandaj nuk ka pasur dijeni për të ardhurat e tij dhe, gjithashtu, në kuptim të pikës 13, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, shtetasi A.Sh. nuk ka pasur cilësinë e personit i lidhur me subjektin në kohën e blerjes së automjetit. Në vijim, subjekti i është përmbajtur deklarimeve që ka bërë në përgjigje të pyetësin nr. 2 dhe ka depozituar si prova: (i) deklaratën noteriale nr. ***, datë 12.11.2021, ku A.Sh. deklaroi se në vitin 2009 ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k. automjetin tip “Fiat 500” me targa ***, në vlerën 290,000 lekë. Ky automjet u shit sepse administratorja e shoqërisë “****” sh.p.k. njëkohësisht bashkëshortja e mikut të tij E.K., e kishte dëmtuar gjatë një përplasje. Përpara se ta blinte automjetin, shtetasi A.Sh. ka kërkuar një preventiv për riparimet në shoqërinë “****” sh.p.k.

¹¹⁵Vërtetim nr. *** prot., datë 20.10.2016, nga DRSSH-ja Fier, saktësuar paga neto sipas legjislacionit të kohës.

dhe meqë nuk ka rënë dakord me çmimin e ofruar ka bërë servis automjetit pranë servisit të A.Ç., në vlerën 320,000 lekë. Për këtë blerje të automjetit, subjekti nuk ka pasur dijeni sepse kanë qenë të divorcuar; (ii) akt identifikim defekti dhe preventiv paraprak punimesh, datë 22.10.2009, nga shoqëria **** “ sh.p.k.; (iii) ekstrakt historik i regjistrimit tregtar për personin fizik **** me objekt veprimtarie “autoservis, import, eksport pjesë këmbimi...”.

Vlerësimi i Komisionit

4.15 Bazuar në shpjegimet e subjektit dhe provave të paraqitura prej tij, Komisioni rillogariti vlerën e paraqitur në analizën financiare të automjetit, duke e pasqyruar atë në vlerën 610,000 lekë (290,000 lekë çmimi i kontratës dhe 320,000 lekë riparimi). Pas rishikimit, analiza financiare e bashkëshortit paraqitet si në vijim:

Tabela nr. 4/1 – Analiza financiare e rishikuar e bashkëshortit të subjektit gjatë periudhës së divorcit

Përshkrim	2007	2008	2009	2010	TOTAL
Të ardhura nga pagat ****	180,576	197,000			377,576
Shpenzime jetese (2 persona)	219,114	273,240	273,240	273,240	1,038,834
Shpenzime për blerje automjeti			610,000		610,000
Shpenzime për kredinë (1/2)	272,804	292,261	304,302	299,761	1,169,128
Ndryshim i likuiditeteve	352	-159	605	1,095	1,893
Balanca vjetore	- 311,694	-368,343	-1,188,146	- 574,096	- 2,442,278

4.16 Në lidhje me dy konstatimet e tjera, subjekti nuk dha shpjegime, kështu që këto konstatime mbeten të pandryshuar.

4.17 Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se bashkëshorti i subjektit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për kryerjen e shpenzimeve (blerjen e makinës, shlyerjen e kredisë dhe shpenzimet për jetesë) gjatë periudhës 2007 – 2010, në shumën 2,442,278 lekë, duke u gjendur në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 5/b të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, për arsye se nuk ka deklaruar në deklaratën Vetting burimin e krijimit të automjetit me targa ***, duke vepruar në kundërshtim me pikat 1 dhe 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

5. Automjet tip “Land Rover”, me targa *, në pronësi të bashkëshortit. Vlera: 0 (zero) lekë. Burimi i krijimit:** nuk ka deklaruar burim krijimi.

5.1 Subjekti në lidhje me këtë automjet ka sqaruar se në vitin 2007 ky automjet është shkatërruar plotësisht në një aksident nga bashkëshorti, për të cilin disponojnë vetëm lejen e qarkullimit të tij, si dhe i ka bashkëlidhur deklaratës Vetting dokumentacionin si vijon: (i) vërtetim¹¹⁶ nga DPSHTRr-ja Fier, ku ky automjet rezulton në pronësi të shtetasit A.Sh.; (ii) shkresë¹¹⁷ me të cilën shtetasi A.Sh. njoftohet nga DPSHTRr-ja Fier që të paguajë taksat për vitet 2011– 2016 për automjetet që ka në pronësi dhe të çregjistrojë automjetin me targa *** që nuk e ka në qarkullim.

¹¹⁶Vërtetim nr. *** prot., datë 4.11.2016, e DRSHTTR-së Fier.

¹¹⁷Njoftimin nr. *** prot., datë 4.1.2016, e DPSHTRR-së.

5.2 ILDKPKI-ja ka depozituar në Komision vërtetimin¹¹⁸ nga DPSHTRr-ja Fier, sipas të cilit automjeti me targa *** është hequr nga qarkullimi përfundimisht në datën 29.6.2017.

5.3 DPSHTRr-ja¹¹⁹ ka depozituar në Komisionit dosjen e këtij automjeti me këto dokumente: (i) kartelën e automjetit, në cilën rezulton se ky automjeti ka ardhur nga Greqia dhe është regjistruar në datë 3.5.2002, me targa ***, në pronësi të z. A.M. dhe në datën 29.5.2003 figuron i regjistruar, me targa ***, në emër të z. A.Sh. dh më vonë i është ndryshuar edhe targa; (ii) aktzhdoganimi, datë 3.5.2002, në emër të z. A. M., vlera automjetit 704,256 lekë, vlera zhdoganimit 221,894 lekë; (iii) leje qarkullimi dhe certifikatë regjistrimi lëshuar nga autoritetet Greke, sipas së cilave figuron se z. A.M. ka qenë pronar i automjetit i regjistruar në Greqi; (iv) kontratë shitblerje automjeti¹²⁰, datë 3.9.2002, me shitës A.M. dhe blerës A.Sh., kundrejt çmimit 800,000 lekë, që është paguar plotësisht jashtë zyrës noteriale.

5.4 Sipas këtyre dokumenteve rezulton se në datën e zhdoganimit më 3.5.2002, vlera e automjetit ka qenë 926,150 lekë (704,256 vlera automjetit + 221,894 vlera e zhdoganimit = 926,150). Personi i lidhur me subjektin, A.Sh. e ka blerë automjetin në datën 3.9.2002, në vlerën 800,000 lekë, pra, 126,150 lekë (926,150 – 800,000) më pak se vlera e zhdoganimit.

5.5 Në DIPP-në e vitit 2003 subjekti ka deklaruar: “Automjet, vlera 950,000 lekë, periudha mars 2003, me burim kursime familjare, pronë e regjistruar në emër të bashkëshortit”.

5.6 Me anë të pyetësorit nr. 2, subjektit iu kërkua të deklarojë dhe të provojë me dokumentacion ligjor justifikues burimin e krijimit të këtij automjeti. Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar se: “Me kontratë shitblerje¹²¹, bashkëshorti A.Sh. ka blerë automjetin tip ‘Land Rover’ nga shtetasi A.M., në vlerën 800,000 lekë. Vlera 950,000 lekë e deklaruar në DIPP e vitit 2003 është një lapsus i shënuar sipas deklarimit verbal të bashkëshortit... Këtë automjet e kemi përdorur deri në vitin 2007 kur bashkëshorti ka bërë aksident dhe automjeti është shkatërruar plotësisht. Me vërtetimin¹²² e DRSHTRR Fier është hequr përgjithmonë nga qarkullimi. Të ardhurat të siguruara nga puna e bashkëshortit në vitet 1997 – 2002.”

5.7 Në DIPP-në e vitit 2003, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: “Automjet, vlera 0.95 milion lekë regjistruar në DRSHTRR Fier në Mars 2003. Pjesë takuese __ % . Blerje me kursime familjare.”

5.8 Faktin që automjeti është shkatërruar në aksident, subjekti e ka deklaruar edhe në procesverbalin e datës 9.2.2016, të mbajtur në ILDKPKI.

5.9 Rezulton se vlera 950,000 lekë e deklaruar në DIPP-në e vitit 2003 nuk përputhet me vlerën 800,000 lekë të kontratës së shitblerjes së automjetit nga z. A.Sh.¹²³.

5.10 Në DIPP-në e vitit 2004, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: “A.Sh., Makinë tip ‘Rover’, viti 2001, blerë nga A.M. Burim krijimi: _____”.

5.11 Në pyetësorin nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektit që të përcaktojë saktë, për cilin automjet bëhet fjalë dhe të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues për blerjen dhe burimin e krijimit të tij. Në përgjigje, subjekti ka deklaruar: “Automjeti tip ‘Land Rover’, me targa

¹¹⁸Vërtetimin nr. ***, datë 29.6.2017, nga DRSHTRR-së Fier.

¹¹⁹Me shkresën datë 26.1.2021.

¹²⁰Kontratë shitblerje automjeti nr. ***, datë 3.9.2002.

¹²¹Kontratë shitblerje automjeti nr. ***, datë 3.9.2002/

¹²²Vërtetimi nr. ***, datë 29.6.2017, i DRSHTRR-së Fier.

¹²³Kontratë nr. ***, datë 3.9.2002, e depozituar nga DPSHTRR-ja pranë Komisionit me shkresën nr. *** prot., datë 26.1.2021.

*** blerë me kontratë¹²⁴, të ardhurat të siguruar nga puna e bashkëshortit në vitet 1997 – 2002.”

5.12 Gjatë hetimit për konflikt interesi, Komisioni administroi shkresën¹²⁵ sipas së cilës rezultoi se nuk ka të dhëna të regjistruara për shtetasin A.M.

5.13 Duke qenë se vlera prej 950,000 lekësh e deklaruar nga subjekti në DIPP-në e vitit 2003, është lapsus, siç shpjegon subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2 dhe vlera e automjetit është vlera e shitjes së përcaktuar në kontratën e shitblerjes¹²⁶, Komisioni për efekt të analizës financiare konsideroi çmimin 800,000 lekë të pasqyruar në kontratën e shitblerjes.

5.14 Referuar dokumentacionit për punësimin e personit të lidhur me subjektin, A.Sh., në Shqipëri, rezultoi se pagat *neto*, për periudhën 1992 – 2002, kanë qenë në shumën 631,343 lekë¹²⁷, të cilat janë të pamjaftueshme për blerjen e automjetit në shumën 800,000 lekë, referuar analizës financiare, për periudhën 1992 – 2002, për të ardhurat, pasuritë dhe shpenzimet, paraqitur në tabelën nr. 5 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

5.15 Komisioni bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenet Ç e D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën për sa duket që: (i) referuar analizës financiare deri në fund të vitit 2002, subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme për blerjen e këtij automjeti; (ii) subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën Vetting burimin e krijimit të automjetit me targa ***.

Qëndrimi i subjektit

5.16 Subjekti e ka kundërshtuar konstatimin e parë si të pabazuar duke shpjeguar se në llogarinë e bashkëshortit të hapur në datën 13.4.2001 është kredituar shuma 6,000,000 lekë të cilën e ka tërhequr gjatë vitit 2001 dhe shuma 3,100,000 lekë është përdorur për të blerë pajisje kompjuterike; shuma 2,000,000 lekë për blerje pajisje bingo nga z. Sh.B. dhe 800,000 lekë për të paguar automjetin tip “Land Rover”. Gjithashtu, subjekti shpjegon se analiza financiare e vitit 2002 rezultoi me balancë pozitive në vlerën 2,691,277 lekë.

5.17 Në lidhje me konstatimin e dytë, subjekti ka shpjeguar se mosdeklarimi i burimit të krijimit, ka qenë lapsus i saj duke menduar se burim është vetë kontrata e blerjes së automjetit dhe vijon se mosdeklarimi i burimit nuk ka qenë i qëllimshëm, pasi automjeti është pasuri e krijuar para detyrës dhe për blerjen e tij kanë pasur burime financiare të ligjshme.

Vlerësimi i Komisionit

5.18 Për sa i përket analizimit të burimit për blerjen e këtij automjeti, duke iu referuar analizës financiare të rishikuar, të ardhurat familjare nga punësimi dhe nga aktiviteti tregtar si person fizik me aktivitet “agjenci informacioni dhe shërbimesh”, janë të mjaftueshme për blerjen e këtij automjeti dhe, për rrjedhojë, personi i lidhur ka pasur burime të ligjshme për blerjen e këtij automjeti.

Në lidhje me konstatimin e dytë, pretendimi i subjektit se nuk e ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë, duke menduar se kontrata e shitblerjes është vetë burim, nuk është bindës, ndërkohë që për pasuri të tjera, për të cilat ka deklaruar kontratën e shitblerjes, subjekti ka deklaruar edhe burimin e krijimit të tyre. Për sa kohë që subjekti ka deklaruar këtë pasuri në

¹²⁴Kontratë shitblerje automjeti nr. *** , datë 3.9.2002.

¹²⁵Shkresë nr. *** prot., datë 10.9.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrtehit Gyqësor Fier.

¹²⁶Kontratë shitblerje automjeti nr. *** , datë 3.9.2002.

¹²⁷Bashkëlidhur deklaratës Vetting: vërtetim nr. *** prot., datë 25.1.2017, nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier; vërtetim nr. *** prot., datë 20.10.2016, nga DRSSH-ja Fier (saktësuar me përlllogaritjet për pagën neto); vërtetim nr. *** prot., datë 25.10.2016, nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier.

deklaratën *Vetting* ka detyrimin ligjor që të deklarojë edhe burimin e ligjshëm të të ardhurave për krijimin e kësaj pasurie.

Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë, për arsye se nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* burimin e krijimit të automjetit me targa *, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet në pikat 1 dhe 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.**

6. Llogari në “ProCredit Bank”, në emër të bashkëshortit, në vitet 2003, 2004 dhe 2005 kanë qenë një llogari rrjedhëse dhe dy llogari kursimi të mbyllura prej tij në datën 3.11.2016. Vlera: 55,568 lekë. Burim i krijimit: të ardhurat nga aktiviteti i shoqërisë “*” sh.p.k.**

6.1 Të njëjtin deklaram si në deklaratën *Vetting*, subjekti dhe personi i lidhur me të, bashkëshorti A.Sh. e kanë bërë edhe në DIPP-në e vitit 2016.

6.2 ILDKPKI-ja nga ana e saj dhe subjekti në përgjigje të pyetësorit standard, kanë depozituar në Komision vërtetimet përkatëse¹²⁸ të “ProCredit Bank”, sipas të cilit z. A.Sh. ka disponuar këto llogari dhe ka mbyllur llogarinë rrjedhëse pranë kësaj banke.

6.3 Sipas dokumentacionit nga “ProCredit Bank”¹²⁹, bashkëshorti i subjektit ka pasur pranë kësaj banke tri llogari bankare dhe dy depozita konkretisht:

a) *Llogari rrjedhëse në USD(dollarë), hapur në datën 26.3.2001 dhe mbyllur në datë 10.4.2011, ku bashkëshorti i subjektit ka depozituar vlerën 10,000 USD në datën 26.3.2001 dhe 5,000 USD në datën 25.4.2001. Këto dy shuma janë tërhequr në datat 5.6.2001 dhe 7.6.2001. Me anë të pyetësorit nr. 2, subjektit iu kërkua të deklarojë burimin e krijimit të këtyre shumave dhe dokumentacioni ligjor justifikues. Subjekti është përgjigjur: “Në qershor të vitit 2001 është lëshuar licenca nga Enti Rregullator i Telekomunikacionit. Bashkëshorti më tregon se për marrjen e licencës ka qenë e nevojshme të kishe gjendje apo kapital, një shumë të caktuar. Meqë ai nuk e dispononte shumën e caktuar, ka marrë borxh nga bashkëshorti i motrës, z. A.V. dhe pas marrjes së licencës, shuma e marrë hua është kthyer me sa kujton ai, brenda vitit.”*

b) *Llogari rrjedhëse në lekë, hapur në datën 24.8.2001 mbyllur në datën 3.11.2016, ku u konstatuan kreditime të vazhdueshme, përgjatë periudhës 10.9.2001 – 12.12.2006, nga persona të tretë për pagesë shërbimesh apo faturash. Nga dinamika e kësaj llogarie, pavarësisht se ajo është në emër individit (A.Sh.), duket se është përdorur në funksion të aktivitetit tregtar që ushtronte. Për këtë arsye, kjo llogari nuk u përfshi në analizën financiare të kryer nga Komisioni.*

c) *Llogari kursimi në lekë, hapur në datën 13.4.2001 mbyllur në datën 3.11.2016, ku nga hetimi¹³⁰ rezultoi se në datën 13.4.2001 është kredituar shuma 6,000,000 lekë nga shtetasi J.Dh. Kjo shumë është tërhequr po gjatë vitit 2001¹³¹. Në pyetësorin nr. 2, subjektit iu kërkuan shpjegime lidhur me arsyen e kësaj transferte, burimin e ligjshëm të shumës dhe marrëdhënien me këtë shtetas. Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar: “Bashkëshorti ka pasur miqësi me babanë e shtetasi J.Dh. (i cili ka ndërruar jetë). Shumën e parave që shtetasi J.Dh. ka transferuar në llogarinë e b/shortit ja ka dhënë b/shorti, i cili e kishte siguruar nga qiraja e bingos dhe kursime të tjera nga puna e kryer, ndër vite, përfshi edhe një periudhë kohe në të*

¹²⁸Vërtetimin datë 3.11.2016.

¹²⁹Shkresë nr. *** prot., datë 27.1.2021.

¹³⁰Shkresë nr. *** prot., datë 1.7.2021, nga “ProCredit Bank”.

¹³¹Në datën 8.6.2001 vlera 1,500,000 lekë, datë 19.6.2001 vlera 500,000 lekë, datë 29.6.2001 vlera 1,000,000 lekë, datë 4.7.2001 vlera 600,000 lekë, datë 20.7.2001 vlera 1,400,000 lekë, datë 24.8.2001 vlera 300,000 lekë dhe në datën 5.9.2001 vlera 700,000 lekë.

cilën bashkëshorti ka qenë emigrant informal". Bashkëlidhur deklarimit, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale¹³² sipas së cilës shtetasi J.Dh. deklaroi se babai M.Dh. ka qenë mik me z. A.Sh. dhe në këto rrethana ky është bërë pjesë e kësaj shoqërie që ka vazhduar edhe pas vdekjes së babait të tij. Në vitin 2001, kur z. A.Sh. po hapte një qendër interneti, J.Dh. shkoi ndonjëherë aty dhe në një nga këto ditë, A.Sh. që në atë moment po merrej me një problem tjetër, i ka kërkuar të shkoi në "ProCredit Bank" dhe të mbyllte shumën 6,000,000 lekë në llogarinë e tij. Në atë kohë banka nuk ka kërkuar asnjë shpjegim në lidhje me shumën dhe ai thjesht ka bërë derdhjen e shumës. J.Dh. dhe babai i tij nuk kanë asnjë lidhje me shumën.

c/1 Lidhur me mundësitë financiare për krijimin e shumës 6,000,000 lekë nga personi i lidhur, siç është konstatuar me lart, deri në këtë fazë të hetimit nuk janë provuar të ardhurat e përfituara në emigracion, ndërsa të ardhurat nga punësimi, për periudhën 1992 – 2000, kanë qenë vetëm në shumën 459,141 lekë.

*c/2 Lidhur me të ardhurat nga qiraja e pajisjeve të bingos, përfaqësuesi i "****" sh.a., në deklaratë noteriale¹³³ deklaroi se për vitin 2001 pagesa u bë totalisht me para në dorë në fillim të kontratës për të gjithë vitin dhe se shoqëria e ka kryer pagesën e detyrimeve tatimore. Nga ana tjetër, subjekti ka deklaruar se: "Të ardhurat e marra nga qiraja u përdorën gjatë aktivitetit të shoqërisë "****" (trajtuar në pikat 2.42-2.59 më lart).*

d) Dy llogari depozitash, me afat 13.4.2001 – 14.5.2001 dhe 30.5.2001 – 8.6.2001, të cilat kanë si burim shumën e transferuar nga shtetasi J.Dh.

d/1 Në pyetësin nr. 5, Komisioni i kërkoi subjektit që të shpjegojë: (i) sa është vlera e të ardhurave nga qiraja e pajisjeve të bingos dhe sa është vlera e të ardhurave nga puna në emigracion, të cilat përfshihen në vlerën totale 6,000,000 lekë; (ii) për çfarë është përdorur shuma 6,000,000 lekë.

d/2 Në lidhje me pyetjen e parë, subjekti është përgjigjur se sipas shpjegimeve të bashkëshortit, shuma 3,000,000 lekë është dhënë me para në dorë nga shoqëria "****" sh. a., në shkurt të vitit 2001 dhe pjesa tjetër në shumën 3,000,000 lekë kursime të familjes dhe puna në emigracion si emigrant informal, gjithsej 6,000,000 lekë u depozituan në bankë me qëllim marrjen e licencës nga ERT/AKEP. Në përgjigje të pyetjes nr.1 të pyetësit nr.5, subjekti ka shpjeguar se shuma 3,100,000 lekë është përdorur për blerjen e pajisjeve kompjuterike për ofrimin e shërbimit internet nëpërmjet agjencisë së shërbimeve dhe "****", për periudhën 2001– 2002, sipas licencave. Bashkëlidhur përgjigjes, subjekti ka depozituar vendimin gjyqësor për regjistrim si person fizik, aplikimin për licencë, licencat nga ERT për "****" sh.p.k. dhe certifikatë regjistrimi tatimor.

d/3. Pra, sipas përgjigjes së dytë, subjekti shpjegon destinacionin e shumës 3,100,000 lekë nga 6,000,000 lekë për të cilën është pyetur. Për diferencën 2,900,000 lekë, subjekti nuk jep shpjegime.

6.4 Komisioni hetoi për ndonjë situatë konflikti interesi të subjektit me shtetasit J. dhe M.Dh., por nga hetimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë¹³⁴.

6.5 Komisioni i kërkoi subjektit që të japë shpjegime në mënyrë sa më të qartë e të përmbledhur për sa duket se: *Subjekti nuk provon arsyen, burimin e krijimit dhe destinacionin e shumave: (i) 6.000.000 lekë, transferuar bashkëshortit nga shtetasi J.Dh.; (ii) 10,000 USD*

¹³²Deklaratën noteriale nr. ***, datë 6.9.2021.

¹³³Deklaratën noteriale nr. ***.

¹³⁴Shkresë nr. *** prot., datë 30.9.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrëhit Gjyqësor Fier.

dhe 5,000 USD të depozituara në “ProCredit Bank” respektivisht në datat 26.3.2001 dhe 25.4.2001, deklaruar të marra hua nga shtetasi A.V.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

6.6 Subjekti ka shpjeguar se shumën që z. J.Dh. ka transferuar në llogarinë e bashkëshortit, ia ka dhënë bashkëshorti për ta depozituar dhe ka si burim të ardhurat që ka siguruar nga qiraja e bingos dhe kursimet e tjera nga puna, ndër vite, përfshirë edhe punën në emigracionin informal. Shumat 10,000 USD dhe 5,000 USD, bashkëshorti ia ka marrë hua bashkëshortit të motrës së subjektit, z. A.V., që i ka siguruar nga shitja e apartamentit me kontratë. Në vijim, subjekti shpjegon se bashkëshorti i saj për të marrë licencën e “****” sh.p.k. ka depozituar në “Fefad Bank” shumat 6,000,000 lekë, 10,000 USD dhe 5,000 USD dhe pasi ka marrë licencën nga ERT-ja në datë 1.6.2001, i ka tërhequr përsëri nga banka dhe ka investuar në “****” sh.p.k., shumën 3,100,000 lekë. Në periudhën mars 2001 – nëntor 2002, bashkëshorti ka ushtruar aktivitetin “agjenci informacioni dhe shërbimesh”, duke paguar detyrimet tatimore, sigurimet shoqërore dhe taksat vendore. Në nëntor të vitit 2002 është krijuar shoqëria “****”, që ka ushtruar aktivitet në Fier dhe është regjistruar në Degën Tatim Taksa Fier.

Për diferencën në shumën 2,900,000 lekë, subjekti shpjegon se shumë 2,000,000 lekë iu paguan z. Sh.B. për blerjen e aparaturave bingo (50% e vlerës) dhe shuma 800,000 lekë për blerjen e automjetit “Land Rover”, me targa ***.

6.7 Bashkëlidhur, subjekti, ndër të tjera, ka depozituar; (i) kontratë shitblerje, datë 14.6.1999¹³⁵, ku A. dhe M.V. i shesin blerësit A.T. në vlerën 1,900,000 lekë, apartamentin nr. ***, në lagjen “****”, Fier; (iii) kontratë shitje apartamenti, datë 17.2.2002¹³⁶, lidhur midis shitësve A.M., H.Ç. dhe blerësit A.V., për blerjen e një apartamenti me sip. 131 m², në vlerën 1,900,000 lekë.

Vlerësimi i Komisionit

6.8 Lidhur me të ardhurat nga qiraja e bingos, Komisioni i ka analizuar në paragrafin 2.42 e në vazhdimësi të këtij vendimi.

6.9 Në lidhje me shumat 10,000 USD dhe 5,000 USD, që subjekti pretendon se ia ka marrë hua bashkëshortit të motrës së saj, z. A.V., subjekti ka depozituar dokumentacion provues për të provuar të ardhurat që kanë shërbyer për huan e dhënë.

Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm burimin e shumave 10,000 USD dhe 5,000 USD, të depozituara në “ProCredit Bank”, në vitin 2001.

7. Të ardhura cash, në vlerën 100,000 lekë. Burimi i krijimit: të ardhurat nga pagat.

7.1. Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti deklaroi: “Të ardhura cash në vlerën 300,000 lekë të siguruara nga pagat e mia, të bashkëshortit, djalit dhe qiraja e ambientit tek ish-hotel “****” në vitin 2012. Vlera: 350,000 lekë”.

7.2. Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti deklaroi: “Të ardhura cash në datën 31.12.2016, vlera 100,000 lekë. Burimi i krijimit: të ardhurat nga pagat e gjithë familjarëve”.

7.3. Meqenëse gjendja e deklaruar në deklaratën Vetting përputhet me atë të deklaruar në DIPP-në e vitit 2016, duket se subjekti deklaroi gjendjen e likuiditeteve cash dhe nuk deklaroi shtesa/pakësime. Për rrjedhojë, në analizën financiare u konsiderua gjendje e

¹³⁵Kontratë shitblerje nr. ****, datë 14.6.1999.

¹³⁶Kontratë shitblerje nr. ****, datë 14.6.1999.

likuiditeteve *cash* në vlerën 350,000 lekë në fund të vitit 2015 dhe në vlerën 100,000 lekë në fund të vitit 2016.

7.4. Komisioni kreu analizën financiare për të ardhurat, pasuritë dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, për vitin 2015 dhe 2016 të paraqitur në tabelën në vijim.

Tabela nr. 5 – Analiza financiare e vitit 2015 dhe 2016

Përshkrim	Viti 2015	Viti 2016
Gjendje <i>cash</i> datë 1 janar	0	350,000
Gjendje likuiditete në bankë datë 1 janar	-66,648	-94,902
Likuiditete datë 1 janar	-66,648	255,098
Gjendje <i>cash</i> dt. 31 dhjetor	350,000	100,000
Gjendje likuiditete në bankë në datën 31 dhjetor	-94,902	-141,695
Likuiditete në datën 31 dhjetor	255,098	-41,695
Të ardhura nga pagat subjekti	1,249,722	1,171,768
Të ardhura nga pagat bashkëshorti	788,855	737,061
Të ardhura nga pagat djali	335,160	512,400
Të ardhura nga qiraja	96,350	82,150
Total të ardhura	2,470,087	2,503,379
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT	897,104	940,368
Shpenzime qiraje	105,000	105,000
Shpenzime për udhëtime nga sistemi <i>TIMS</i>	79,362	96,722
Shpenzime për pagesën e kredisë (principal, interesa, shpenzime të tjera)	256,887	239,890
Shpenzime mjekësore	0	405,810
Total shpenzime	1,338,354	1,787,790
Balanca e fondeve (të ardhura + shpenzime - likuiditete në fund + likuiditete në fillim)	809,987	1,012,382

Duket se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e shtesës së kursimeve dhe kryerjen e shpenzimeve gjatë vitit 2015 dhe 2016.

8. Të ardhura nga qiraja e pasurisë nr. *, në periudhën 1.4.2015 – 31.12.2016. Vlera: 178,500 lekë.**

8.1 Në DIPP-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar të ardhura nga dhënia me qira e apartamentit në ish-hotel “***”, Fier, për periudhën 2.5.2012 – 31.12.2012. Vlera: 175.000 lekë.

8.2 Në DIPP-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar të ardhura nga dhënia me qira e kësaj pasurie, për periudhën 1.1.2013 – 31.12.2013, në vlerën 300.000 lekë.

8.3 Në DIPP-në e vitit 2015, të ardhura nga qiraja për 11 muaj pas pagesës së detyrimeve tatimore në vlerën 96,350 lekë.

8.4 Në DIPP-në e vitit 2016 – për 12 muaj, në vlerën 82.150 lekë.

8.5 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: (i) kontratë qiraje¹³⁷ me qiramarrësin G.P., për pasurinë me sip. 36.5 m², për një afat 3-vjeçar, kundrejt çmimit 200 euro/muaj (për 6 muajt e parë 25.000 lekë/muaj); (ii) kontratë qiraje¹³⁸ me qiramarrësin M.Sh. me afat 1-vjeçar, 1.4.2015 – 1.4.2016, me vlerën 10,000 lekë/muaj; (iii) deklaratë noteriale¹³⁹, ku z. A.Sh. deklaroi se kontrata e qirasë, datë 23.3.2015, është rinovuar deri në datën 31.12.2017 me të

¹³⁷Kontratë qiraje nr. ***, datë 2.5.2012.

¹³⁸Kontratë qiraje nr. ***, datë 23.3.2015.

¹³⁹Deklaratë noteriale nr. ***, datë 6.8.2016.

njëjtat kushte; (iv) vërtetim¹⁴⁰ i DRT-së Fier, sipas së cilës shtetasi A.Sh. ka paguar tatim mbi qiranë për periudhën prill 2015 – 31.12.2016.

8.6 Gjatë hetimit për ndonjë situatë konflikti interesi të subjektit me shtetasin G.P. dhe M.Sh., Komisioni nuk konstatoi ndonjë situatë të tillë.

8.7 Referuar të ardhurave nga marrëdhëniet e qirasë, Komisioni pasqyroi në analizën financiare vetëm ato të ardhura të deklaruara në deklaratat përkatëse të pasurisë dhe për të cilat u vërtetua pagesa e detyrimeve tatimore.

9. Të ardhurat nga shitja e aparaturave të bingos subjektit “**” sh.p.k., P.,** blerë në vitin 2000 me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 8.10.2000, nga subjekti “****” sh.p.k. Vlera: 1,900,000 lekë *(trajtuar në pikat 2.18 – 2.41 më lart)*.

❖ Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë

10. Kredi në BKT, dega Fier, në shumën 4,450,000 lekë, në datën 18.5.2006, me kontratë nr. ***, datë 17.5.2006, me këst 41.000 lekë/lekë, me afat 20 vjet e mbyllur në datën 15.11.2011 *(trajtuar në pikat 2.56 – 2.63 te pasuria nr. *** më lart)*.

11. Kredi në BKT, dega Fier, përfituar nga Bashkia Fier me kushte lehtësuese, datë 14.11.2011, në shumën 3,590,000 lekë, me afat shlyerje 20 vjet, me këst 20,000 lekë/muaj, për blerjen e pasurisë nr. ***, ZK ***. Vlera: 2,861,002 lekë *(trajtuar në pasurinë e dytë)*.

❖ KONSTATIME TË TJERA PËR SUBJEKTIN

12. Të ardhurat nga filiali “**”,** i regjistruar në Degën e Tatimeve Fier për 6 muaj që ushtrohej në lokal me qira nga S.P., vendndodhja lagjja “****”, Fier. Vlera: 600,000 lekë. Është deklaruar në DIPP-në e vitit 2005.

12.1 Në pyetësoin nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektit: (i) të shpjegojë mënyrën e ushtrimit të këtij aktiviteti; (ii) të provojë me dokumentacion ligjor regjistrimin e tij në gjykatë dhe në organet tatimore; si dhe (iii) të ardhurat e realizuara prej tij çdo vit. Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar se bashkëshorti ka qenë i punësuar pranë kësaj shoqërie. Informacionin që kemi mundur të sigurojmë është vetëm ai bashkëlidhur shkresave: (i) vërtetim vjetërsie¹⁴¹ i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier, që konfirmon të ardhurat që z. A.Sh. ka realizuar nga punësimi pranë subjektit “****” Fier (1.9.1993 – 31.12.1993), pranë “****”, Lushnjë (1.8.1996 - 30.4.1997), nga subjekti “****”, Fier (1.11.2002 - 30.6.2008); (ii) shkresa¹⁴² e Drejtorisë së Përgjithshme e Tatimeve, e cila i përgjigjet subjektit se: *“Rezulton...i regjistruar tatimpaguesi ‘***’ sh.a., me NIPT ***. Ky tatimpagues ka të deklaruar si adresa të ushtrimit të aktivitetit në qytetin Fier për vitet e referuara nga ju, por të dhënat e sistemit tonë tatimor nuk janë të plota për t’i konfirmuar si të njëjta. Gjithashtu në dosjen fizike të këtij tatimpaguesi pranë arshivës së DRT-së Tiranë nuk u gjetën të dhëna apo dokumentacion mbi regjistrimin e adresave dytësore në qytetin e Fierit, të cilat në shkresën tuaj referohen me nr. *** dhe nr. ***”*.

12.2 Komisioni i kërkoj subjektit që të shpjegojë në mënyrë të qartë dhe të përmbledhur, për sa duket, që subjekti nuk ka depozituar asnjë dokument që provon regjistrimin e këtij aktiviteti dhe të ardhurat prej tij dhe, për rrjedhojë, këto të ardhura nuk u paraqitën në analizën financiare.

Qëndrimi i subjektit

¹⁴⁰Vërtetim nr. *** prot., datë 9.1.2017, i DRT-së Fier.

¹⁴¹Vërtetim vjetërsie nr. *** prot., datë 20.10.2016, nga DRSSH-së Fier.

¹⁴²Shkresë nr. *** prot., datë 2.9.2021, DP Tatimeve.

12.3 Në lidhje me këtë konstatim, subjekti ka shpjeguar se bashkëshorti ka pasur të ardhura nga filiali “****” si aktivitet me nipt sekondar, të cilin sot nuk e disponon. Ky aktivitet ka qenë i hapur në kohën e deklaramit të DIPP-së 2005, por aktualisht nuk gjenden të dhëna në organet tatimore. Subjekti nuk ka paraqitur prova të reja, por pretendon se ndodhet në rastet e parashikuara nga neni 32/2 i ligjit nr. 84/2016, kur subjekti nuk ka mundësi të sigurojë informacionin, pasi organet kompetente për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar nuk kanë ruajtur të dhënat, prandaj të ardhurat e bashkëshortit në vlerën 600,000 lekë duhet të përfshihen në analizën financiare.

Vlerësimi i Komisionit

12.4 Komisioni vlerëson se neni 32/2 i ligjit nr. 84/2016 përcakton: “Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër.” Në rastin konkret, në shkresën nr. *** prot., datë 2.9.2021 DP Tatimeve konfirmon se të dhënat e sistemit tonë tatimor nuk janë të plota” dhe nuk u gjetën të dhëna apo dokumentacion mbi regjistrimin e adresave dytësore, por nuk citon se dokumentet janë zhdukur apo kanë humbur. Për këtë arsye, shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse për Komisionin.

Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti nuk ka depozituar asnjë dokument që provon regjistrimin e aktivitetit “**”, në Fier dhe të ardhurat e përfituara prej tij dhe për rrjedhojë, këto të ardhura nuk u morën në konsideratë në analizën financiare, në respektim të pikës 1, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 dhe në kushtet e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 5/b, të nenit 33, të këtij ligji, subjekti ka kryer deklaramit të pamjaftueshëm.**

13. Të ardhura nga subjekti “**” sh.p.k., me objekt shërbim interneti dhe regjistruar në Degën e Tatimeve Fier, aktivitet që ushtrohet në një lokal me qira te pallati pranë Prefekturës Fier, nga shtetasi B.Sh. me banim në Fier. Aktivitet që ushtrohet nga bashkëshorti. Vlera: 150,000 lekë. Është deklaruar në DIPP-në e vitit 2005 (trajtuar në pikën 2.60 – 2.63 te pasuria nr. 2 më lart).**

14. Apartament nr. *, me sip. 95 m², pasuria nr. ***, z. k. ***, p. ***, shk. ***, k. ***, lagjja “****”, Tepelenë. Pjesa subjektit 1/5, pjesa bashkëshortit të subjektit 7/30 dhe disa bashkëpronarë. Burimi i krijimit: me kontratë privatizimi nr. ***, datë 6.12.1993.**

14.1 Ky apartament është konstatuar nga kontrata e shitjes e datës 18.10.2013¹⁴³ e dërguar në Komisionit nga noteri P.Xh. Sipas kësaj kontrate rezulton se bashkëpronarët e këtij apartamenti shtetasit D.S., A.Sh. dhe A.G. (motrat e bashkëshortit të subjektit) i shesin pjesën e tyre nënës R.Sh. dhe pas këtij veprimi bashkëpronarë të apartamentit mbeten shtetasit R.Sh. (7/30), A.Sh. (7/30), Violeta Shkurta (1/5) dhe M.N. (91/30).

14.2 Në pyetësorin nr. 5, Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegojë përse ajo dhe bashkëshorti nuk e kanë deklaruar asnjëherë këtë apartament. Subjekti është përgjigjur se ka lidhur martesë me bashkëshortin në datën 15.6.1992 në Zyrën e Gjendjes Civile në qytetin Fier dhe gjatë gjithë kohës kanë banuar në qytetin Fier. Nuk ka banuar asnjëherë në qytetin Tepelenë, ku ka banuar familja e bashkëshortit dhe që kanë në pronësi këtë apartament. Bashkëshorti prej vitit 1985 është larguar nga shtëpia, kur ka ndjekur arsimin e lartë në Shkollën e Policisë në Tiranë deri kur është caktuar me punë në Fier. Subjekti shpjegon se ka pasur dijeni që familja e bashkëshortit ka apartament në Tepelenë të përfituar nga privatizimi, por nuk ka pasur dijeni që është përfituese në këtë apartament. Apartamenti është përfituar nga familja e bashkëshortit me kontratë privatizimi nr. ***, datë 6.12.1993. Në këtë moment

¹⁴³Kontrata e shitjes nr. ***, datë 18.10.2013.

subjekti është njohur me kopje të kontratës së shitjes, datë 18.10.2013¹⁴⁴, nga përmbajtja e së cilës konstaton se motrat e bashkëshortit i kanë shitur nënës së tyre pjesët takuese pas vdekjes së babait. Subjekti shpjegon se nuk ka asnjë dijeni për këtë kontratë të motrave të bashkëshortit sepse nëna e tij ka banuar dhe vazhdon të banojë në apartamentin e saj në qytetin Tepelenë. Përfshirja ime dhe e bashkëshortit në certifikatën e pasurisë është kryer pasi ne mund të kemi qenë gabimisht në regjistrin e gjendjes civile pas martesës për gabime materiale të punonjësve të gjendjes civile që nuk kanë ndryshuar gjendjen tonë civile pas martesës. Bashkëlidhur përgjigjeve, subjekti ka depozituar vendimin nr. ***, datë 29.6.1991, të Komitetit Ekzekutiv Pluralist të qytetit Fier për dhënien e lejes së përhershme të banimit z. A.Sh. së bashku me familjen e tij (pjesëtarë ai dhe subjekti) në qytetin Fier.

14.3 Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit që të japë shpjegime për sa duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, nuk kanë deklaruar pjesën takuese në bashkëpronësi në apartamentin me sip. 95 m², pasuria nr. ***, z. k. ***, p. ***, shk. ***, k. ***, lagjja ‘***’, Tepelenë”.

Qëndrimi i subjektit

14.4 Në lidhje me këtë konstatim, subjekti jep të njëjtat shpjegime si në përgjigjen e pyetësorit nr. 5, si dhe ka bashkëlidhur: (i) certifikatën e martesës, datë 1.11.2021, që provon kohën e martesës së saj me shtetasin A.Sh., datë 15.6.1992, në Zyrën e Gjendjes Civile Fier; (ii) shkresën nr. *** prot., datë 29.7.2021, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që provon se që nga viti 1989 ka qenë i punësuar në Fier; (iii) librezën e punës së subjektit, ku rezulton e punësuar që nga qershori 1992 si oficere e policisë gjyqësore pranë Prokurorisë së Rrethit Fier.

Vlerësimi i Komisionit

14.5 Nisur nga faktet që rezultojnë prej provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni vëren se martesa e subjektit është lidhur në datën 15.6.1992 në Fier, ndërkohë që kontrata e privatizimit është lidhur në datën 6.12.1993, për një apartament që ndodhet në Tepelenë, në të cilin subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë jetuar asnjëherë. Subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë nënshkruar kontratën e shitjes, datë 18.10.2013, si bashkëpronarë që duhet të japin pëlqimin për shitjen e pjesëve të bashkëpronarëve të nëna e tyre.

Për këto arsye, për sa më lart, Komisioni krijoi bindjen se subjekti me bashkëshortin nuk kanë pasur dijeni për këtë apartament dhe as për bashkëpronësinë e tyre mbi të, prandaj nuk mund të ngarkohen me përgjegjësi për mosdeklarimin e pjesëve të tyre takuese në këtë pasuri.

❖ Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë

15. Subjekti i rivlerësimit, në DIPP-në e vitit 2011 ka deklaruar: *“Në prill 2011 kam përfituar kredi me kushte lehtësuese në shumën 4,404,960 lekë për blerje apartamenti. Kreditë e kam përdorur për të shlyer kreditë e mëparshme që kisha marrë në BKT, dega Fier, në vitin 2006, për të blerë të njëjtin apartament të ndodhur në lagjen ‘***’, Fier. Duke përdorur kreditë e marrë me kushte lehtësuese, e likuidova kreditë e vitit 2006 në datë 15.12.2011. Kredia e re në shumën 3,590,000 lekë ka afat shlyerjeje 20 vjet, me këst 20,000 lekë/muaj. Kam paguar për kreditë gjithsej 548,000 lekë (për kreditë e vitit 2006). Rimbursuar për kreditë e vitit 2006 shumën 520,000 lekë. Gjithsej paguar për kredi shumën 1,088,000 lekë. Gjendja e detyrimit të mbetur pa shlyer deri në datën 31.12.2011 është 4,146,770 lekë” (trajtuar në pikën 2.103 më lart).*

❖ Shpenzime të deklarueshme

¹⁴⁴Kontratës së shitjes nr. ***, datë 18.10.2013.

16. Shpenzime shkollimi për djalin R.Sh., në vlerën 261,000 lekë

16.1 Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar shpenzime në vlerën totale 261.000 lekë, për shkollimin e djalit R.Sh., në shkollën jopublike “****”, Fier, gjatë periudhës 2007 – 2009 dhe ka bashkëlidhur vërtetimin përkatës. Gjithashtu, ka deklaruar arsimimin e djalit Redi Shkurta dhe vajzës B.Sh. në institucione të tjera arsimore publike.

16.2 Përgjatë hetimit, subjekti ka depozituar disa dokumente¹⁴⁵, ku rezulton se ka kryer shpenzime për shkollim në institucion privat vetëm për djalin R.Sh., në vlerën 261,000 lekë, në shkollën jopublike “****”, Fier, gjatë periudhës 2007 – 2009.

16.3 Në përfundim, Komisioni pasqyroj në analizë financiare shpenzimet e shkollimit dhe akomodimit të fëmijëve të subjektit, përgjatë kohës së studimeve, sipas dokumentacionit dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti.

❖ Personi i lidhur me subjektin/ A. Sh. (bashkëshorti)

17. Pasuria apartament me nr. *, vol. ***, f. ***, z. k. ***, pasuri e paluajtshme në ZVRPP-në Fier, e përfituar nga privatizimi me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 23.2.2011. Vlera e apartamentit 0 (zero) lekë, kurse vlera e truallit 174,802 lekë. Pjesa takuese: 50%. **Burim i krijimit:** të ardhurat huamarrje.**

18. Apartament banimi me sip. 180.3 m², me nr. *, vol. ***, f. ***, z. k. ***, pasuri e paluajtshme në ZVRPP-në Fier, në datën 16.5.2006. Blerë me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 19.4.2006. Hipotekuar në favor të BKT-së, dega Fier, në datën 17.5.2006. Vlera: 8,060,000 lekë (sqarim i subjektit: “Në lidhje me vlerën e apartamentit sqaroj se në kontratën e shitblerjes, vlera e apartamentit është 8,460,000 lekë, kontrata është lidhur me qëllim marrjen e kredisë, por apartamenti ishte i papërfunduar. Në vazhdim të punimeve dhe në marrëveshje me firmën ndërtuese disa punime në vlerën 400,000 lekë nuk u kryen”). **Burimi i krijimit:** kredi në BKT, dega Fier, datë 17.5.2006. Të ardhurat nga shitja e aparaturave të bingos “AS”, blerë në vitin 1999.**

19. Automjet tip “Audi” me targa * .**

20. Automjet tip “Fiat” me targa * .**

21. Automjet tip “Land Rover” me targa *.**

22. Në “ProCredit Bank”, në vitet 2003, 2004 dhe 2005 kanë qenë një llogari rrjedhëse dhe një llogari kursimi të mbyllura prej saj në datën 3.11.2016. Vlera: 55,568 lekë.

23. Të ardhura cash në vlerën 100,000 lekë.

24. Dëmshpërblim 1 vit pagë, përfituar me vendimin nr. *, datë 7.2.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, shuma totale 538,560 lekë, nga të cilat ka tërhequr në datën 7.12.2012, në “Raiffeisen Bank”, shumën prej 200,000 lekësh.**

24.1 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën *Vetting* vendimin gjyqësor nr. ***, datë 7.2.2006. Në dokumentacionin e përcjellë nga “Raiffeisen Bank”, konstatohet se në datën 7.12.2012 është transferuar vlera 200,000 lekë në llogarinë e bashkëshortit me përshkrimin “Zyra e Përmbarimit Tiranë, detyrim i Ministrisë së Rendit”. Komisioni përfshiu në analizën financiare të vitit 2012, shumën 200,000 lekë.

¹⁴⁵Vërtetim nr. *** e nr. *** prot., datë 18.8.2021, i shkollës “****”, qyteti Fier për R. dhe B. Sh. ; informacion nr. *** prot., datë 20.8.2021, i Gjinnazit “****”, Fier, për fëmijët R. Sh. dhe B. Sh.; vërtetim nr. *** prot., datë 24.08.2021, i shkollës 9-vjeçare “****”, Fier, për vajzën B. Sh.; diploma Bachelor e djalit R. Sh. nga Universiteti i Shkencave natyrës Tiranë; diploma e vajzës B. Sh. nga Fakulteti Mjekësisë Tiranë.

Konstatohet se deklarimi i personit të lidhur përputhet me dokumentacionin e depozituar.

25. Të ardhura në vitet 1994 – 1996 dhe 1998 , bashkëshorti i subjektit. Vlera: 7,100,000 lekë.

25.1 Bashkëshorti i subjektit ka deklaruar se: *“Në vitet 1994 – 1996 dhe 1998, kam punuar në emigracion në Greqi. Kam kaluar ilegalisht dhe ka punuar në të zezë si pjesa më e madhe e emigrantëve). Të ardhura nga emigracioni dhe nga puna si menaxher në disa bingo në Lushnjë dhe në Fier. Vlera: 7,100,000 lekë”* (trajtuar në pikat 2.25 – 2.29 dhe 2.40 – 2.41 te pasuria nr. 2 më lart).

26. Të ardhura nga qiraja e pasurisë me nr. *, në periudhën 1.4.2015 – 31.12.2016. Vlera: 178,500 lekë.**

27. Të ardhurat nga shitja e aparaturave të bingos subjektit “**” sh.p.k., P., blerë në vitin 2000 me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 8.10.2000, nga shoqëria “****” sh.p.k. Vlera: 1,900,000 lekë** (pasuritë nr. 26 dhe nr. 27 janë trajtuar te pasuritë e subjektit të rivlerësimit Violeta Shkurta, më lart).

❖ **Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë**

Konstatime të tjera për personin e lidhur A. Sh. /bashkëshorti

28. Pasuri e luajtshme me vlerë 2,200,000 lekë, pjesa takuese 100%, krijuar në vitin 2004. Nuk ka deklaruar burim krijimi.

28.1 Kjo pasuri është deklaruar në DIPP-në e vitit 2004.

28.2 Sipas procesverbalit datë 9.2.2016, subjekti është pyetur nga ILDKPKI-ja rreth këtij deklarimi dhe ka shpjeguar se kjo vlerë është përfituar nga bashkëshorti i saj para vitit 2003 për shkak të ofrimit të internetit nga ***. Në vijim, subjekti shpjegon se në vitin 2004 ka paraqitur statement që vërtetojnë këto vlera dhe tërheqjen e tyre, si dhe i ka deklaruar me qëllim burimin e aktivitetit të tij.

28.3 Duke qenë se në DIPP-të e viteve pasardhëse, subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar pakësimin e kësaj shume, me anë të pyetësorit nr. 2, Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegojë: (i) mospërputhjen e deklarimeve të saj në DIPP-në e vitit 2004 me ato para ILDKPKI-së për kohën e krijimit të kësaj pasurie; (ii) kur dhe për çfarë është përdorur kjo shumë.

28.4 Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar se shuma prej 2,200,000 lekësh është përfituar nga bashkëshorti nga një projekt i ***, i realizuar nga shpërndarja e internetit në disa institucione shtetërore Fier-Gjirokastrë, në subjektin “****” sh.p.k. Shuma është kaluar nëpërmjet sistemit bankar në vitin 2004 për shoqërinë “****” sh.p.k. me administrator dhe ortak të vetëm shtetasin A. Sh.. Në procesverbalin e ILDKPKI-së, për shkak të kohës së gjatë që kishte kaluar dhe për shkak se nuk dispononte dokumentacionin e plotë, ka deklaruar gabimisht se është përfituar përpara vitit 2003.

28.5 Nga verifikimi i llogarive në “ProCredit Bank”, Komisioni konstaton se në llogarinë me nr. *** (trajtuar edhe në pikën 0), gjatë vitit 2004 është tërhequr vlera 1,300,000 lekë, me burim transferta nga të tretë, e cila duket se është në funksion të aktivitetit tregtar. Ndërkohë që gjatë vitit 2003 është tërhequr vlera 2,200,000 lekë, e cila gjithashtu ka si burim transferta nga të tretë që duket të jenë në funksion të aktivitetit tregtar.

28.6 Komisioni nuk e pasqyroi vlerën 2,200,000 lekë, si gjendje *cash* në fund të vitit apo si të përdorur në vijim, duke qenë se, sipas deklaramit të subjektit, ka qenë likuiditet i përfshirë në aktivitetin tregtar të bashkëshortit. Kjo bazohet në parimet e kontabilitetit, të cilat rregullojnë

transaksionet e shitje-blerjes së mallrave dhe shërbimeve, veprimet e arkës, bankës, inventarit dhe çdo transaksioni tjetër, pjesë e aktivitetit tregtar, efektet e të cilave reflektohen tek pasqyrat financiare në fund të vitit ushtrimor, duke pasqyruar fitimin ose humbjen e njësisë së biznesit. Ky rezultat financiar është analizuar nga Komisioni në seksionin përkatës.

29. Huamarrje e tokës bujqësore me sip. 1.500 m² nga shtetasi A. S., për ekonomi bujqësore familjare, viti 2016. Deklaruar në përgjigje të pyetësorit standard.

29.1 Subjekti ka depozituar në Komision, për efekt të pyetësorit standard, kontratë të thjeshtë huapërdorje (pa datë) të lidhur midis huadhënësit M. G. dhe huapërdorësit A. Sh., sipas së cilës shtetasi A. Sh. ka marrë në huapërdorje pa kundërshpërblim, tokë bujqësore me sip. 1.500 m² për ekonomi bujqësore familjare, në Njësinë Administrative ***, Fier. Afati i huapërdorjes është periudha 1.1.2016 – 31.12.2020.

29.2 Në pyetësorin nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektit që të shpjegojë lidhjen e saj dhe të bashkëshortit me shtetasin M. G., si dhe të provojë titullin e pronësisë së tij mbi tokën që u ka dhënë në huapërdorje që nga data 1.1.2016 deri më sot. Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar: *“Bashkëshorti ka marrë në përdorim tokën bujqësore nga shtetasi M. G. me sip.1.500 m² për ekonomi bujqësore familjare. Bashkëshorti ka për qëllim të blejë tokën bujqësore dhe shtetasi M. G. është i interesuar ta shesë. Bashkëshorti është në pritje të daljes së certifikatës së pronësisë në emër të pronarit M. G. për të realizuar blerjen, pasi posedon vetëm formularin nr. 6”*. Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti ka depozituar: (1) kontratë të thjeshtë huapërdorje (rinovim i kontratës) pa datë, si dhe një listë emërore ku është emri i shtetasit M.G. dhe disa emra kufitarësh, por jo AMTP në përdorim ose në pronësi apo certifikatë pronësie që të vërtetojë titullin e pronësisë së shtetasit M.G. mbi tokën bujqësore. Subjekti nuk ka shpjeguar lidhjen e saj dhe të bashkëshortit me shtetasin M.G., përveç marrëdhënies së huapërdorjes pa kundërshpërblim.

29.3 Në pyetësorin nr. 3, Komisioni i ka kërkuar subjektit që të shpjegojë se përse nuk e ka deklaruar këtë huapërdorje në deklaratën *Vetting*. Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar se në momentin që ka plotësuar deklaratën *Vetting*, nuk e ka ditur faktin që bashkëshorti ka marrë në huapërdorje tokë bujqësore me sip. 1.500 m². Në datën 26.9.2016 ka kryer ndërhyrje kirurgjikale dhe për disa muaj ka qëndruar në regjim shtrati. Për këto arsye nuk e ka deklaruar huapërdorjen në deklaratën *Vetting*. Subjekti shpjegon se është vënë në dijeni në vitin 2018 kur bashkëshorti ka plotësuar deklaratën për procesin e rivlerësimit të punonjësve të policisë dhe gjatë marrjes së dokumentacionit për këtë deklaratë, konkretisht, vërtetimet për shlyerjen e detyrimeve të OSHEE-së dhe Ujësjiellësit është kujtuar për faktin që kishte lidhur me ndërmarrjen Ujësjiellës Kanalizime kontratën për furnizim me ujë për tokën bujqësore. Në këtë moment ka rënë në dijeni të faktit që bashkëshorti ka marrë në huapërdorje tokë bujqësore me sip.1.500 m². Bashkëshorti i ka sqaruar se kishte harruar t’i tregonte për këtë fakt për shkak se me pronarin e saj kishte rënë në marrëveshje që sapo ai të marrë certifikatën e pronësisë së tokës, të kryejnë edhe shitblerjen. Pasi ka rënë në dijeni, subjekti e ka pasqyruar këtë fakt në DIPP-në e vitit 2018 duke i bashkëlidhur edhe kontratën e huapërdorjes.

29.4 Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti ka depozituar vërtetimin¹⁴⁶ e Drejtorisë Vendore të Policisë Fier që vërteton dokumentacionin që ka paraqitur bashkëshorti i subjektit në kuadrin e procesit të vlerësimit kalimtar të punonjësve të policisë, si dhe librezën e pagesës së konsumit të ujit për tokën bujqësore.

29.5 Gjatë hetimit për konflikt interesi me shtetasin M.G., Komisioni administroi shkresën¹⁴⁷ ku rezulton se me vendimin datë 18.4.2021 të Prokurorisë Fier është pushuar procedimi penal

¹⁴⁶Vërtetimin nr. ***, datë 6.5.2018, e Drejtorisë Vendore të Policisë Fier.

¹⁴⁷Shkresa nr. *** prot., datë 10.9.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

nr. *** në ngarkim të këtij shtetasi, i hetuar nga subjekt tjetër, prokurore E.H. Pra, nuk rezultoi konflikt interesi.

29.6 Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenet Ç dhe D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën për sa duket se, subjekti nuk e ka deklaruar huapërdorjen e tokës bujqësore në deklaratën *Vetting*.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

29.7 Në lidhje me këtë konstatim, subjekti i është përmbajtur shpjegimeve të dhëna në përgjigje të pyetësorit nr. 3 dhe kërkon të mbahet parasysh nga Komisioni vetë praktika e këtij të fundit, sipas së cilës gabimet që nuk lidhen me anën subjektive nuk përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore. Bashkëlidhur subjekti ka depozituar: (i) shkresën nr. *** prot., datë 4.11.2021, të UK Fier ku rezulton se bashkëshorti i saj në datën 18.1.2016 ka lidhur kontratë për pagimin e furnizimit me ujë, jo si konsumator familjar por si biznes; (ii) kontratën nr. *** për shërbim ujësjellës kanalizim, si dhe akte të tjera të paraqitura gjatë hetimit.

Vlerësimi i Komisionit

29.8 Komisioni vlerëson se pavarësisht nga padijenja e subjektit, bashkëshorti, me cilësinë e personit të lidhur, kishte detyrimin ligjor që ta deklaronte këtë huamarrje, pasi pikat 11 dhe 19, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016 përcakton se objekt deklarimi janë pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to që ndodhen në pronësi dhe në përdorim të subjektit të rivlerësimit. Por, pavarësisht kësaj, Komisioni mban në konsideratë faktin se kemi të bëjmë me një pasuri të paluajtshme të pa regjistruar në regjistrat e pasurisë në ASHK Fier, me një kontratë huapërdorje pa elementët e domosdoshëm të karakterit formal sic është data e hartimit të kontratës, faktin se kjo marrëdhënie është deklaruar më vonë, si në DIPP-në e vitit 2018 ashtu edhe në përgjigje të pyetësorit standart.

Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se personi i lidhur me subjektin, bashkëshorti i saj, ka kryer deklarim të pasaktë në lidhje me marrëdhënien e huapërdorjes të tokës bujqësore.

❖ Personi i lidhur me subjektin/R.Sh., i biri

Konstatime të tjera për personin e lidhur R.Sh.

30. Blerje automjeti tip “Opel Corsa”, data e blerjes 31.1.2014, me kontratë nr. *. Vlera: 50,000 lekë.** Dhuratë për ditëlindje në datën 19.12.2013. Shitje automjeti me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 4.9.2014. Vlera: 2,000 euro (paratë iu dorëzuan babait).

30.1 Kjo pasuri është deklaruar në DIPP-në e vitit 2014.

30.2 DPSHTRR-ja¹⁴⁸ ka depozituar në Komision, ndër të tjera: (i) deklaratë shitjeje datë 23.11.2009, sipas së cilës shitësi C.K. i shet shtetasit P.L. automjetin tip “Opel Corsa” me vlerën 600 euro; (ii) akt zhdoganimi datë 30.11.2009, ku figuron dërgues shtetasi C.K., ku në total vlera e automjetit në datën e zhdoganimit është 210,013 lekë; (iii) kontratë dhurimi¹⁴⁹ ku z. P.L. i dhuron znj. A.L. pronësinë mbi ½ e automjetit; (iv) kontratë shitblerjeje¹⁵⁰ me blerës R.Sh. dhe shitës P. dhe A.L., për automjetin tip “Opel Corsa”, me targa ***, me vlerë 50,000 lekë; (v) kontratë shitblerjeje e automjetit¹⁵¹ ku shitësi R.Sh. i shet blerësit D.G. automjetin

¹⁴⁸Shkresë nr. *** prot., datë 26.1.2021, të DPSHTRR-së.

¹⁴⁹Kontratë dhurimi nr. ***, datë 9.12.2009.

¹⁵⁰Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 31.1.2014.

¹⁵¹Kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 4.9.2014.

në vlerën 2,000 euro, e likuiduar jashtë zyrës së noterisë. Rezulton se diferenca nga çmimi i blerjes të çmimi i shitjes është 229,200 lekë.

30.3 Në pyetësin nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektit që të shpjegojë se: (i) kush ia ka bërë dhuratë automjetin djalit të saj për ditëlindje; (ii) a është paguar tatimi mbi fitimin e realizuar në vlerën 229,200 lekë nga shitja e automjetit; (iii) cila është lidhja midis subjektit apo familjarëve të saj dhe bashkëshortëve P. dhe A.L. (shitësve të automjetit tip “Opel Corsa”). Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar se me kontratën nr. *** rep., datë 31.1.2014, djali R.Sh. ka blerë automjetin tip “Opel Corsa” në shumën 50,000 lekë dhuratë (me lekët e dhuruara nga të afërmit për ditëlindjen e tij datë 19.12.2013). Automjetin e ka gjetur bashkëshorti dhe e ka blerë djali. Vlera 229,200 lekë nuk është fitim dhe nuk mendon se diferenca ndërmjet çmimit të shitjes edhe atij të blerjes nuk është e ardhur e tatueshme. Subjekti shpjegon se ajo dhe djali i saj nuk i njohin fare shtetasit P. dhe A.L. Bashkëshorti i njeh si qytetarë dhe ka qenë në djalëni që kishin automjetin për të shitur.

30.4 Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti ka depozituar shkresën¹⁵² e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, sipas së cilës konfirmohet se subjekti Violeta Shkurta nuk është subjekt i nenit 6 “Fusha e veprimet të tatimit mbi të ardhurat personale” të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Tatimi mbi të ardhurat” për veprimet e kryera në vitin 2014 në lidhje me transaksionin e kërkuar në shkresën e saj.

30.5 Gjatë hetimit për konflikt interesi midis subjektit dhe shtetasve D.G., P. dhe A.L., Komisioni administroi shkresën¹⁵³ nga e cila rezulton se me këta persona nuk ka situata të konfliktit të interesit.

30.6 Referuar jurisprudencës së Kolegjtit të Posaçëm të Apelimit¹⁵⁴, germa “g”, e pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 8438/1998), përcaktojnë se: *“Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale merren si të ardhura të tatueshme të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë, ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë”*. Sa më sipër, të ardhurat e realizuara nga shitja me fitim e pasurive të luajtshme nuk bëjnë pjesë në të ardhurat e përjashtuara nga neni 8/1 i të njëjtit ligj. Në rastin konkret konstatohet se nuk është kryer pagesa e detyrimeve tatimore për vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e automjetit me targa *** dhe, për këtë arsye, vlera e fitimit të realizuar prej 229,280 lekësh¹⁵⁵ vlerësohet si e ardhur e paligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe kjo vlerë i zbritet të ardhurës së arkëtuar për efekt të analizës financiare.

30.7 Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenet Ç dhe D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i kaloi subjektit barrën e provës, për sa duket se çmimi i shitjes së automjetit prej 2,000 euro krahasuar me çmimin e blerjes prej 50,000 lekësh nga personi i lidhur me subjektin është fiktiv, duke mos u provuar me dokumentacion dhe me vlerë nga subjekti ndonjë investim i kryer mbi këtë pasuri dhe, për rrjedhojë, në analizë financiare deri në këtë fazë të hetimit është marrë në konsideratë çmimi i blerjes.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

30.8 Në lidhje me këtë konkluzion, në prapësimet e barrës së provës, subjekti ka shpjeguar se djali ka qenë pronar i automjetit tip “Opel Corsa”, me targa *** që ia kanë blerë të përdorur në vlerën 50,000 lekë. Si mjet i përdorur, pati defekte prandaj i bënë shërbime pranë servisit

¹⁵²Shkresë nr. *** prot., datë 31.8.2021, e DRT-së Fier.

¹⁵³Shkresë nr. *** prot., datë 31.8.2021, e Prokurorisë së Përgjithshme.

¹⁵⁴Vendim nr. 34-2019 (JR), datë 2.12.2019.

¹⁵⁵Diferenca midis ekuivalentit të vlerës 279,280 lekë (2,000 euro e vlerësuar me kursin zyrtar të këmbimit 1 euro = 139,64 lekë) me 50,000 lekë.

“****” sh.p.k., në vlerën 110,000 lekë dhe e shitën në vlerën 2,000 euro për të përfituar investimin e bërë.

30.9 Bashkëlidhur, subjekti ka depozituar: (i) një deklaratë (pa datë, pa muaj, viti 2021) nga përfaqësuesi i shoqërisë “****” sh.p.k. për kryerjen e servisit të automjetit tip “Opel Corsa”, me targa ***, në vitin 2004, në vlerën 110,000 lekë; (ii) ekstraktin historik të shoqërisë “****” sh.p.k., aktiv në vitin 2004; (iii) deklaratën noteriale datë 12.11.2021¹⁵⁶ të personit të lidhur A.Sh., i cili deklaron njësoj si shpjegimet e subjektit.

Vlerësimi i Komisionit

30.10 Komisioni vlerëson se provat e paraqitura nga subjekti, të pashoqëruara me faturën tatimore të shërbimit dhe situacionin e shërbimeve të kryera, si dhe të depozituara vetëm në fazën e fundit të hetimit, nuk janë bindëse për Komisionin pasi nuk provuan investimin e kryer për të rritur vlerën e automjetit. Gjithashtu nuk provohet edhe pagesa e detyrimeve tatimore në lidhje me të ardhurat e përfituara nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes me atë të blerjes.

Për sa më lart Komisioni, për efekt të analizës financiare, mori në konsideratë çmimin e blerjes së automjetit prej 50,000 lekësh, nga personi i lidhur me subjektin, i biri R.Sh.

❖ Personi i lidhur me subjektin/B.Sh., e bija

31. Llogari rrjedhëse në BKT, dega Fier, krijuar në datën 22.7.2015. Gjendja në llogari në datën 19.1.2017 është 16,352,94 lekë. Burimi i krijimit: të ardhura nga paga e prindërve.

31.1 Në DIPP-në e vitit 2016 personi i lidhur/B.Sh. ka deklaruar: *“Kam llogari rrjedhëse në BKT. Gjendja e llogarisë në datën 31.12.2016 është 352,94 lekë. Burimi i krijimit: nga paga e prindërve”.*

31.2 BKT-ja¹⁵⁷ konfirmon llogari rrjedhëse në emër të shtetas B.Sh., me gjendje në vlerën 16,352,94 lekë, në datën 19.1.2017. Komisioni konstaton se kreditimet në këtë llogari vijnë nga: (i) gjatë vitit 2015, vlera 1,500 lekë e depozituar nga shtetasja B.Sh. dhe vlera 95,000 lekë si shumë e disa transfertave nga llogaria e subjektit të rivlerësimit të llogaria e vajzës; dhe (ii) gjatë vitit 2016, vlera 358,000 lekë, si shumë e disa transfertave nga llogaria e subjektit të rivlerësimit të llogaria e vajzës.

Për sa më lart, deklarimi i personit të lidhur përputhet me dokumentacionin e administruar.

32. Analiza financiare

Komisioni kreu analizën financiare duke e fragmentuar në dy pjesë, konkretisht: (i) analiza financiare për të ardhurat, pasuritë dhe shpenzimet e subjektit dhe personave të lidhur për periudhën 1992 – 2002; dhe (ii) analiza financiare për të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit dhe personave të lidhur për periudhën 2003 – 2016, duke i përcjellë subjektin të rivlerësimit edhe aneksin nr. 1 me emërtim “Analiza financiare e detajuar” dhe aneksin nr. 2 me emërtim “Metodika e analizës financiare”.

Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i kaloi subjektin barrën e provës për sa duket se: (i) subjekti dhe personat e lidhur me të kanë pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën -13,982,379 lekë për periudhën 1992 – 2002; dhe (ii) subjekti dhe personat e lidhur me të kanë pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën 10,255,252 lekë për periudhën 2003 – 2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

¹⁵⁶Deklaratë noteriale nr. ***, datë 12.11.2021.

¹⁵⁷Shkresat nr. *** prot., datë 8.2.2021 dhe nr. *** prot., datë 2.7.2021.

32.1 Lidhur me balancën negative të periudhës 1992 – 2002 (konstatimi i parë), në prapësime, krahas pretendimeve të analizuara në paragrafët përkatës të këtij vendimi për të ardhurat nga emigracioni dhe nga qiradhënia e pajisjeve, subjekti ka pretenduar të ardhura nga aktiviteti i bashkëshortit me objekt veprimtarie “agjenci informacioni dhe shërbimesh” në shumën *neto* 2,693,652 lekë dhe ka paraqitur: (i) shkresë nr. *** prot., datë 4.11.2021, të DRT-së Fier dhe dokumentacion bashkëlidhur; (ii) shkresë nr. *** prot., datë 5.11.2021, të DRSSH-së Fier; (iii) shkresë nr. *** prot., datë 10.11.2021, nga QKB-ja.

32.2 Sipas shkresës nr. *** prot., datë 4.11.2021, të DRT-së Fier, shtetasi A.Sh. ka ushtruar aktivitetin “agjenci informacioni dhe shërbimesh” për vitin 2001 - 2002, është regjistruar me vendimin nr. ***, datë 20.3.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe me kod fiskal ***. Dokumentacioni bashkëlidhur kësaj shkrese, vijon subjekti, konfirmon të ardhurat *bruto* për periudhën 2001 – 2002, në shumën 3,000,000 lekë. Sipas shkresës nr. *** prot., datë 5.11.2021, të DRSSH-së Fier, shtetasi A.Sh. figuron i regjistruar si person fizik ambulant për dhjetor periudhën 2001 – nëntor 2002, bashkëlidhur pagimin e sigurimeve shoqërore për këtë periudhë.

32.3 Në vijim, subjekti shpjegon se sipas ekspertit kontabël, për periudhën deri në datën 31.12.2002 analiza financiare rezulton me balancë pozitive. Subjekti kërkon që Komisioni të vlerësojë faktin që një pjesë e konsiderueshme e të ardhurave të bashkëshortit nga puna e tij në emigracion apo në Shqipëri, kanë qenë të depozituara në sistemin bankar që nga viti 2001 përpara detyrës së subjektit dhe nuk kanë lidhje me detyrën e saj. Gjithashtu, subjekti kërkon që Komisioni të vlerësojë se nga të ardhurat e saj apo të bashkëshortit para vitit 2000, vetëm shuma 1,900,000 lekë është përdorur për krijimin e pasurisë. Meqë balanca për periudhën 1992 – 2002 është pozitive në shumën 2,691,277 lekë, subjekti pretendon se ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e pajisjeve në vitin 2000, si rrjedhojë nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën 1,900,000 lekë për kryerjen e pagesës së kështit të parë të apartamentit.

32.4 Lidhur me balancën negative të periudhës 2003 – 2016 (konstatimi i dytë), subjekti ka shpjeguar¹⁵⁸ se sipas analizës financiare të kryer nga eksperti kontabël nuk kanë rezultuar diferenca për këto vite, madje për vitet 2005, 2006 dhe 2011 balanca është pozitive. Për vitin 2003, subjekti ka paraqitur kundërshtimet e tij duke shpjeguar se, referuar deklaratës noteriale nr. ***, datë 28.8.2021 dhe pikës 2.34 të raportit, të ardhurat janë nga qiraja e pajisjeve të Bingos. Komisioni i ka paraqitur si shpenzime për vlerën *bruto* 1,800,000 lekë dhe nuk janë paraqitur edhe si të ardhura të përfituara. Kjo ka rënduar situatën financiare të subjektit sepse nga njëra anë ka marrë në analizë shpenzimet e një shoqërie tregtare, kapitali i së cilës është vetëm 100,000 lekë dhe nga ana tjetër nuk ka marrë në konsideratë të ardhurat nga qiraja, të cilat nga provat e depozituara rezulton të jenë përfituar, ndërsa detyrimin tatimor për këto të ardhura e ka qiramarrësi si agjent tatimor.

32.5 Në vijim, subjekti shpjegon se Komisioni nuk ka marrë në analizë financiare vlerën 10,000 euro, që kanë marrë nga motra e bashkëshortit të saj, A. G., e cila ka pasur mundësi financiare t’ua japë këtë hua.

32.6 Në përfundim, subjekti shpjegon se bazuar në prapësimet dhe provat e depozituara, rezulton se të ardhurat e familjes Shkurta rrjedhin nga burime tërësisht të ligjshme, janë transparente dhe mbulojnë tërësisht vlerën e pasurisë *neto* të subjektit dhe kostot e nevojshme të jetesës në fund të çdo viti për periudhën 31.12.2003 – 2016. Si rrjedhojë, ka arritur një nivel të besueshëm të kontrollit të pasurisë.

Vlerësimi i Komisionit

¹⁵⁸Në faqen 31 të observacionit.

32.7 Bazuar në dokumentacionin e administruar nga hetimi, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI, përgjigjet e pyetësorëve të dërguar gjatë procesit të hetimit administrativ, në prapësimet e saj pasi iu kalua barra e provës, si dhe në shpjegimet e dhëna në seancën dëgjimore, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë lidhur me pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur, si në vijim:

32.8 Lidhur me analizën financiare për periudhën 1992 – 2002, Komisioni vëren se në analizën financiare të paraqitur në raportin e audituesit ligjor janë konsideruar: (i) të ardhura nga qiraja në vlerën *neto* prej 6,000,000 lekësh përkundrejt vlerës 0 (zero) të përlllogaritur nga Komisioni; (ii) të ardhurat nga emigracioni në vlerën 7,100,000 lekë përkundrejt vlerës 0 (zero) të përlllogaritur nga Komisioni; (iii) të ardhura nga biznesi person fizik me kod fiskal ***, në vlerën 2,693,652 lekë; (iv) shpenzime për aktivitetin “****” sh.p.k. (të ardhurat nga qiraja) në vlerën 6,000,000 lekë përkundrejt vlerës 6,900,000 lekë të përlllogaritur nga Komisioni. Për sa i përket të ardhurave nga qiraja dhe ato nga emigracioni, Komisioni i qëndron arsyetimit të kryer në paragrafët përkatës të këtij vendimi.

32.9 Lidhur me të ardhurat nga biznesi person fizik me kod fiskal ***, për periudhën 2001 - 2002, në shumën 2,693,652 lekë, Komisioni vlerësoi t’i marrë në konsideratë për sa kohë u provua burimi i tyre dhe pagesa e detyrimeve tatimore.

32.10 Komisioni arrin në përfundimin se duke konsideruar të ardhurat e mësipërme, balanca negative për periudhën 1996 – 2002, reduktohet nga 13,982,379 lekë në vlerën 11,288,727 lekë.

32.11 Lidhur me analizën financiare gjatë viteve 2003 – 2016, pas riçeljes së hetimit dhe seancave dëgjimore, rezulton se vitet 2003, 2005 dhe 2006 paraqiten me balancë negative të fondeve dhe, konkretisht: (i) për vitin 2003 ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën 1,544,378 lekë, për kryerjen e shpenzimeve/investimeve për biznesin e bashkëshortit gjatë këtij viti, konkretisht, në vlerën 572,448 lekë për harkun kohor 1.1.2003 – 1.5.2003 dhe në vlerën 971,930 lekë për harkun kohor 2.5.2003 - 31.12.2003; (ii) për vitin 2005 ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën 2,748,824 lekë (mungesë burimesh të ligjshme për pagesën e këstit të parë të apartamentit në prill të vitit 2005 në shumën 2,500,000 lekë dhe për kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve në vlerën 248,824 lekë gjatë këtij viti); (iii) për vitin 2006 ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën 283,621 lekë për kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve gjatë këtij viti.

Tabela nr. 6 – Analiza financiare për subjektin dhe personat e lidhur për periudhën 2003 – 2016

Viti	Pasuri	Ndryshim likuiditete cash	Ndryshim likuiditete bankë	Të ardhurat	Detyrimet	Shpenzime	Diferenca për shpenzime	Vitet me balancë negative
2003	0	0	19,782	710,860	0	2,235,456	-1,544,378	-1,544,378
2004	0	0	-737	3,337,683	0	435,456	2,902,964	0
2005	8,460,000	0	620,944	1,170,572	5,960,000	798,451	-2,748,824	-2,748,824
2006	0	0	-642,474	1,021,265	-849,740	1,097,620	-283,621	-283,621
2007	-400,000	0	39,365	1,166,787	-470,489	837,733	219,199	0
2008	0	0	1,963	1,156,943	-72,360	1,015,903	66,718	0
2009	0	0	-53,627	1,323,901	-74,493	994,351	308,684	0
2010	0	0	43,142	1,227,518	-85,111	787,650	311,615	0
2011	1,296,063	0	19,892	2,120,923	814,476	1,491,873	127,571	0
2012	0	0	-222,043	1,549,174	-131,978	718,760	920,479	0
2013	0	0	-56,533	1,602,178	-137,246	738,017	783,448	0
2014	320,900	0	161,784	2,076,038	-141,442	1,173,951	277,961	0

2015	0	350,000	-28,254	2,470,087	-145,525	1,192,829	809,987	0
2016	0	-250,000	-46,793	2,503,379	-149,761	1,638,029	1,012,382	0
TOTAL	9,676,963	100,000	- 143,587	23,437,307	4,516,330	15,156,078	3,164,183	- 4,576,823

Në lidhje me analizën financiare, Komisioni arrin në përfundimin se:

Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur/tjerë të lidhur me të rezultojnë me burime financiare jo të ligjshme dhe, për rrjedhojë, me një balancë negative financiare:

- për periudhën para detyrës, 1996 – 2002, në vlerën 11,288,727 lekë;**
- për periudhën 2003 – 2016, në vlerën 4,576,823 lekë;**
- dhe personi i lidhur gjatë periudhës së divorcit 2007 – 2010, në vlerën 2,442,278 lekë,**

e cila duke marrë në konsideratë edhe parimin e proporcionalitetit në lidhje me periudhën para detyrës, si dhe atë të divorcit konsiderohet e mjaftueshme për të kualifikuar subjektin e rivlerësimit në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm, bazuar në pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka dërguar¹⁵⁹ pranë Komisionit raportin¹⁶⁰ mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Violeta Shkurta, i deklasifikuar plotësisht me vendimin¹⁶¹ e KDZH-së. Sipas këtij raporti, Grupi i Punës të DSIK-së, në përfundim të verifikimit ka konkluduar se:

- subjekti i rivlerësimit ka pasur të njëjtat gjeneralitete si ato që ka deklaruar vetë në deklaratën për kontrollin e figurës;*
- për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.*

Sa më sipër, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Violeta M. Shkurta (H.).

Nga hetimi i kryer, Komisioni nuk ngriti dyshime për sa i përket përshtatshmërisë së subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës në lidhje me kriterin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE TË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), si organi ndihmës për vlerësimin etiko-profesional, ka hartuar dhe ka përcjellë në Komision raportin¹⁶² mbi aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit Violeta Shkurta. Ky raport, për periudhën 8.10.2013 – 8.10.2016, i ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

Aftësitë profesionale ku përfshihen:

- njohuritë ligjore dhe arsyetimi ligjor – subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore (të sjella nga subjekti) dhe në*

¹⁵⁹Shkresë nr. *** prot., datë 30.4.2021, e DSIK-së.

¹⁶⁰Raporti nr. *** , datë 2.11.2017, i DSIK-së.

¹⁶¹Vendim nr. *** , datë 30.4.2021, i KDZH-së.

¹⁶²Raporti nr. *** prot., datë 23.9.2021, i KLP-së, miratuar me vendimin nr. *** , datë 23.9.2021, të KLP-së, depozituar në Komision me nr. *** , datë 30.9.2021.

pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se ai identifikon drejtë normën ligjore të zbatueshme dhe argumenton arsyet e zbatimit të saj në rastin konkret; analizon dispozitat ligjore për caktimin e dënimit dhe respekton standardet e procesit të rregullt ligjor. Aktet e arsyetuara prej subjektit janë të kuptueshme.

Aftësitë organizative ku përfshihen:

a) *aftësia për të përballuar ngarkesën në punë* – subjekti i rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka trajtuar gjithsej 627 çështje, nga të cilat 122 çështje të mosfilluara, 81 çështje të pushuara, 242 çështje të dërguara për gjykim dhe 179 çështje të pezulluara¹⁶³. Subjekti ka zbatuar kompetencat që ligji i njuh prokurorit dhe ka respektuar afatet procedurale;

b) *aftësia për të kryer procedurat hetimore* – konstatohet se subjekti tregon profesionalizëm në gjykim dhe në qëndrimin që mban për çështjet në gjykim;

c) *aftësia për të administruar dosjet* – dosjet e vëzhguara janë të administruara rregullisht, materialet të vendosura në rend kronologjik dhe japin të dhëna mbi faktin penal, qëndrimin e subjektit dhe disponimin e gjykatës.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale ku përfshihen

a) *etika në punë, integriteti dhe paanësia* – gjuha që përdor subjekti në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Gjatë periudhës tetor 2013 – tetor 2016, ndaj subjektit nuk është marrë asnjë masë disiplinore. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti dhe nga pesë dosjet e përzgjedhura me short konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit, as shkaqe anësie të dokumentuara, as përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjerë që vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit, as raste të përdorimit të cenimit të të drejtave të palëve dhe viktimave.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional ku përfshihen:

(a) *aftësitë e komunikimit; (b) aftësia për të bashkëpunuar; (c) gatishmëria për t'u angazhuar.*

Komisioni i Vlerësimit ka konstatuar se subjekti shfaq aftësi të mira komunikimi dhe sjellje të mirë, ka aftësi bashkëpunimi dhe pune në grup, si dhe është angazhuar në një sërë aktivitete profesionale.

Raporti, gjithashtu, është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e informacioneve si vijojnë:

C/1. FORMULARI I VETËDEKLARIMIT DHE DOKUMENTET E PARAQITURA NGA SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT

Formulari paraqitet i nënshkruar pa mangësi dhe pa kundërthënie nga subjekti, sipas shtojcës që parashikon ligji, i plotë lidhur me deklaratimet për të dhënat statistikore dhe me dokumentacionin e nevojshëm bashkëlidhur, si: certifikata trajnimi dhe vërtetime për trajnimet brenda dhe jashtë Shkollës së Magjistraturës¹⁶⁴; tri dokumentet ligjore¹⁶⁵ të përzgjedhura nga subjekti; dy akte “Vlerësimi i punës” për vitet 2012 – 2016 nga Prokurori i Përgjithshëm me vlerësimin “shumë mirë”.

¹⁶³Sipas vërtetimit nr. ***, datë 27.10.2020.

¹⁶⁴Sipas vërtetimit nr. ***, datë 21.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës.

¹⁶⁵Vendim datë 2.10.2015 për mosfillim procedimi penal; diskutim përfundimtar për procedimin penal nr. ***, viti 2014; diskutim përfundimtar për procedimin penal nr. ***, viti 2016.

Rezulton se subjekti gjatë viteve 2014, 2015 dhe 2016 ka trajtuar gjithsej 575 procedime penale, 104 kallëzime të mosfilluara dhe nuk ka mbartur asnjë çështje në vitin 2016.

C/2. DOKUMENTET E PARAQITURA NGA SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT

Dokumenti nr. 1 – vendim datë 2.10.2015, “Për mosfillimin e procedimit penal” mbi bazën e kallëzimit nr. ***, datë 2.9.2015.

Dokumenti nr. 2 – diskutim përfundimtar datë 13.3.2014, “Për gjykimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2014, në ngarkim të të pandehurit F. S.”.

Dokumenti nr. 3 – diskutim përfundimtar datë 22.7.2016, “Për gjykimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2016, në ngarkim të të pandehurit V. D.”.

Konkluzion: në tri dokumentet e paraqitura nga subjekti nuk janë konstatuar problematika që çojnë në një vlerësim negativ të subjektit të rivlerësimit për sa i përket kriterit profesional.

C/3. DOSJET E PËRZGJEDHURA SIPAS NJË SISTEMI RASTËSOR DHE OBJEKTIV

Dosja nr. 1 – kallëzim penal nr. * /2016**

1.1 Kallëzimi penal datë 16.5.2016, i bërë nga shtetasi Z. H., është regjistruar në datën 3.6.2016 dhe subjekti i rivlerësimit ka proceduar me vendim mosfillimi të procedimit penal datë 2.7.2016.

1.2 Sipas kallëzuesit, ZVRPP-ja Fier ka bërë falsifikime sepse ka regjistruar pasurinë nr. *** në emër të shtetasit L. H., ndërkohë që AMTP-ja e kësaj pasurie ishte dërguar në Prefekturë për shqyrtim.

1.3 Subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal sepse pronat e palëve kanë mbivendosje dhe ky është një konflikt civil që zgjidhet në rrugë gjyqësore, prandaj fakti i kallëzuar nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

1.4 Vendimi i mosfillimit është strukturuar në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa arsyetuese dhe dispozitivi dhe në këto pjesë nuk vërehen parregullsi, paqartësi apo shkelje nga ana e subjektit.

Nuk u konstatuan mangësi në këtë dosje.

Dosja nr. 2 – procedimi penal nr. *, datë 26.6.2013**

2.1 Ky procedim për veprën penale “ndërtim i paligjshëm” (neni 199/a/1 i Kodit Penal) është regjistruar mbi bazën e kallëzimit datë 21.6.2013 të shtetases H. Z. që pretendon se shtetasi H. Ll. po ndërton armaturën e katit 4 në tokën e saj. Nga hetimi ka rezultuar se shtetasi H. Ll. ka bërë shtesë kati të katërt të paligjshëm në pasurinë e tij të regjistruar me certifikatë pronësie dhe jo ndërtim të paligjshëm mbi tokë, pra nuk është cenuar toka për të cilën kreu II, seksioni XI parashikon veprat që mbrojnë regjimin juridik të tokës nga pronari i saj apo nga persona të tjerë.

2.2 Shtetasi H. Ll., sipas vërtetimit hipotekor datë 14.2.2008, ka në pronësi pronën me sip. 119 m² truall dhe magazinë, në zonën kadastrale ***, Fier. Në datën 22.6.2013, ky shtetas ka aplikuar për legalizimin e ndërtimit pa leje, shtesë 1 kat mbi objektin 3 kate që e ka në pronësi me certifikatë pronësie datë 22.4.2013 për pasurinë nr. *** (truall me sip. 209 m² nga i cili 166 m² është ndërtesë) dhe ku kartela e pasurisë bashkëlidhur ka përshkrimin “godinë e kombinuar 3 kate”.

2.3 Komisioni nga ana e tij vëren se subjekti i rivlerësimit është caktuar ta ndjekë këtë procedim nga data 10.12.2013, pasi ka zëvendësuar prokurorin e mëparshëm E. Gj.. Komisioni vëren se deri në datën 26.10.2013 nga prokurori i mëparshëm janë kryer të gjitha

hetimet dhe administruar të gjitha provat që tregojnë kryerjen e ndërtimit pa leje nga shtetasi H. Ll. mbi pronën e tij. Pavarësisht nga kjo, në datën 26.12.2013 subjekti i rivlerësimit Violeta Shkurta ka vendosur zgjatjen e afatit të hetimeve deri në datën 26.3.2014 për një hetim të plotë, objektiv e të gjithanshëm (pa përcaktuar se çfarë veprimesh nevojitej të kryheshin në vijim), por gjatë kësaj kohe e deri në vendimin e pushimit të procedimit, subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer asnjë veprim hetimor. Në datën 30.4.2014 subjekti ka vendosur pushimin e procedimit penal¹⁶⁶ në bazë të neneve 190/ç dhe 328/1, germa “f”, të Kodit të Procedurës Penale dhe neneve 5 dhe 6 të ligjit nr. 22, datë 10.3.2014, “Për dhënie amnistie”. Për periudhën njëmuajore tej afatit nga data 26.3.2014 deri në datën e pushimit të procedimit, subjekti nuk ka disponuar me vendim për shtyrje të afatit të hetimeve.

2.4 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit për sa duket se:

Shtyrja e afatit të hetimeve deri në 4 muaj nuk ka qenë e nevojshme dhe e arsyetuar, hetimet janë zgjatur edhe një muaj pa disponuar me vendim. Ky veprim i subjektit të rivlerësimit duket se është në kundërshtim me pikat 2 dhe pika 3, të nenit 324, të Kodit të Procedurës Penale, që përcaktojnë se: “Zgjatje të mëtejshme, secila për një kohë jo më shumë se tre muaj, mund të bëhen nga prokurori në rastet e hetimeve komplekse ose të pamundësisë objektive për t’i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur. Vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve jepet i arsyetuar”.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

2.5 Në prapësime dhe në seancë dëgjimore subjekti shpjegoi se është caktuar që të ndjekë këtë procedim duke zëvendësuar prokurorin e mëparshëm në datën 10.12.2013, por fizikisht këtë dosje e ka marrë pas kësaj date. Ka pasur ngarkesë të madhe pune për shkak të numrit të madh të procedimeve penale. Neni 199/a i Kodit Penal që parashikonte veprën penale “ndërtim i paligjshëm” objekt hetimi, ishte dispozitë e re e shtuar me ligjin nr.10023, datë 27.11.2008, neni 21 dhe kishte disa qëndrime në teori dhe praktikë për konceptin e ndërtimit të kryer në tokë dhe lartësi. Prokurorët ishin në dijeni të ligjit “Për amnistinë” për një kategori veprash penale të kryera para datës 31.12.2013. Për këto arsye ka qenë e nevojshme zgjatja e afatit të hetimeve.

2.6 Vendimi për zgjatjen e afatit është i arsyetuar me shkaqet e mësipërme. Në faqen 204 të procedimit penal ndodhet vendimi për zgjatjen e afatit. Në këtë vendim ka një gabim material në lidhje me datën e përfundimit të hetimeve, por në pjesën arsyetuese të vendimit duket qartë se zgjatja është deri në datën 26.5.2014. Vendimi për pushimin e procedimit mban datën 30.4.2014, pra është marrë brenda afatit hetimor të çështjes sepse afati i zgjatur përfundonte në datën 26.5.2014 (bashkëlidhur vendimi për zgjatjen e afatit hetimor, f. 204 e dosjes *** dhe kopje e raportit vjetor të Prokurorisë Fier për ngarkesën e punës së subjektit në vitin 2013).

Vlerësimi i Komisionit

2.7 Nisur nga analiza e çdo argumenti që ka paraqitur, Komisioni vëren se ngarkesa e madhe në punë, qëndrimet e ndryshme në lidhje me konceptin e veprës penale “ndërtim pa leje” (që faktikisht kishte 4 vjet që ishte miratuar) nuk janë shkak për shtyrjen e afatit të hetimeve.

Në dosjen e këtij procedimi penal, prokurori i mëparshëm E. Gj., me vendimin datë 26.9.2013 ka vendosur zgjatjen e arsyetuar të afatit të hetimeve deri në datën 26.12.2013.

2.8 Subjekti i rivlerësimit pretendon në prapësime se vendimi datë 26.12.2013 për zgjatjen e afatit të hetimeve është i arsyetuar me shkaqet e mësipërme, por në këtë vendim subjekti citon:

¹⁶⁶Vendimi datë 30.4.2014 i subjektit të rivlerësimit.

“Afatit i hetimeve paraprake përfundon në datën 26.12.2013, por hetimet nuk kanë përfunduar dhe për një hetim të plotë, të gjithanshëm e objektiv të çështjes është e domosdoshme kryerja e veprimeve hetimore si: të vendoset për zgjidhjen përfundimtare të çështjes, etj. Bazuar në ligjin nr. 22, datë 10.3.2014, vepra penale e parashikuar nga neni 199 i Kodit Penal përfshihet në ligjin për amnistinë që hyn në fuqi në datën 11.4.2014. Për këto arsye, bazuar në nenet 324 dhe 325 të Kodit të Procedurës Penale vendosa shtyrjen e afatit hetimor për 2 muaj deri në datën 26.5.2014”.

2.9 Në dosje nuk ka vendime të tjera për zgjatje afati hetimor. Nisur nga ky fakt dhe nga përmbajtja e këtyre dy vendimeve, rezulton se data 26.12.2013 që mban vendimi i subjektit për zgjatjen e afatit hetimor është i saktë dhe nuk mund të jetë pasaktësi siç tenton ta justifikojë subjekti i rivlerësimit.

2.10 Referuar datës 26.12.2013 së vendimit për zgjatjen e afatit hetimor dhe referuar pikave 2 dhe 3, të nenit 324, të Kodit të Procedurës Penale, që përcaktojnë se: *“Zgjatje të mëtejshme, secila për një kohë jo më shumë se tre muaj ...”*, duhej që afati i përfundimit të hetimeve të ishte data 26.3.2014, prandaj përfundimi i hetimit dhe pushimi i procedimit në datën 30.4.2014 është një muaj jashtë afatit dhe i pajustificuar.

2.11 Pretendimi i subjektit se prokurorët ishin në dijeni të ligjit “Për amnistinë” për një kategori veprash penale të kryera para datës 31.12.2013, kur ndërkohë ky ligj u miratua në datën 10.3.2014 (3 muaj më vonë), të çon vetvetiu në arsyetimin se subjekti i rivlerësimit, qëllimisht, ka zvarritur hetimin deri në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit “Për amnistinë” me qëllim që personi nën hetim të përfitonte nga ky ligj.

2.12 Pretendimi i subjektit në lidhje me datën 26.5.2014 e përfundimit të afatit të hetimeve në tentativë për ta justifikuar si gabim material është një përpjekje aspak serioze dhe joprofionale. Komisioni rithekson se edhe pse ka shtyrë afatin subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor tjetër. Zgjidhja përfundimtare e çështjes bazuar në një ligj që amnistion veprën penale objekt hetimi siç citon subjekti në pjesën arsyetuese të vendimit nuk është shkak ligjor për shtyrjen e hetimeve sepse nuk ka të bëjë me nevojën e kryerjes së veprimeve hetimore, por me përfundimin e hetimeve.

Për sa më lart, Komisioni arrin në përfundimin se shtyrja e afatit të hetimeve deri në 4 muaj nuk ka qenë e nevojshme dhe, për më tepër, e arsyetuar. Hetimet janë zgjatur edhe një muaj pa disponuar me vendim. Ky veprim i subjektit duket se është në kundërshtim me pikat 2 dhe pika 3, të nenit 324, të Kodit të Procedurës Penale, që përcaktojnë se: *“Zgjatje të mëtejshme, secila për një kohë jo më shumë se tre muaj, mund të bëhen nga prokurori në rastet e hetimeve komplekse ose të pamundësisë objektive për t’i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur. Vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve jepet i arsyetuar ...”*

Dosja nr. 3 – procedimi penal nr. *, datë 16.12.2013**

3.1 Ky procedim është regjistruar mbi bazën e kallëzimit të shtetasit J. Gj., sipas të cilit shtetas kishte blerë në maj të vitit 2010 një automjet me targa *** nga shtetasi F. H. me garancinë se ishte me dokumentacion të rregullt. Në datën 17.11.2013, duke kaluar në doganën greke, gjatë kontrollit ka rezultuar se automjeti është i vjedhur në shtetin grek dhe i është sekuestruar.

3.2 Gjatë hetimit (siç edhe ka cituar subjekti në arsyetimin e vendimit të pushimit) ka rezultuar se sipas letërporosisë nr. ***, datë 27.8.2012, të Ministrisë së Drejtësisë së Republikës Greke (marrë nga procedimi penal tjetër me nr. ***/2011), shtetasi F. H. ishte pjesë e një organizate kriminale që kryente vjedhje, mashtrime, falsifikime dhe ka ndërmjetësuar shitjen e automjetit të blerësi J. Gj. duke i marrë shumën 5,500 euro. Është

këqyrur procedimi penal nr. *** /2014 (i ndarë nga procedimi nr. ***/2011) dhe ka rezultuar se automjeti ishte i vjedhur në Greqi.

3.3 KLP-ja ka konstatuar se në dosje nuk rezultojnë të nënshkruara nga prokurori i çështjes dhe personi nën hetim, vendimet për zgjatjen e afateve të hetimit të datave 14.3.2014, 16.6.2014, 16.9.2014 dhe 16.12.2014; nuk rezultojnë urdhri për regjistrimin e procedimit penal dhe urdhri për delegimin e kryerjes së veprimeve hetimore nga OPGJ-ja (ndonëse OPGJ R. Z. ka përgatitur relacionin përkatës).

3.4 Komisioni, nga ana e tij, vëren se subjektit të rivlerësimit i është ngarkuar ky procedim në datën 30.1.2015 me urdhrin për zëvendësimin e prokurorit të mëparshëm, z. A. B., prandaj këto mangësi nuk janë përgjegjësi e subjektit të rivlerësimit.

3.5 Komisioni ka konstatuar disa pasaktësi në dosjen e procedimit penal, konkretisht: (i) vendimi “Për caktimin e përkthyesit” i nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, mban datën 8.11.2013, kur ndërkohë subjektit i është caktuar çështja në datën 30.1.2015; (ii) me vendimin datë 16.3.2015, subjekti i rivlerësimit ka vendosur zgjatjen e afatit të hetimit deri në datën 16.3.2015 me qëllim administrimin e akteve të procedimit penal nr. ***, viti 2012 dhe veprime të tjera të cilat nuk u përfunduan deri në datën 16.9.2014. Pra, ky vendim ka pasaktësi në lidhje me datën e nënshkrimit të tij dhe me datën e afatit të përfundimit të hetimeve, duke e bërë të paqartë kur është marrë ky vendim dhe kur duhej të përfundonin hetimet; (iii) procesverbali datë 5.6.2015, “Për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve” është nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit 3 javë pas vendimit të pushimit të procedimit.

3.6 Pavarësisht nga këto, subjekti, në bazë të germës “F”, të nenit 328, të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur në datën 15.5.2015 të pushojë hetimet ndaj personit nën hetim F. H.. Në pjesën e fundit të arsyetimit të vendimit, subjekti citon: “... me qëllim marrjen e të dhënave të tjera për gjendjen e mjetit aktualisht, hetimet ndaj të hetuarit do të pushohen në pritje të letërporosisë”.

3.7 Në dosje gjenden: (i) shkresa nr. *** prot., datë 29.4.2015, “letërporosi për ndihmë gjyqësore” e Prokurorisë Fier dërguar Ministrisë së Drejtësisë në Shqipëri dhe Autoritetit Gjyqësor Greqi; (ii) shkresa nr. *** prot., datë 15.5.2015, “kërkesë për ndihmë juridike” e Ministrisë së Drejtësisë shqiptare drejtuar Ministrisë së Drejtësisë greke dhe për dijëni Prokurorisë Fier, ku kjo e fundit ka marrë dijëni në datën 18.5.2015 pra, vetëm 3 ditë pasi subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e procedimit penal.

3.8 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit nga duket se: (i) ka pasaktësi në aktet e dosjes hetimore në lidhje me datat e nënshkrimit të tyre nga ana e subjektit të rivlerësimit; (ii) subjekti i rivlerësimit edhe pse ka bërë kërkesë për marrjen e provave nga Autoritetet Gjyqësore Greke, ka pushuar procedimin brenda 15 ditëve nga dita e nisjes së kësaj kërkesë, pa pritur përgjigjen nga këto autoritete, duke mos kryer kështu hetim të plotë.

Qëndrimi i subjektit

3.9 Në prapësimet e barrës së provës dhe në seancë dëgjimore, subjekti ka shpjeguar se:

i) Në dhjetor të vitit 2014 ka dërguar për gjykim procedimin penal nr. ***/2011 në ngarkim të disa të pandehurve të akuzuar për veprën penale “Trafikim të mjeteve motorike” të kryer në bashkëpunim (neni 141/a i Kodit Penal) dhe nga ky procedim është veçuar procedimi penal nr. ***, datë 11.12.2014, disa akte të të cilit janë administruar në funksion të procedimit penal nr. ***/2013. Këto akte janë administruar me procesverbalin për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve datë 5.6.2015 (datë me gabime materiale) dhe ndodhen në dosjen e procedimit nr. ***/2013, faqet 11-220.

Në këto akte ndodhet edhe vendimi datë 8.11.2013, “Për caktimin e përkthyesit” dhe nga përmbajtja e aktit del qartë se vendimi për caktimin e përkthyesit dhe akti i përkthimit janë kryer në funksion të procedimit penal nr. ***/2011 dhe nuk ka pasaktësi në lidhje me datën e këtij vendimi.

ii) Vendimi për zgjatjen e afatit datë 16.3.2015 ka gabim material në lidhje me afatin e zgjatjes së hetimeve, sepse afati hetimor i çështjes është zgjatur për 3 muaj dhe përfundon në datën 16.6.2015. Si rrjedhojë, pavarësisht gabimit material, vendimi për pushimin e procedimit është marrë në datën 15.5.2015 brenda afatit hetimor të çështjes. Kjo provohet me formularin për kontrollin e kryer nga Drejtuesi i Prokurorisë ku ndodhet shënimi “dosja është dorëzuar për kontroll në datën 20.5.2015”, si dhe me datën e arkivimit të dosjes 12.6.2015, që është shënuar mbi fashikullin e procedimit. Pra, data e vendimit të pushimit të procedimit është 15.5.2015 brenda afatit të hetimit.

iii) Procesverbali për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve ka datën 5.6.2015 që është gabim material, por gjithsesi kjo datë është përpara datës së vendimit të pushimit të procedimit sepse këto dokumente janë analizuar në faqen 3 të këtij vendimi.

3.10 Në lidhje me pasaktësitë që janë gabime materiale, subjekti shpjegon se kanë ndodhur për shkak të shpejtësisë dhe ngarkesës në punë, por ligji parashikon mënyrën e ndreqjes së tyre sipas neneve 100 dhe 114 të Kodit të Procedurës Penale. Neni 100 përcakton: *“Kur parashikohet pavlefshmëria e aktit për shkak se nuk është treguar data, ky rregull ka vlerë vetëm në rastin kur data nuk mund të saktësohet me siguri në bazë të elementeve që përmbahen në vetë aktin ose në aktet që lidhen me të”*.

3.11 Në lidhje me konstatimin e dytë të Komisionit, se subjekti i rivlerësimit edhe pse ka bërë kërkesë për marrjen e provave nga Autoritetet Gjyqësore Greke ka pushuar procedimin brenda 15 ditëve nga dita e nisjes së kësaj kërkesë, pa pritje përgjigjen nga këto autoritete duke mos kryer kështu hetim të plotë, subjekti ka shpjeguar se në rastet kur për hetimin e çështjes kërkohen të dhëna nga autoritetet gjyqësore të huaja, të cilat kërkojnë kohë të gjatë për t'u administruar, prokuroria ka proceduar me pushimin e procedimit, në pritje të letërporosisë ose me pezullimin e hetimeve.

3.12 Në vijim, subjekti shpjegon se para ndryshimeve ligjore të vitit 2017, me pushim procedohej në rastin kur çështja ishte regjistruar në ngarkim të një personi të dyshuar, ndërsa me pezullim në rastin kur nuk kishte persona të dyshuar si autorë të veprës penale. Procedimi penal nr. ***/2013 është regjistruar në ngarkim të shtetasit të dyshuar F. H. sipas kallëzuesit, regjistrim që urdhërohej nga Drejtuesi i Prokurorisë, pavarësisht nëse të dhënat ishin ose jo të mjaftueshme. Për shkak se afati hetimor llogaritet nga data e regjistrimit të emrit të personit të dyshuar dhe me qëllim që të mos kalonin afatet tërësore të hetimit me pasojë mosushtrimin e ndjekjes penale, u vendos pushimi i procedimit në pritje të letërporosisë. Nga aktet e procedimit rezulton se letërporosia nuk ka ardhur ende, por sapo të mbërrijë, ky procedim do të rifillohet dhe subjekti do të bëjë edhe ndreqjen e gabimeve materiale.

3.13 Bashkëlidhur prapësimeve subjekti ka depozituar: (i) vendimin datë 8.11.2013 për caktimin e përkthyesit; (ii) formularin për kontrollin e dosjes; (iii) kopjen e kapakut të fashikullit të procedimit ku shënohet data e arkivimit të dosjes; (iv) të dhëna nga regjistri i procedimeve penale të vitit 2011; (v) kopjen e raportit vjetor të Prokurorisë Fier për vitet 2014 dhe 2015.

Vlerësimi i Komisionit

3.14 Në lidhje me vendimin “Për caktimin e përkthyesit” që Komisioni ka konstatuar pasaktësi sepse është nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit në datën 8.11.2013, kur ndërkohë subjektit i është caktuar çështja për ndjekje në datën 30.1.2015, Komisioni pranon prapësimet e subjektit sepse nga përmbajtja e aktit del që vendimi për caktimin e përkthyesit dhe akti i përkthimit janë kryer në funksion të procedimit penal nr. ***/2011 për të përkthyer aktet e ardhura në datën 4.11.2013. Gjithashtu edhe deklaratat e përkthyesit është nënshkruar në datën 8.11.2013.

3.15 Në lidhje me vendimin datë 16.3.2015 ku subjekti i rivlerësimit ka vendosur zgjatjen e afatit të hetimit deri në datën 16.3.2015 me qëllim administrimin e akteve të procedimit penal nr. ***, viti 2012 dhe kryerjen e veprimeve të tjera që nuk u përfunduan deri në datën 16.9.2014, vendimi për të cilin Komisioni ka konstatuar pasaktësi në lidhje me datën e nënshkrimit të tij, me datën kur duhej të përfundonte hetimi dhe me datën e afatit final të përfundimit të hetimeve, Komisioni vëren se subjekti e pranon që janë pasaktësi duke i justifikuar si gabime materiale dhe që afati hetimor i çështjes realisht është zgjatur për 3 muaj me qëllim për të përfunduar në datën 16.6.2015, ndërkohë që vendimi i pushimit është marrë në datën 15.5.2015 pra, brenda afatit hetimor.

3.16 Në lidhje me procesverbalin datë 5.6.2015 “Për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve” që Komisioni konstatoi se është nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit 3 javë pas vendimit të pushimit të procedimit datë 15.5.2015 dhe që subjekti pranon në prapësime se data është gabim material, Komisioni vëren se: Me këtë procesverbal janë marrë aktet e Interpolit bashkëlidhur shkresës nr. *** prot., datë 14.6.2012, pjesë e fashikullit të procedimit penal nr. ***, viti 2014, si dhe letërporosia me shkresë nr. ***, datë 27.8.2012, e Ministrisë së Drejtësisë së Greqisë pjesë e fashikullit të procedimit penal nr. ***/2011. Pra, vërtet nga përmbajtja e të dy akteve kuptohet se kronologjikisht ky procesverbal duhej të datojë para vendimit të pushimit, fakti që data në procesverbal është shënuar pas datës së vendimit, tregon se procesverbali mekanikisht dhe realisht është bërë pasi është nënshkruar vendimi i pushimit.

3.17 Në lidhje me konstatimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit edhe pse ka bërë kërkesë për marrjen e provave nga Autoritetet Gjyqësore Greke, ka pushuar procedimin brenda 15 ditëve nga dita e nisjes së kësaj kërkesë, pa pritur përgjigjen nga këto autoritete duke mos kryer kështu hetim të plotë, Komision vlerëson të marrë në konsideratë prapësimet e subjektit për sa kohë që veprimi i tij nuk ka ndalim ligjor, por është edhe në funksion të mos humbjes së mundësisë për të rihapur këtë hetim në rastin kur do të ishin të disponueshme provat e kërkuara.

Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se ka pasaktësi në aktet e dosjes hetimore, por që konsiderohen me peshë minimale në lidhje me kriterin profesional që nuk mund të çojë deri në aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

Dosja nr. 4 – procedimi penal nr. *, datë 15.2.2016**

4.1 Procedimi është regjistruar mbi kallëzimin e shtetasit E. T.. Nga hetimi ka rezultuar se ky shtetas është kanosur me thikë nga shtetasi L. T. brenda një lokali dhe kur E. ka dalë nga lokali, L. e ka ndjekur jashtë dhe ka goditur xhamin e automjetit të E..

4.2 Meqë vlera e dëmit të automjetit është 10,412 lekë, subjekti i ka pushuar hetimet për akuzën “shkatërrim prone”, kurse për veprën penale “kanosje” ka përpiluar në përputhje me nenin 331 të Kodit të Procedurës Penale kërkesën për gjykimin e çështjes në ngarkim të të pandehurit L. T..

4.3 Gjatë gjykimit, subjekti ka kërkuar deklarimin fajtor të të pandehurit L. T., dënimin e tij me 2 muaj burgim dhe në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dënimin me 1

muaj e 10 ditë burgim. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, në zbatim të nenit 406, ka vendosur me vendimin nr. ***, datë 26.7.2016, dënimin me 20 ditë burgim, kurse Gjykata Apelit Vlorë ka vendosur prishjen e këtij vendimi dhe pushimin e çështjes.

Komisioni nuk konstatoi mangësi në këtë dosje.

Dosja nr. 5 – procedimi penal nr. *, datë 18.4.2014**

5.1 Procedimi penal ka filluar në ngarkim të shtetasit R. C. për veprën penale “drejtim automjeti në gjendje të parregullt”. Nga hetimet ka rezultuar e provuar kryerja e kësaj vepre penale dhe, në përfundim, subjekti ka përpiluar kërkesën për gjykim bazuar në nenin 331 të Kodit të Procedurës Penale.

5.2 Subjekti ka hartuar edhe konkluzionet përfundimtare në gjykim dhe në përfundim ka kërkuar deklarinim fajtor të të pandehurit dhe dënimin e tij pas zbatimit të neneve 406 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 63 të Kodit Penal, me punë në interes publik për 100 orë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur¹⁶⁷ dënimin e fajtorit me punë në interes publik për 80 orë.

Komisioni nuk konstatoi mangësi në këtë dosje.

C/4. TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLP-së

1. Nga verifikimi i të dhënave nga arkivi i Prokurorisë së Përgjithshme dhe KLP-së, si dhe nga shkresa me të cilën Prokuroria e Përgjithshme ka dërguar¹⁶⁸ në Komision përgjigjet e prokurorive të rretheve gjyqësore¹⁶⁹ ka rezultuar se nuk ka: të dhëna për procedim disiplinor; të dhëna nga agjencitë ligjzbatuese për veprime që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit; të dhëna për kontakte të subjektit me persona të papërshtatshëm; kopje të fashikujve të procedimeve penale të mosfilluara, të pushuara apo të pezulluara ku përmendet subjekti i rivlerësimit.

2. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me shkresën¹⁷⁰ dërguar Prokurorisë së Përgjithshme, konfirmon se pranë kësaj Prokurorie janë regjistruar procedimet penale nr. ***/2020 dhe nr. ***/2019, të mosfilluara ku përmendet emri i subjektit të rivlerësimit Violeta Shkurta (procedimi penal nr. ***/2020 është trajtuar më poshtë në denoncimin nr. ***, datë 20.3.2018, kurse procedimi penal nr. ***/2019 është trajtuar në denoncimin nr. ***, datë 5.7.2019, më poshtë).

3. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda i konfirmon¹⁷¹ KLP-së se pranë saj nuk është regjistruar procedim penal ndaj subjektit të rivlerësimit, por vetëm një kallëzim penal nga shtetasi Xh. K., kallëzim të cilin kjo prokurori ia ka përcjellë për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

¹⁶⁷Vendimi nr. ***, datë 23.10.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

¹⁶⁸Shkresa nr. *** prot., datë 19.4.2021, e Prokurorisë së Përgjithshme.

¹⁶⁹Prokuroritë e rretheve gjyqësore: Pogradec nr. *** prot., datë 29.1.2021; Sarandë nr. *** prot., datë 15.4.2021; Shkodër nr. *** prot., datë 29.1.2021; Lushnjë nr. *** prot., datë 29.1.2021; Mat nr. *** prot., datë 26.1.2021; Elbasan nr. *** prot., datë 29.1.2021; Fier nr. *** prot., datë 27.1.2021; Tiranë nr. *** prot., datë 28.1.2021; Krujë nr. *** prot., datë 27.1.2021; Durrës nr. *** prot., datë 3.2.2021; Gjirokastrë nr. *** prot., datë 27.1.2021; Korçë nr. prot. ***, datë 1.2.2021; Pukë nr. *** prot., datë 2.2.2021; Dibër nr. *** prot., datë 19.1.2021; Tropojë nr. *** prot., datë 26.1.2021; Kavajë nr. *** prot., datë 19.2.2021; Kurbin nr. *** prot., datë 27.1.2021; Përmet nr. *** prot., datë 26.1.2021; Kukës nr. *** prot., datë 1.2.2021; Berat nr. *** prot., datë 27.1.2021; Lezhë nr. *** prot., datë 1.2.2021.

¹⁷⁰Shkresë nr. *** prot., datë 8.2.2021, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

¹⁷¹Shkresë nr. *** prot., datë 21.12.2020, e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

4. Prokuroria e Përgjithshme konfirmon¹⁷² se pranë saj janë regjistruar 6 ankesa ndaj subjektit, konkretisht:

- *Praktika nr. ***/2015, ankesë e shtetasit Xh. L. (Xh.)*. Në lidhje me këtë praktikë, Prokuroria e Përgjithshme jep tablonë e disa konflikteve gjyqësore që bashkëshorti i subjektit ka pasur me ankuesin Xh. L. (Xh.) për pronësinë e dhomës në ish-hotel “****”, në përfundim të të cilave shtetasi Xh. L. (Xh.) ka humbur në të gjitha shkallët e gjykimit dhe kjo prokurori citon se ky shtetas u dëgjua dhe u sqarua nga ana e saj në lidhje me pretendimet e tij.

- *Praktika nr. ***/2019, ankesë e shtetasit A. Ç.*. Në lidhje me këtë praktikë, ankesa (për pasaportën që nuk i kthehet) është marrë në shqyrtim dhe Prokuroria e Përgjithshme e ka dërguar për kompetencë dhe zgjidhje në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (trajtuar më poshtë në denoncimet nr. **, datë 13.4.2021 dhe nr. **, datë 26.11.2019, të ankuesit A. Ç.).

- *Praktika nr. ***/2019, ankesë e shtetasve Xh. dhe F. K.*, e cila është dërguar¹⁷³ për kompetencë dhe zgjidhje në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Bashkëshortët K. kanë bërë kallëzim penal ndaj subjektit të rivlerësimit për veprën penale “shpërdorim detyre”. Në kallëzim pretendohet se në datën 12.6.2017 Prokuroria Fier ka regjistruar procedimin penal nr. ***/viti 2017 për veprën penale “vjedhje”, për të cilën subjekti ka dërguar për gjykim dy shtetas, ndërsa për bashkëpunëtorët e tjerë të panjohur ka veçuar materialet duke regjistruar procedimin penal nr. **, viti 2018 (trajtuar më poshtë në denoncimet nr. **, datë 16.1.2019 dhe nr. **, datë 5.7.2019, të ankuesve Xh. dhe F. K.). Me vendimin datë 30.7.2019 subjekti pezullon procedimin penal nr. ***/2018 dhe ndaj këtij vendimi bashkëshortët K. ankohen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, e cila me vendimin nr. **, datë 2.12.2019, nuk e ka pranuar ankimin e tyre.

Mbi bazën e kallëzimit penal të bashkëshortëve K., Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka regjistruar procedimin penal nr. **, datë 19.12.2019, për veprën penale “shpërdorim detyre” në ngarkim të subjektit të rivlerësimit. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë vendos¹⁷⁴ mosfillimin e këtij procedimi penal me arsyetimin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Prokurori arsyeton në vendim se: subjekti i ka kryer të gjitha veprimet e mundshme hetimore; nuk është organi i akuzës që vlerëson arsyet pse prokurorja ka disponuar me vendim pezullimi, por janë gjykatat ato që e vlerësojnë.

Kundër vendimit të Prokurorisë Vlorë, bashkëshortët K. kanë bërë ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila ka vendosur¹⁷⁵ mospranimin e ankimit:

- *Praktika nr. ***/2020, ankesë e shtetasit F. K., dërguar ILD-së me shkresë nr. **, datë 14.2.2020.*

- *Praktika nr. ***/2007, ankesë e shtetasit Xh. L. (Xh.)*. Me shkresën nr. **, datë 21.12.2007, ky shtetas ka kërkuar takim me Prokurorin e Përgjithshëm për t’i dorëzuar një material kundër subjektit të rivlerësimit. Nga ana e kësaj Prokurorie i është kërkuar që të dorëzojë këtë material, por më tej nuk ka asnjë korrespondencë apo veprim të këtij shtetasi.

- *Praktika nr. ***/2020, ankesë e shtetasit A. Ç.* (Prokuroria e Përgjithshme e ka dërguar ankesën në ILD, trajtuar më poshtë në denoncimin nr. **, datë 8.6.2020).

¹⁷²Shkresë nr. *** prot., datë 26.1.2021, e Prokurorisë së Përgjithshme.

¹⁷³Me shkresën nr. *** prot., datë 17.12.2019, të Prokurorisë së Përgjithshme.

¹⁷⁴Vendimi datë 24.12.2019 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

¹⁷⁵Vendimi nr. **, datë 4.3.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

DENONCIME NGA PUBLIKU

1. Denoncimet nr. *** prot., datë 13.4.2021 dhe nr. *** prot., datë 26.11.2019, nga shtetasi A. Ç.

1.1. Shtetasi A. Ç. pretendon se: “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier¹⁷⁶ ka pranuar kërkesën e prokurorit/subjekti i rivlerësimit dhe ka caktuar ndaj tij, masën e sigurisë ‘ndalim i daljes jashtë shtetit’. Prokuroria i ka sekuestruar pasaportën. Me vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë¹⁷⁷ ka përfunduar gjykimi dhe masa e sigurimit është shuar. Me vendimin nr. *** , datë 27.7.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fieri ka vendosur detyrimin e Prokurorisë Fier t’i kthejë denoncuesit pasaportën që ndodhet në dosjen gjyqësore nr. *** regjistri datë 3.11.2015 dhe regjistri nr. *** vendimi, datë 3.10.2017. Prej 3 vitesh nuk i kthehet pasaporta nga kryeprokurorja e Fierit, Violeta Shkurta, për motive të dobëta, hakmarrëse e të papërgjegjshme, e cila me dashje nuk zbaton vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Denoncuesi ka kërkuar 2 herë¹⁷⁸ nga subjekti i rivlerësimit kthimin e pasaportës dhe ka marrë përgjigjen se pasaporta ndodhet në dosjen që është nisur në Gjykatën e Lartë dhe kur të kthehet dosja në Gjykatën e Fierit do të kryhet kthimi i pasaportës”.

1.2. Komisioni, pasi shqyrtoi provat e bashkëlidhura denoncimit dhe pasi administroi¹⁷⁹ shkresën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe vendimet bashkëlidhur, vëren se: Me vendimin nr. *** , datë 25.10.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka caktuar masën e sigurimit personal “ndalim i daljes jashtë shtetit” ndaj shtetasit A. Ç. që hetohej për veprën penale “mashttrim”. Me urdhrin datë 29.10.2015, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar policinë gjyqësore të sekuestrojë pasaportën e këtij shtetasi dhe t’ia bashkojë pasaportën fashikullit të procedimit nr. ***.

1.3. Me vendimin nr. *** , datë 3.10.2017, kjo gjykatë ka vendosur dënimin e shtetasit A. Ç. me 7 vjet burgim për veprën penale “mashttrim në dëm të disa personave”. Ky vendim është ndryshuar me vendimin nr. *** , datë 13.6.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë, e cila ka vendosur pezullimin e dënimit me 5 vjet burgim dhe vënien në provë për 3 vjet me kusht të këtij shtetasi, por nuk është shprehur për shuarjen e masës së sigurimit personal “ndalim i daljes jashtë shtetit” dhe as për provën materiale të sekuestruar.

1.4. Me vendimin nr. *** , datë 27.7.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka pranuar kërkesën e shtetasit A. Ç. dhe ka vendosur kthimin e sendeve të sekuestruara, pasaportën e tij që ndodhet në dosjen gjyqësore penale nr. ***/2017. Ky vendim ka marrë formë të prerë pa u ankmuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier.

1.5. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit për sa duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka zbatuar vendimin nr. *** , datë 27.7.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për kthimin e pasaportës së denoncuesit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

1.6. Në prapësimet e barrës së provës dhe në seancën dëgjimore, subjekti pasi ka ripërmendur rrethanat si më lart duke shpjeguar se sapo dosja është kthyer nga Gjykata e Lartë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, është bërë ekzekutimi i vendimit të gjykatës në lidhje me kthimin e pasaportës së shtetasit A. Ç.. Këtë e provon me procesverbalin për ekzekutimin e urdhrin të ekzekutimit datë 22.4.2021.

¹⁷⁶Vendimi nr. *** , datë 25.10.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

¹⁷⁷Vendimi nr. *** , datë 13.6.2018, i Gjykatës së Apelit Vlorë.

¹⁷⁸Shkresat e datave 5.9.2019 dhe 11.10.2019 të denoncuesit A. Ç..

¹⁷⁹Shkresën nr. *** prot., datë 27.9.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, si dhe dosjen e procedimit penal nr. ***/2014, të tërhequr nga fashikulli nr. 14 i subjekti të rivlerësimit A. Y., e ndodhur në arkivin e Komisionit.

1.7. Bashkëlidhur prapësimeve, subjekti ka depozituar: (i) praktikën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. ***, datë 3.10.2017; (ii) praktikën e ekzekutimit të vendimit nr. ***, datë 27.7.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; (iii) korrespondencën e mbajtur me qëllim ekzekutimin e këtyre vendimeve; (iv) vendimin nr. ***, datë 22.9.2021, të ILD-së, “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara, paraqitur nga shtetasi A. Ç.”.

Vlerësimi i Komisionit

1.8. Komisioni, pasi mori në shqyrtim aktet e paraqitura nga subjekti bashkëlidhur prapësimeve, konstaton se evidentohet procesverbali datë 22.4.2021, i mbajtur midis oficerit të policisë gjyqësore të Prokurorisë Fier dhe shtetasit A. Ç. në lidhje me dorëzimin e pasaportës *** së këtij shtetasi.

Për sa më lart, Komisioni arrin në përfundimin se vendimi nr. *, datë 27.7.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për kthimin e pasaportës së denoncuesit, është zbatuar dhe subjekti nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për sa pretendon denoncuesi në denoncimin e tij.**

2. Denoncimet nr. * prot., datë 8.6.2020 dhe nr. *** prot., datë 31.7.2018, nga shtetasi A. Ç..** Denoncuesi pretendon se shtetasi K. Ç. në datën 18.2.2015 ka bërë deklaram të rremë kundër tij përpara oficerit të policisë. Shtetasi K.Ç. në qershor të vitit 2015 është liruar me kusht duke u vënë në provë për 5 vjet për një vepër penale dhe deklaramin e rremë e ka bërë gjatë kohës së provës. Subjekti edhe pse e ka ditur që deklarama ishte e rreme, nuk ka kryer funksionet e saj sepse nuk ka vendosur ta ndjekë penalisht personin që ka bërë deklaram të rremë dhe as ka kërkuar revokimin e pezullimit të dënimit për shkak të kryerjes së veprës penale gjatë kohës së provës. Denoncuesi e ka denoncuar deklaramtën e rreme para subjektit në vitet 2015, por ajo nuk ka kryer detyrën duke e zgatur afatin kohor që të zbatohet parashkrimi i ndjekjes penale; subjekti nuk ka hetuar rreth 30 prova të administruara në dosje sidomos dy letra dorëshkrim datë 30.4.2002; ka marrë deklaramtë nga K. dhe F. Ç. të dy me probleme mendore; nuk ka thirrur ekspertë të mjekësisë ligjore për të verifikuar aftësitë mendore të bashkëshortëve deklarues (Kodi i Procedurës Penale nenet 297, 155 dhe 156); nuk ka pyetur si dëshmitarë shtetasit J. Ç., A. S. dhe M. K.; subjekti nuk i ka vlerësuar dhe nuk ka hetuar për dy letërshkrimet e K. Ç. nga burgu drejtuar një personi (B.) për ta ndihmuar në lidhje me sekserë dhe avokatë që do të mundësonin bisedimet me ekspertët ligjorë dhe gjyqtarë për ta nxjerrë nga burgu.

2.1. Komisioni, pasi administroi dhe hetoi¹⁸⁰ aktet bashkëlidhur denoncimit, aktet e procedimit penal nr. ***, viti 2014, si dhe disa vendime gjyqësore, konstatoi se:

2.2. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, në datën 10.10.2014, mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit K. Ç. ka regjistruar procedimin penal nr. ***, viti 2014, në ngarkim të shtetasit A. Ç. për veprën penale “mashttrim”.

2.3. Gjatë hetimit, sipas autorizimit datë 18.2.2015 të subjektit që autorizon OPGJ R. Z. të kryejë veprime procedurale me shtetasin K. Ç. në IEVP-në Durrës. Janë marrë me cilësinë e provës deklaramet e shtetasit K. Ç. dhe bashkëshortes së tij F. Ç. sipas dy procesverbaleve në datat 18.2.2015 dhe 23.2.2015, ku deklarojnë rrethanat se si shtetasi A. Ç. i kishte marrë 2,000,000 lekë znj. F. Ç. me porosi të K., me qëllim për të ndihmuar këtë të fundit që të dilte nga burgu ku vuante dënimin për veprën penale “vrasje me paramendim”. Shtetasi K. Ç., në deklaramet e tij midis të tjerash, ka deklaruar edhe faktin që A. në vitin 2009 ka marrë

¹⁸⁰Shkresën nr. *** prot., datë 27.9.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, si dhe dosjen e procedimit penal nr. ***/2014, të tërhequr nga fashikulli nr. 14 i subjekti të rivlerësimit A. Y., e ndodhur në arkivin e Komisionit.

3,000,000 lekë nga shtetasi A. S. dhe i ka kthyer këtij vetëm 2,000,000 lekë, kurse 1,000,000 lekë nuk ia ka kthyer ende.

2.4. Me vendimin datë 22.10.2015, subjekti i rivlerësimit ka vendosur të marrë si të pandehur shtetasin A. Ç. për veprën penale “mashttrim” me pasoja të rënda për 2,000,000 lekë që i ka marrë shtetases F. Ç..

2.5. Në procesverbalin datë 4.10.2018, e ndodhur në dosjen e procedimit penal nr. ***, viti 2015, shtetasi A. Ç. deklaroi se kërkon që të bëjë kallëzim penal ndaj shtetasit K. Ç. dhe ka depozituar letrën datë 7.11.2017, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm ku akuzon K. për kallëzimin e rremë se shtetasi A. Ç. i ka marrë 3,000,000 lekë shtetasit A. S.

2.6. Në procesverbalin e pyetjes së të pandehurit datë 28.10.2015, shtetasi A. Ç. deklaroi se kërkon që të merret dosja gjyqësore e shtetasit K. Ç. që të shqyrtohen raportet mjekësore lidhur me faktin nëse është ai apo jo i përgjegjshëm nga ana mendore për kallëzimin që ka bërë ndaj A..

2.7. Në dosjen e këtij procedimi ndodhen edhe këto akte: dy raporte mjeko-ligjore të datave 8.12.2003 dhe 11.2.2009 nga grup ekspertësh psikiatër të caktuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, që konfirmojnë se shtetasi K. Ç. është me probleme mendore, etj.; deklarata noteriale datë 12.10.2017, ku shtetasi A. S. deklaroi se nuk ka pasur asnjë marrëdhënie financiare me z. A. Ç.. Në dosje nuk ka asnjë veprim nga subjekti në lidhje me qëndrimin e tij për këto prova.

2.8. Komisioni çmon se nevoja për të verifikuar përgjegjshmërinë e personit që ka bërë kallëzimin i përket vlerësimit dhe bindjes së brendshme të prokurorit.

2.9. Bashkëlidhur denoncimit janë edhe disa akte ku rezulton se me vendimin datë 6.7.2018 prokurori B. B. në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur mosfillimin e hetimeve mbi kallëzimin nr. ***, datë 22.6.2018, të shtetasit A. Ç. kundër shtetasit K. Ç. për “deklarim të rremë”. Në këtë vendim, prokurori citon se shtetasi K. Ç., në deklaratën e datës 18.2.2015 ku ka deklaruar se shtetasi A. Ç. i ka marrë shumën 3,000,000 lekë dhe i ka kthyer vetëm 2,000,000 shtetasit A. S., ka bërë deklarim të rremë pasi me deklaratën noteriale datë 12.10.2017 të shtetasit A. S. provohet se ky i fundit nuk ka pasur asnjëherë marrëdhënie financiare me z. A. Ç.. Në vijim, prokurori citon se vepra penale “deklarim i rremë përpara oficerit të policisë gjyqësore”, në bazë të nenit 66/c të Kodit të Procedurës Penale është parashkuar.

2.10. Nga procesverbali gjyqësor datë 6.2.2017, rezulton se vetë denoncuesi ka hequr dorë nga kërkesa për t’u pyetur si dëshmitar i shtetasve J. Ç., A. S. dhe F. Ç. (ndërsa në denoncim pretendon që subjekti nuk i pyeti).

2.11. Shtetasi A. Ç. u dënua nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit (më lart denoncimi 1, pika 1.3) për veprën penale “mashttrim në dëm të disa personave” dhe çështja është për gjykim në Gjykatën e Lartë.

2.12. Gjatë shqyrtimit të dosjes së procedimit penal nr. ***, Komisioni vëren edhe se me vendim datë 10.3.2015 subjekti ka vendosur kryerjen e aktekspertimit grafik dhe ky vendim është dërguar¹⁸¹ në Prokurorinë Fier në datën 4.8.2015, me shkresën nr. *** prot., datë 30.7.2015, të Drejtorisë së Policisë së Shtetit. Me vendimin datë 10.1.2015, subjekti vendos shtyrjen e afatit të hetimeve deri në datën 10.4.2015 me motivin se është kërkuar kryerja e aktekspertimit grafik, por se nuk ka ardhur ende ky akt. Me vendimin datë 10.10.2015, subjekti vendos sërish shtyrjen e afatit të hetimeve deri në datën 10.1.2016 me të njëjtin motiv edhe pse aktekspertimi kishte ardhur para dy muajsh.

¹⁸¹Me shkresën nr. *** prot., datë 30.7.2015, të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

2.13. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit nga ku duket se subjekti i rivlerësimit: (i) ka zvarritur 6 muaj afatin e hetimeve, pa motiv të nevojshëm; (ii) nuk ka regjistruar dhe hetuar deklarinimin e rremë të shtetasit K.Ç. ndaj shtetasit A.Ç.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

2.14. Në prapësimet e barrës së provës, subjekti ka shpjeguar se në lidhje me konstatimin e zgjatjes së afatit të hetimit, shkak për vonesën përveç ngarkesës në punë, është se kallëzuesi K. Ç. ishte duke vuajtur dënimin në IEVP-në Durrës, kurse i pandehuri A.Ç. ishte me banim në Tiranë dhe i shmangej paraqitjes para organit procedues duke u justifikuar me moshën dhe arsyet shëndetësore të dokumentuara në dosje.

2.15. Në datën 10.11.2015 shtetasi A.Ç. ka marrë kopjen e akteve të procedimit penal dhe nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për kallëzim penal për “deklarim të rremë” as në vitin 2015 gjatë hetimit, në përfundim të hetimit dhe në gjykim. Procedimi penal nr. *** ka filluar në datën 10.10.2014 dhe është dërguar për gjykim në datën 29.10.2015. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për këtë procedim penal, është dhënë në datën 3.10.2017 dhe fashikulli i procedimit penal është arkivuar në datën 3.10.2017.

2.16. Në fashikullin e procedimit penal nr. ***, me shkresën nr. *** prot., *** datë 19.1.2018, të ardhur për kompetencë nga Prokuroria e Përgjithshme është bashkëlidhur: letra datë 7.11.2017, e shtetasit A.Ç. drejtuar kësaj prokurorie; deklarata noteriale datë 12.10.2017 e shtetasit A.S.; si dhe kopja e procesverbalit datë 8.12.2015 e deklarinimit të shtetasit K.Ç. Mbi këto akte, në Prokurorinë Fier në datën 8.10.2018 është regjistruar kallëzimi penal nr. *** i shtetasit A.Ç. për veprën penale “deklarim i rremë” dhe është caktuar për ta ndjekur prokurori Ç. S., i cili ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Këto akte janë depozituar gabimisht në fashikullin e procedimit penal nr. ***, që është arkivuar qysh më 3.10.2017. Gjithashtu, deklarata noteriale datë 12.10.2017 e shtetasit A.S. nuk përbën provë në kuptim të neneve 149 dhe 151 të Kodit të Procedurës Penale.

2.17. Bashkëlidhur prapësimeve, subjekti ka depozituar: kopje të fashikullit të kallëzimit penal nr. ***, viti 2018; shkresat nr. *** prot., datë 22.9.2021 dhe nr. *** Prot., datë 22.9.2021 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në lidhje me arkivimin e ankesave të paraqitura nga shtetasi A.Ç. ndaj subjektit të rivlerësimit; si dhe kopje të fashikullit të procedimit penal nr. ***, viti 2015.

Vlerësimi i Komisionit

2.18. Në lidhje me prapësimet e subjektit ndaj konstatimit të Komisionit se subjekti ka zvarritur 6 muaj afatin e hetimeve pa motiv të nevojshëm, Komisioni vëren se në dosjen e procedimit penal nr. ***, që Komisioni ka tërhequr nga fashikulli nr. 14 i subjektit të rivlerësimit A.Y.¹⁸², ka vetëm një kërkesë pa datë nga shtetasi A.Ç., drejtuar subjektit gjatë hetimeve se nuk mund të paraqitet në Fier për arsye shëndetësore. Pra, faktet që paraqet subjekti si shkaqe për shtyrjen e afateve të hetimit, nuk qëndrojnë.

2.19. Në vendimet për zgjatje të afateve të hetimit, siç rezulton nga dosja, pavarësisht se nga ana formale subjekti e ka arsyetuar shtyrjen e afateve të hetimit siç kërkon neni 324 i Kodit të Procedurës Penale “*Vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve jepet i arsyetuar...*”, sërish siç parashtron Komisioni në pikën 2.12 më lart, arsyet e shtyrjes nuk qëndrojnë. Në këtë këndvështrim, prapësimet e subjektit nuk merren në konsideratë.

¹⁸²Fashikulli nr. 14 i subjektit të rivlerësimit A.Y., i ndodhur në arkivin e Komisionit, dërguar në Komision me shkresën nr. *** prot., datë 13.3.2019, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier.

2.20. Në lidhje me konstatimin e Komisionit se subjekti nuk ka regjistruar dhe hetuar deklarin e rremë të shtetasit K. Ç. ndaj shtetasit A.Ç., Komisioni vlerëson se qëndrojnë faktet dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti në prapësime për sa i takon faktit që kallëzimi për “deklarim i rremë” nuk është depozituar nga denoncuesi A.Ç. gjatë periudhës që subjekti ishte ngarkuar për të ndjekur procedimin penal nr. *** dhe, në këto kushte, subjekti nuk ka pasur dijeni. Për këto arsye Komisioni i merr në konsideratë prapësimet e subjektit të rivlerësimit.

Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka zvarritur për disa muaj afatin e hetimeve, pa arsye, duke vepruar në kundërshtim me nenin 324 të Kodit të Procedurës Penale.

3. Denoncimet: nr. * prot., datë 20.10.2020; nr. *** prot., datë 14.9.2018; nr. *** prot., datë 14.11.2018, nga *** (OSPN), përfaqësuar nga shtetasi G.T.**

3.1 OSPN-ja bën denoncime për disa prokurorë dhe gjyqtarë, kurse në lidhje me subjektin e rivlerësimit, pretendon se me çështjen penale nr. *** akti, viti 2019 është kërkuar të urdhërohet Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier që të zbatojë vendimin nr. ***, datë 23.3.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Denoncuesi ka bërë kallëzimin penal nr. ***, për veprën penale ‘falsifikim i dokumenteve’ dhe “vjedhje me anë të mashtrimit”, por subjekti me vendimin datë 8.1.2018 ka vendosur “Pushimin e procedimit penal” me argumentin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, e cila me vendimin nr. ***, datë 23.3.2018 ka pranuar ankimin, ka urdhëruar Prokurorinë pranë Rrethit Gjyqësor Fier të regjistrojë procedimin penal dhe të kryejë hetimet e nevojshme. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 14.6.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë. Deri në datën 6.9.2018 subjekti nuk ka kryer asnjë veprim. Denoncuesi, në datën 7.9.2018, i ka kërkuar Prokurorisë Fier zëvendësimin e subjektit, por ka marrë përgjigjen¹⁸³ se kërkesa është e pabazuar pasi nuk jemi në rastet e parashikuara nga neni 27 i Kodit të Procedurës Penale. Denoncuesi kërkon që prokurorë Violeta Shkurta të heqë dorë nga hetimi i çështjes penale për arsyen se ka zvarritur hetimin dhe ka fshehur faktet dhe provat.

3.2 Komisioni, pasi administroi¹⁸⁴ shkresat e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe të Prokurorisë pranë kësaj gjykate, si dhe aktet bashkëlidhur, vëren se:

3.3 Pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, shtetasi G.T. ka bërë kallëzimin penal nr. ***, datë 20.9.2017, për veprën penale “falsifikim të dokumenteve” dhe “vjedhje me anë të mashtrimit”. Subjekti i rivlerësimit, pasi ka kryer disa veprime hetimore, me vendimin datë 8.1.2018 (pas 3.5 muajsh nga data e regjistrimit të kallëzimit penal dhe jo brenda 15 ditëve sipas nenit 291/1 të Kodit të Procedurës Penale) ka vendosur “Mosfillimin e procedimit penal nr. ***” (neni 290/1 germa “ç”, neni 291, neni 59 i Kodit të Procedurës Penale) me argumentin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

3.4 Ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, e cila pasi ka konstatuar edhe këtë mangësi, me vendimin nr. ***, datë 23.3.2018, ka pranuar ankimin, ka urdhëruar Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier të regjistrojë procedimin penal, të kryejë hetimet e nevojshme dhe i ka caktuar disa detyra. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 14.6.2018.

3.5 Pasi vendimi nr. ***, datë 14.6.2018, ka marrë formë të prerë, subjekti ka regjistruar procedimin penal nr. *** për veprën penale “mashttrim”. Në datën 19.9.2018 subjekti i

¹⁸³Shkresë nr. *** prot., datë 11.9.2018, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

¹⁸⁴Me shkresën nr. *** prot., datë 22.12.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe shkresën nr. *** prot., datë 28.12.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

rivlerësimi i ka paraqitur Drejtuesit të Prokurorisë dorëheqjen nga ky procedim penal, i cili ka pranuar dorëheqjen duke e zëvendësuar me një prokurorë tjetër dhe ky procedim është ende në hetim pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier.

3.6 Në lidhje me procedimin penal nr. ***, rezulton që nuk është palë denoncuesi dhe gjithsesi ky procedim është në hetim pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier.

3.7 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit për sa duket se: (i) subjekti ka marrë vendim për mosfillimin e procedimit penal 3.5 muaj pas datës së regjistrimit të kallëzimit penal dhe jo brenda 15 ditëve siç parashikon neni 291/1 i Kodit të Procedurës Penale; (ii) subjekti i rivlerësimi ka kryer një hetim jo të plotë që konsiston në veprime hetimore të mangëta, me pasojë marrjen e vendimit për “Mosfillimin e procedimit penal nr. ***”, vendim i cili nuk është gjetur i drejtë nga gjykatat e të dyja shkallëve të gjykimit që kanë vendosur të urdhërojnë prokurorinë që të regjistrojë procedimin penal dhe të kryejë hetimet e nevojshme.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimi

3.8 Në prapësimet e barrës së provës, subjekti i rivlerësimi e ka pranuar se ka vendosur mosfillimin e procedimit penal jashtë afatit procedural, por e justifikon këtë veprim me argumentin se ka qëndrime të ndryshme teorike dhe praktike në lidhje me këtë afat dhe vetë subjekti e ka konsideruar të pamjaftueshëm këtë afat për të regjistruar një procedim pa një minimum provash.

Vlerësimi i Komisionit

3.9 Në lidhje me prapësimet e subjektit ndaj konstatimit të Komisionit për moszbatimin e afatit procedural të mosfillimit të procedimit penal, Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse, aq më tepër kur bëhet fjalë vetëm për zbatimin korrekt të një dispozite të qartë ligjore siç është neni 291/1 i Kodit të Procedurës Penale, e cila nuk lë shteg për interpretime dhe qëndrime subjektive të organeve ligjzbatuese.

3.10 Në lidhje me konstatimin e dytë të Komisionit, subjekti nuk ka dhënë shpjegime.

3.11 Bashkëlidhur prapësimeve, subjekti ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 22.12.2020, të ILD-së për njoftimin e vendimit nr. ***, datë 22.12.2020, “Për arkivimin e ankesave të bashkuara të paraqitura nga OSPN P.”.

Për sa më lart, Komisioni arrin në përfundimin se:

- **Subjekti i rivlerësimi ka marrë vendim për mosfillimin e procedimit penal 3.5 muaj pas datës së regjistrimit të kallëzimit penal dhe jo brenda 15 ditëve, siç parashikon neni 291/1 i Kodit të Procedurës Penale.**
- **Nga ana e subjektit të rivlerësimi nuk është kryer një hetim i plotë që konsiston në veprime hetimore të mangëta, me pasojë marrjen e vendimit për “Mosfillimin e procedimit penal nr. ***”, vendim i cili nuk është gjetur i drejtë nga gjykatat e të dyja shkallëve të gjykimit që kanë vendosur të urdhërojnë prokurorinë që të regjistrojë procedimin penal dhe të kryejë hetimet e nevojshme, duke vepruar kështu në kundërshtim me funksionet e tij të përcaktuara nga Kodi i Procedurës Penale.**

4. Denoncimi nr. * prot., datë 22.1.2020, nga shtetasi P.P.**

4.1 Denoncuesi pretendon se ka bërë kallëzimin penal nr. *** për veprën penale “falsifikim i dokumenteve” të ndodhur në datën 8.4.1998. Subjekti, me vendimin datë 21.5.2019 ka vendosur “Mosfillimin e procedimit penal” për arsye se ndjekja penale për këtë vepër është parashkruar. Meqenëse dokumenti i falsifikuar “vërtetim datë 8.4.2018 i kryetarit të Rajonit nr. *** Bashkia Fier” është përdorur në një gjykim civil dhe për shkak të këtij dokumenti ai

ka humbur gjyqin, denoncuesi i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit që të urdhërojë asgjësimin e këtij dokumenti. Subjekti i ka kthyer përgjigje se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka lënë në fuqi vendimin për mosfillimin e procedimit penal dhe, për këtë arsye, ndalohet ligjërisht kryerja e veprimeve të tjera hetimore sikurse është asgjësimi i dokumentit dhe, për rrjedhojë, refuzon kërkesën e tij.

4.2 Rezulton se me shkresën nr. *** prot., datë 16.1.2020, “Përgjigje për z. P.P.”, subjekti i rivlerësimit jo vetëm që nuk citon dispozitën ligjore, që sipas tij ndalon asgjësimin e dokumentit, por edhe gabon duke refuzuar kërkesën e denoncuesit sepse neni 190 i Kodit të Procedurës Penale përcakton: “Në vendimin përfundimtar ose në atë të pushimit të çështjes, gjykata ose prokurori caktojnë se çfarë duhet bërë me provat materiale duke urdhëruar: (a) ...; (b) sendet, mbajtja ose qarkullimi i të cilave është i ndaluar, u dorëzohen enteve përkatëse ose zhduken; (c) sendet që nuk kanë asnjë vlerë zhduken”.

4.3 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit për sa duket se subjekti ka refuzuar në kundërshtim me ligjin një kërkesë procedurale të kallëzuesit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

4.4 Në prapësimet e barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se procedimi penal nr. *** për veprën penale “falsifikim i dokumenteve” është ndjekur nga prokurore E. H., ndërsa subjekti ka nënshkruar vetëm këto dy akte të përpiluara nga prokurorja e çështjes: shkresën nr. *** prot., datë 24.5.2019, për t’i njoftuar kallëzuesit vendimin datë 21.5.2019 të pushimit të procedimit, si dhe shkresën nr. *** prot., datë 15.1.2020, “Përgjigje për z. P.P.” për refuzimin e kërkesës mbi asgjësimin e dokumentit të falsifikuar.

4.5 Në vijim, subjekti shpjegon se në cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë nuk ka tagër që të disponojë për provat materiale të një çështjeje penale të hetuar nga një prokuror tjetër, pasi prokurorët janë të pavarur në ushtrimin e funksioneve të tyre të hetimit, të përfaqësimit të akuzës në gjykim dhe të disponimit mbi provat materiale.

4.6 Bashkëlidhur prapësimeve, subjekti ka depozituar: (i) vendimin nr. ***, datë 1.7.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (i lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 22.10.2019, të Gjykatës së Apelit Vlorë) që ka rrëzuar ankimin e shtetasit P.P. ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal; (ii) vendimin nr. ***, datë 2.4.2021, të ILD-së “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së shtetasit P.P.”; (iii) kërkesën datë 3.6.2019 të shtetasit P.P. drejtuar Prokurorisë Fier.

Vlerësimi i Komisionit

4.7 Komisioni, pasi administroi provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, vëren se sipas vendimit datë 21.5.2019 “Për mosfillimin e procedimit penal” rezulton se procedimi penal nr. *** për veprën penale “falsifikim i dokumenteve” është ndjekur nga prokurore E. H.

Për sa më lart, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për sa pretendon denoncuesi, aq më tepër që vendimi i prokurores së çështjes është vlerësuar nga gjykatat e dy shkallëve të gjykimit.

5. Denoncimi nr. * prot., datë 15.1.2020, nga shtetasja A.A.**

5.1 Denoncuesja pretendon se bashkëshorti i saj E.A., më 21.8.2018, në aksin rrugor Fier-Vlorë është përfshirë në një aksident prej 3 automjeteve me pasojë vdekjen e një personi dhe plagosjen e tre personave të tjerë. Çështja është hetuar nga subjekti i rivlerësimit së bashku me një prokuror tjetër, të cilët kanë kërkuar dënimin e z. E.A. si fajtor për pasojat e aksidentit, pa u bazuar në aktekspertimin autoteknik. Sipas këtij akti, shtetasi E.A. ka kryer vetëm

“Mospozicionim të rregullt në karrexhatë”, vepër për të cilën parashikohet vetëm dënimi me gjobë nga Kodi Rrugor. Duhej të dënohej edhe shtetasi A.S. si shkaktar i aksidentit.

5.2 Komisioni, pasi administroi¹⁸⁵ dhe shqyrtoi vendimin nr. ***, datë 30.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe vendimin nr. ***, datë 16.9.2020, të Gjykatës së Apelit Vlorë, vëren se subjekti i rivlerësimit ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore.

5.3 Subjekti i rivlerësimit ka dërguar çështjen për gjykim dhe ka kërkuar shpalljen fajtor të shtetasit E.A. për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 8 vjet burgim. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur deklarinimin fajtor të këtij shtetasi për veprën penale të parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 vjet burgim. Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr.***, datë 16.9.2020. Çështja është për gjykim në Gjykatën e Lartë.

Për sa më lart, Komisioni nuk konstatoi mangësi në veprimet procedurale të subjektit të rivlerësimit.

6. Denoncim nr. * prot., datë 20.3.2018, nga shtetasi D.Y.**

6.1 Denoncuesi pretendon se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier po gjykohet kërkesa e subjektit të rivlerësimit lidhur me pushimin e procedimit penal në ngarkim të shtetasit A.A. për veprën penale “shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor me pasojë vdekjen” (viktima, shtetasi A.Y. është vëllai i denoncuesit). Prokurorja e çështjes, padrejtësisht kërkon pushimin e çështjes duke u bazuar në një aktekspertimi të njëanshëm dhe aspak profesional, ku vërehen: mungesa e analizës teknike në përpunimin e dinamikës së ngjarjes; kundërshti e aktekspertimit në raport me provat e tjera në dosje; aktekspertimi bazohet vetëm në deklarinimin e personit nën hetim A.A. dhe jo në provat e tjera të dosjes (procesverbali i këqyrjes së vendngjarjes, deklarinimet e dëshmitarëve dhe fotot e policisë, etj.); nuk është analizuar fakti që aksidenti do të ndodhte ose jo, nëse shtetasi A.A. do të kishte zbatuar rregullat e qarkullimit lidhur me respektimin e shpejtësisë dhe pozicionimin e duhur në karrexhatë; nga eksperti nuk është llogaritur drejtë shpejtësia e automjetit që drejtohej nga shtetasi A.A.; eksperti qëllimisht nuk ka evidentuar shkakun determinant të aksidentit, por është përgjigjur në mënyrë të tërthortë dhe joshkëcore. Prokurorja e çështjes Violeta Shkurta nuk ka pranuar kërkesën për riekspertim.

6.2 Komisioni, pasi administroi¹⁸⁶ dosjen e procedimit penal nr. ***, datë 29.9.2017, vëren se: Në datën 28.9.2017, në aksin rrugor Levan-Fier ka ndodhur një aksident automobilistik ku janë përfshirë automjeti tip “Land Rover” i shtetasit A.A. dhe automjeti tip “Mercedes-Benz” i shtetasit A.Y. Si pasojë e përplasjes midis dy automjeteve ka humbur jetën shtetasi A.Y. dhe është plagosur shtetasi A.M. që ndodhej në një automjet me viktimën. Për këtë arsye është regjistruar procedimi penal për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor” (neni 290/3 i Kodit Penal). Pasi janë administruar provat e nevojshme për hetimin në datën 4.10.2017 subjekti ka vendosur kryerjen e aktekspertimit autoteknik dhe caktimin e një eksperti dhe detyrave për ekspertin.

6.3 Në procesverbalin datë 29.9.2017 të marrjes së të dhënave nga personi që ka dijeni për rrethanat e ngjarjes, shtetasi A.A. ka deklaruar se i ka ardhur përballë një automjet tip “Ford” gri me targa ***, që parakaloi në mënyrë të gabuar dhe hyri në korsinë e tij. Për të shmangur përplasjen, eci në të djathtë të rrugës ku ndeshi në praninë e ujit 20 cm sepse binte shi i

¹⁸⁵Shkresë nr. ***, datë 23.12.2021.

¹⁸⁶Me shkresat: nr. *** prot., datë 22.12.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; nr. *** prot., datë 22.12.2020, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. *** prot., datë 8.2.2021, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

rrëmbyer, humbi kontrollin e automjetit sepse nuk kapnin frenat dhe ka devijuar rrugën duke u përplasur me automjetin e shtetasit A.Y.. Në vijim, shtetasi A.A. ka deklaruar se në pjesën ku ndeshi ujë, rruga nuk ka kanal dhe ujërat e një biznesi inertesh që është mbi nivelin e rrugës, derdhen në rrugë.

6.4 Të gjithë dëshmitarët e pyetur kanë deklaruar se ditën e aksidentit binte shi i imët dhe vetëm një dëshmitar ka deklaruar se rruga mban ujë në pjesën që është 400 m më poshtë nga vendi i aksidentit (pra, shumë larg si distancë). Edhe pronari i biznesit të inerteve, i pyetur gjatë hetimit në cilësinë e dëshmitarit, ka deklaruar se në atë pjesë rruga ka kanal dhe nuk mban ujëra. Në asnjë akt tjetër në dosje nuk citohet fakti që rruga mban ujë, madje nga fotot duket rruga pa gjurmë uji.

6.5 I pyetur, shtetasi i dëmtuar A.M. deklaron se kanë qenë duke ecur në korsinë e tyre dhe panë se po vinte drejt tyre automjeti tip “Land Rover” që ecte në mënyrë të çrregullt dhe, për këtë arsye, A. uli fare shpejtësinë e automjetit dhe u pozicionua shumë në të djathtë të karrexhatës, por automjeti tip “Land Rover” u erdhi përballë nga ana e shoferit dhe i goditi.

6.6 Në aktekspertimin e kryer datë 11.10.2007 është cituar se automjeti tip “Mercedes-Benz” nuk ka shkelur rregullat e qarkullimit rrugor dhe se shpejtësia e matur e automjetit tip “Land Rover” që drejtonte shtetasi A.A. është 70 km/orë (më e madhe se shpejtësia 60 km/orë e lejuar në atë segment rruge sipas tabelës referuese në rrugë). Në përfundim, eksperti ka konkluduar se: Ky aksident rrugor nuk mund të shmangej me praninë e ujërave dhe lagështisë në rrugë, pra e faktorit të jashtëm atmosferik në momentin e ndodhjes së aksidentit, i cili ishte shkaku që ka sjellë humbjen e kontrollit të automjetit tip “Land Rover” i drejtuar nga shtetasi A.A.

6.7 Të aksidentuarit i kanë kërkuar¹⁸⁷ subjektit përsëritjen e aktekspertimit dhe dërgimin për gjykim të shtetasit A.A., duke pretenduar midis të tjerash se eksperti nuk ka llogaritur shpejtësinë që automjeti tip “Land Rover” ka humbur pas përplasjes dhe po ta llogariste, shpejtësia reale e automjetit tip “Land Rover” do të ishte mbi 70 km/orë.

6.8 Subjekti ka vendosur¹⁸⁸ mospranimin e kërkesës me argumentin se shpejtësia është llogaritur nga eksperti sipas teknikave përkatëse dhe shkak i aksidentit nuk ka qenë shpejtësia, por lagështia në rrugë.

6.9 Gjatë hetimit, mbi kërkesën e datës 18.10.2017 të subjektit të rivlerësimit është administruar shkresa nr. *** prot., datë 27.10.2017, e DPSHTRR-së me të gjithë emrat e pronarëve që disponojnë automjetet me targën *** të automjetit që parakaloi dhe e detyroi shtetasin A.A. të humbasë kontrollin e automjetit. Nga dosja hetimore rezulton se subjekti nuk thirri asnjë nga këta persona për t'i pyetur, duke mos hetuar kështu faktin nëse ka pasur një mjet që ka bërë parakalim të gabuar ose jo.

6.10 Në datën 22.12.2017 subjekti i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier pushimin e procedimit penal ndaj shtetasit A.A., pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Gjykata, me vendimin nr. ***, datë 29.3.2018, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, kthimin e akteve prokurorisë¹⁸⁹ duke urdhëruar kryerjen e një aktekspertimi autoteknik të ri me grup ekspertësh, pasi aktekspertimi autoteknik ku subjekti ka bazuar vendimin e pushimit të procedimit nuk ka dhënë përgjigje të qartë se kush ka qenë shkaku determinat i aksidentit, si dhe nuk i ka dhënë përgjigje pyetjes që nëse personi nën hetim do të kishte lëvizur brenda shpejtësisë së lejuar a do të kishte mundësi të shmangte pasojat e aksidentit pavarësisht nga faktorët e jashtëm?

¹⁸⁷Kërkesa nr. ***, datë 24.11.2017, e avokatëve të aksidentuarve.

¹⁸⁸Vendimi datë 15.12.2017 i subjektit të rivlerësimit.

¹⁸⁹Me shkresën nr. *** prot., datë 16.4.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

6.11 Nga dosja nuk rezulton që subjekti ka bërë ankim ndaj vendimit të gjykatës. Në datën 20.4.2018 subjekti ka dhënë dorëheqjen nga hetimi i procedimit penal nr. ***, nisur nga kërkesa e familjarëve të viktimës dhe është zëvendësuar me një prokuror tjetër. Nga aktekspertimi datë 30.5.2018 (me grup ekspertësh), i kryer pasi subjekti ka dhënë dorëheqjen, ka rezultuar se shtetasi A.A. ka qenë me shpejtësi 110 km/orë.

6.12 Mbi bazën e kallëzimit të shtetases D.Y., në Prokurorinë e Posaçme është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, datë 24.2.2020, ndaj subjektit të rivlerësimit Violeta Shkurta dhe një prokurori tjetër që ka hetuar këtë procedim, për “shpërdorim detyre”. Pasi i kanë kaluar aktet për kompetencë, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Vlorë ka vendosur¹⁹⁰ mosfillimin e procedimit penal sepse faktet nuk parashikohen nga ligji si vepër penale.

6.13 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit për sa duket se subjekti i rivlerësimit për periudhën deri në datën e dorëheqjes së saj nga hetimi nuk ka kryer hetime të plota në lidhje me faktorët e jashtëm që pretendohet se kanë ndikuar në ardhjen e aksidentit (nuk ka thirrur për të pyetur pronarët e automjeteve me targa ***, nuk ka këqyrur vendngjarjen në vendin ku A.A. pretendon se rruga mban ujë apo nuk ka bërë eksperiment për të provuar këtë fakt), por është bazuar në vendimmarrje në një aktekspertim të pasaktë dhe në deklarinimin e personit nën hetim, duke u dhënë vlerë të paracaktuar këtyre provave dhe duke mos i vlerësuar në unitet me provat e tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre (nenet 149, 152, 171, 173, 176, 198 dhe 313 të Kodit të Procedurës Penale) dhe, për pasojë, gjykata ia ka kthyer aktet për rihetim.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

6.14 Në prapësimet e barrës së provës subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se i ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore. Vendimi i saj për pushimin e procedimit penal është vlerësuar nga gjykata si i vetmi organ që ushtron kontroll mbi veprimtarinë hetimore të prokurorit në hetime paraprake (neni 42 i Kushtetutës dhe neni 332 i Kodit të Procedurës Penale) dhe në këtë aspekt Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka urdhëruar kryerjen vetëm të një veprimi hetimor, përsëritjen e aktekspertimit autoteknik me grup ekspertësh.

6.15 Në lidhje me mospranimin e kërkesës së të aksidentuarit për përsëritjen e aktekspertimit dhe dërgimin për gjykim të shtetasis A.A., subjekti ka shpjeguar se me vendimin datë 15.12.2017 ka vendosur mospranimin e kërkesës me një vendim të arsyetuar, të mbështetur në provat e marra gjatë hetimeve paraprake.

6.16 Në vijim, subjekti shpjegon se disa veprime hetimore që sipas Komisionit nuk janë kryer gjatë hetimeve, siç janë eksperimenti për të provuar faktin se në segmentin rrugor ku ndodhi aksidenti rruga mban ujë, këqyrja e vendit të ngjarjes për të provuar që rruga mban ujë, etj., nuk mund të kryhen pasi objektivisht është i pamundur riprodhimi i ngjarjes.

6.17 Në seancë dëgjimore, në lidhje me faktin që nuk ka thirrur për të pyetur personat që sipas shkresës nr. *** prot., datë 27.10.2017, të DPSHTRR-së disponojnë automjetet me targën *** të automjetit që parakaloi dhe e detyroi shtetasin A.A. të humbasë kontrollin e automjetit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se numri i këtyre personave ishte shumë i madh dhe nuk e konsideronte të lehtë thirrjen e të gjithë atyre.

6.18 Bashkëlidhur prapësimeve, subjekti ka depozituar disa shkresa, pjesë e korrespondencës me Drejtorinë e Policisë Rrugore të disa rretheve dhe me DPSHTRR-në, të cilat janë në dosje dhe janë shqyrtuar nga Komisioni gjatë hetimit.

Vlerësimi i Komisionit

¹⁹⁰Vendimi datë 27.2.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

6.19 Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ka kryer hetime të plota dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier i ka urdhëruar vetëm të kryejë një aktekspertimi të ri, Komisioni vlerëson se vendimi i gjykatës në fazën e hetimeve paraprake është orientues për organin e ndjekjes penale, por orientimet e gjykatës nuk do të thotë se janë shteruese për një hetim të gjithanshëm me qëllim arritjen në një konkluzion të drejtë nga organi i akuzës. Gjykata ka arritur në konkluzionin se aktekspertimi nuk është bindës duke e vlerësuar atë në raport me provat e tjera të administruara gjatë hetimit (si pohimi i të dëmtuarit se drejt automjetit të tij ka ardhur me shpejtësi automjeti i shtetasit A.A.), vlerësim që subjekti i rivlerësimit nuk rezulton ta ketë bërë. Prandaj edhe gjykata ka shtruar për zgjidhje nga grupi i ekspertëve pyetjen që nëse personi nën hetim do të kishte lëvizur brenda shpejtësisë së lejuar, a do të kishte mundësi të shmange pasojat e aksidentit pavarësisht nga faktorët e jashtëm.

6.20 Sipas aktekspertimit me grup ekspertësh është konkluduar se shtetasi A.A. ka qenë me shpejtësi 110 km/orë.

6.21 Në lidhje me shpjegimet e subjektit se ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës së të dëmtuarit për përsëritjen e aktekspertimit dhe për dërgimin e shtetasit A.A. në gjykim, duke u bazuar në provat e marra gjatë hetimeve paraprake, Komisioni vëren se siç citohet në pjesën arsyetuese të vendimit, këtë vendim subjekti e ka marrë duke u bazuar vetëm në aktekspertimin e parë, i cili u refuzua nga gjykata.

6.22 Subjekti i rivlerësimit, për periudhën deri në datën e dorëheqjes së saj nga hetimi, nuk ka kryer hetime të plota në lidhje me faktorët e jashtëm që pretendohet se kanë ndikuar në ardhjen e aksidentit dhe nuk ka përfunduar veprimin hetimor të filluar pasi nuk ka thirrur për të pyetur pronarët e automjeteve me targa ***.

Për sa më lart, Komisioni arrin në përfundimin se nga subjekti i rivlerësimit nuk janë kryer veprime të hetimore të plota, por që në tërësinë e tyre nuk vlerësohen deri në atë masë sa që ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra në lidhje me kriterin profesional.

7. Denoncim nr. * prot., datë 19.4.2018 dhe nr. *** prot., datë 16.1.2019 nga shtetasi L.S.**

7.1 Denoncuesi pretendon se pranë Prokurorisë Fier ka bërë kallëzimin penal nr. ***, viti 2017, kundër shtetasës M.N. për veprën penale “kallëzim i rremë”. Prokurore Violeta Shkurta, me vendimin datë 15.10.2017, ka vendosur “Mosfillimin e procedimit penal”, pa kryer asnjë veprim hetimor, por vetëm duke u bazuar në një vendim tjetër të Prokurorisë Fier.

7.2 Nga analiza e kryer akteve bashkëlidhur denoncimit konstatohet se në vendimin datë 15.10.2017, subjekti, bazuar në nenin 290/1, germa “ç” dhe në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, duke iu referuar vendimit datë 8.12.2016 të prokurorit E.R., arsyeton se prokurori tjetër në procedimin penal nr. *** ka kryer hetime dhe nëse do të konstatonte elementët e veprës “kallëzim i rremë” do të kishte hetuar edhe për këtë vepër penale kryesisht.

7.3 Denoncuesi ka bërë ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier kundër vendimit të subjektit dhe kjo gjykatë me vendimin nr. ***, datë 15.3.2018, ka vendosur mospranimin e ankimit, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë¹⁹¹.

Për sa më lart, Komisioni nuk konstaton mangësi në veprimet procedurale të subjektit të rivlerësimit.

8. Denoncim nr. * prot., datë 25.7.2018, nga shtetasi S.A.** Denoncuesi pretendon se prokurore Violeta Shkurta ka shkëlur etikën profesionale sepse e ka pritur me ton të ashpër,

¹⁹¹Vendimi nr. ***, datë 15.5.2018, i Gjykatës së Apelit Vlorë.

nuk e ka thirrur asnjëherë që ta marrë në pyetje, nuk ka bërë proces të rregullt hetimor dhe nuk i ka komunikuar vendimin e mosfillimit të procedimit penal.

8.1 Komisioni ka administruar¹⁹² dosjen e procedimit penal nr. *** dhe dokumentet bashkëlidhur denoncimit, ku rezulton se pranë Prokurorisë Fier, në datën 1.12.2015, është protokolluar kallëzimi penal datë 1.11.2015 i shtetasit S.A. kundër shtetases N.K., i cili pretendon se kjo eksperte ka bërë “ekspertim të rremë” (neni 309 i Kodit Penal). Denoncuesi ka bërë edhe një shtesë të kallëzimit penal, ku citon se dyshon që në dokumentacionin e paraqitur nga shtetasi I.A. pranë ALUIZN-it, ndodhet ndonjë nga ekzemplarët e asgjësuar nga Prokuroria Fier në datën 18.7.2014 si dokumente të falsifikuara.

8.2 Me kërkesën datë 8.1.2018, denoncuesi i kërkon subjektit që ta njohë me dosjen hetimore nr. *** sepse nuk është thirrur asnjëherë për t’u pyetur me ecurinë e kallëzimit të tij.

8.3 Për qëllime të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka administruar provat bashkëlidhur kallëzimit dhe dosjen gjyqësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë për çështjen me paditës shtetasin S.A., i paditur – ZRPP-ja, objekti – detyrimi i ZRPP-së të ndryshojë urdhrin nr. ***, datë 26.1.2015, që ka rrëzuar kërkesën e shtetasit S.A. për të regjistruar vendimin nr. ***, datë 23.7.2014, të AKKP-së. Kjo gjykatë, me vendimin gjyqësor nr. ***, datë 7.12.2015, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë.

8.4 Nga studimi i dosjes hetimore dhe gjyqësore, rezulton se:

8.5 Me shkresat e datave 24.5.2012 dhe 27.11.2015, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier konfirmon se shtetasja N.K. figuron e regjistruar me NIPT *** me aktivitet vlerësuese e pasurive të paluajtshme dhe me status “e çregjistruar” në datën 29.5.2008.

8.6 Ekspertja vlerësuese e pasurive të paluajtshme, N.K., ka kryer aktekspertimin datë 14.11.2015, që përcakton mbivendosje prej 202 m² midis dy pronave duke iu referuar të gjitha akteve nga kanë origjinën këto dy prona. Për këtë aktekspertimi është lëshuar fatura tatimore datë 14.11.2015 e shoqërisë “****” sh.p.k., nënshkruar nga znj. N.K. për blerje të shërbimit aktekspertimi me vlerë 36,000 lekë nga z. I.A. Sipas licencës dhe ekstraktit të kësaj shoqërie, rezulton se në objektet e aktivitetit të saj është edhe vlerësimi i pasurive të paluajtshme. Gjatë gjykimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë nuk është bazuar në këtë aktekspertimi të depozituar nga njëra prej palëve ndërgjyqëse, por ka caktuar një eksperte tjetër, e cila ka konkluduar sërish mbivendosje të dy pronave.

8.7 Në datën 4.4.2016, subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal sepse fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

8.8 Në dosjen e procedimit penal nr. *** nuk ndodhen: procesverbali i pyetjes së personit që ka bërë kallëzimin; shkresa drejtuar kallëzuesit për njoftimin e vendimit të pushimit të procedimit penal; përgjigjja e subjektit për kallëzuesin lidhur me kërkesën e tij për t’u njohur me ecurinë e kallëzimit dhe hetimit (veprim në kundërshtim me nenin 110 të Kodit të Procedurës Penale që përcakton se: *“Palët dhe përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, të paraqesin memorie dhe kërkesa me shkrim. Organi procedues shprehet me vendim brenda pesëmbëdhjetë ditëve”*).

8.9 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit për sa duket se subjekti i rivlerësimit: (i) nuk ka administruar aktet e hetimit në përputhje me nenin 315 të Kodit të Procedurës Penale “Dokumentimi i veprimeve të prokurorit”; (ii) nuk ka disponuar për kërkesën e kallëzuesit për t’u njohur me ecurinë e hetimit, duke moszbatuar kështu nenin 110 të Kodit të Procedurës Penale “Memoriet dhe kërkesat e palëve”.

¹⁹²Me shkresën nr. *** prot., datë 28.12.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Qëndrimi i subjektit të vlerësimit

8.10 Në prapësimet e barrës së provës, subjekti i rivlerësimit shpjegon se ka vendosur mosfillimin e procedimit duke u bazuar vetëm në shkresat që ka administruar nga institucionet dhe nuk e ka marrë në pyetje denoncuesin.

8.11 Në lidhje me konstatimin se në dosje nuk ndodhen shkresa drejtuar kallëzuesit për njoftimin e vendimit të pushimit të procedimit penal, subjekti shpjegon se në fashikullin e dosjes mungon faqja 3 pas vendimit që sipas listës së materialeve të dosjes i korrespondon këtij njoftimi. Nga verifikimi në arkivin e prokurorisë, subjekti ka vërejtur se në regjistrin e korrespondencës për vitin 2016 nuk ka shënime për dërgimin e vendimit ankuesit S.A. dhe, gjithashtu, dosja e këtij kallëzimi penal nuk figuron e regjistruar në këtë regjistër por në një listë të veçantë me shënimin “të ndryshme 2016”, bashkë me disa dosje të prokurorëve të tjerë dhe nuk ka dijeni pse nuk është regjistruar në regjistrin përkatës të arkivit të muajit prill 2016.

8.12 Subjekti shpjegon se nuk i kujtohet që denoncuesi S.A. të jetë paraqitur në zyrë në prokurorinë Fier dhe të jenë takuar, sepse nëse do të ishte paraqitur, takimi do të ishte dokumentuar. Subjekti nuk ka dijeni për kërkesën e denoncuesit për t’u njohur me dosjen, por pas verifikimit që ka kryer në arkivin e kryesekretarisë ka vërejtur se në librin e dorëzimit të ankesave është regjistruar kërkesa datë 8.1.2018 me nr. rendor ***, e shtetasit S.A., por nuk ka shënime se këtij personi i ka kaluar për kthim përgjigje dhe nëse i është kthyer ose jo përgjigje kësaj kërkesë.

8.13 Bashkëlidhur prapësimeve, subjekti ka depozituar: (i) kopjen e kapakut të fashikullit të kallëzimit; (ii) listën e materialeve të dosjes pas faqes nr. ***; (iii) kopjen e listës së dosjeve të arkivuara me shënimin “të ndryshme 2016”; (iv) kopjen e librit të ankesave të vitit 2018.

Vlerësimi i Komisionit

8.14 Komisioni, pasi shqyrtoi prapësimet dhe provat e depozituara bashkëlidhur, vlerëson se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit janë bindëse. Në rastin e mungesës në dosje të shkresës për njoftimin e vendimit të mosfillimit të procedimit, pavarësisht se është përgjegjësi e subjektit administrimi i dosjes, për shkak se kanë kaluar vite nga koha e mbylljes së kësaj dosjeje dhe nuk mund të evidentohet personi përgjegjës për këtë mungesë, vlerëson të mos ngarkojë me përgjegjësi subjektin.

Për sa më lart, Komisioni vlerëson së për këtë denoncim nuk konstatohen veprime që ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit.

9. Denoncim nr. * prot., datë 5.10.2018, nga shtetasi Xh.Xh.**

9.1 Denoncuesi është personi me të cilin subjekti ka pasur konflikt gjyqësor për disa vite në lidhje me pronësinë e banesës apartament me sip. 35 m², në ish-hotel “***” (trajtuar më lart në pikën A të relacionit). Denoncuesi pretendon se në disa konflikte gjyqësore ku ishte palë edhe bashkëshorti i subjektit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier dhe ajo e Apelit në Vlorë i rrëzonin kërkesat e tij si të pambështetura në prova dhe në ligj, sepse subjekti kishte miqësi familjare me shtetasen R.S. në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Denoncuesi kërkoi, gjatë gjykimit në Vlorë, përjashtimin e gjyqtarit Sh.S. (bashkëshorti i R.S.) dhe ky gjyqtar u përjashtua. Edhe OPGJ-ja i çështjes në Fier, E.H. kishte punuar me subjektin në Prokurorinë e Fierit. Denoncuesi ankohet edhe për veprime procedurale gjatë këtyre proceseve.

9.2 Rezulton se denoncuesi asnjë nga pretendimet e tij nuk i provon me prova shkresore bashkëlidhur denoncimit.

9.3 Bazuar në provat lidhur me këto konflikte gjyqësore që subjekti ka depozituar në përgjigje të pyetësorëve gjatë hetimit të pasurisë, si dhe nga dosjet që Komisioni ka administruar¹⁹³ nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, rezulton se denoncuesi ka pasur disa konflikte gjyqësore me bashkëshortin e subjektit për pronësinë e dhomës me sip. 36.5 m², që ndodhet në ish-hotel “***”, por në asnjë prej këtyre proceseve nuk ka qenë palë vetë subjekti i rivlerësimit. Denoncuesi i ka humbur të gjitha këto procese gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit.

9.4 Rezulton se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është regjistruar për gjykim çështja penale “përdorim dokumentesh të falsifikuara” në ngarkim të shtetasit Xh.Xh. Në seancën e dytë përgatitore, denoncuesi Xh.Xh. ka paraqitur kërkesën datë 8.10.2007, për përjashtimin e gjyqtarit të çështjes Sh.S., me motivin se bashkëshorten e tij R.S., gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, e ka parë të shoqëruar disa herë me prokuroren Violeta Shkurta që ka interes në këtë çështje që po gjykohet.

9.5 Në të njëjtën datë gjyqtari Sh.S. ka paraqitur kërkesën për dorëheqje nga gjykimi i kësaj çështjeje dhe në datën 10.10.2007 është zëvendësuar me një gjyqtar tjetër.

Për sa më lart, Komisioni nuk konstatoi mangësi që kanë të bëjnë me veprimet dhe figurën e subjektit të rivlerësimit.

10. Denoncim nr. * prot., datë 16.1.2019, nga shtetasi Xh.K.**

10.1 Denoncuesi pretendon se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier po gjykohet çështja penale nr. *** në ngarkim të shtetasve R.L. dhe Xh.M. dhe të dëmtuarit janë Xh. dhe F.K. Kjo gjykatë, me vendimin datë 21.12.2018, i ka kthyer aktet Prokurorisë Fier duke urdhëruar përsëritjen e transkriptimit të procesverbalit të përgjimit ambiantal datë 21.9.2017. Ky përgjim duhej të dërgohej për transkriptim në Prokurorinë e Përgjithshme, kurse subjekti e ka dërguar në Sektorin e Teknologjisë dhe Informacionit pranë Zyrës së Përgjimeve në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier, ku drejtues është H.Sh., bashkëshorti i subjektit. Kanë lindur të gjitha dyshimet se procesverbali i transkriptimit datë 21.9.2017 dhe procesverbali datë 26.12.2018 është ndryshuar duke hequr fjalë dhe duke i nxjerrë fjalët nga konteksti si rezultat i ndikimit të mundshëm. Denoncuesi kërkon zëvendësimin e subjektit me një prokuror tjetër sepse ekzistojnë shkaqe njëanshmërie dhe konflikti i interesit dhe madje vetë subjekti ka kërkuar dorëheqjen nga ky procedim.

10.2 Denoncim nr. * prot., datë 5.7.2019, nga shtetasja F.K.** Denoncuesja pretendon se subjekti ka ndjekur çështjen ku denoncuesja dhe familja e saj janë viktimat të vjedhjes në bashkëpunim me pasoja të rënda. Dy autorët kryesorë janë dënuar me vendim të formës së prerë, por subjekti është shprehur se ka edhe bashkëpunëtorë të tjerë dhe ka veçuar dosjen për zbulimin e tyre. Subjekti ka 3 vjet që nuk zbaton një vendim gjyqësor të formës së prerë për të marrë të dhëna kompjuterike nga shoqëria “Facebook” edhe pse kjo shoqëri është shprehur e gatshme të japë të dhëna nëse prokuroria i jep informacione shtesë. Pas kësaj, subjekti ka ndërprerë komunikimin me shoqërinë dhe ka pezulluar hetimet. Nga relacioni përfundimtar i OPGJ-së, del se shtetasja B.M. është implikuar në vjedhje dhe nga përgjimet ka dalë se ushtron edhe prostitucion, por subjekti nuk kryen asnjë veprim për arrestimin e kësaj shtetaseje.

10.3 Të dyja këto denoncime kanë lidhje me njëri-tjetrin sepse bëhet fjalë për të njëjtin procedim penal nr. ***, viti 2017, prandaj Komisioni administroi¹⁹⁴ dosjen e këtij procedimi dhe të procedimit penal nr. ***/2019, ku vëren se:

¹⁹³Me shkresën nr. *** prot., datë 27.9.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

¹⁹⁴Me shkresat: nr. *** prot., datë 28.12.2021, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier dhe nr. *** prot., datë 8.2.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (dosja e materialeve nga prokuroritë e rretheve).

10.4 Në datën 12.6.2017, Prokuroria Fier ka regjistruar procedimin penal nr. ***, viti 2017, për veprën penale “vjedhje” në ngarkim të shtetasve R.L. dhe Xh.M. Me vendimin datë 8.11.2018 “Për zëvendësimin e prokurorit” është zëvendësuar prokurori i çështjes me subjektin e rivlerësimit.

10.5 Në datën 19.11.2018, subjekti i rivlerësimit ka dërguar për gjykim shtetasit R.L. e Xh.M. dhe me vendimin datë 14.11.2018 ka veçuar materialet e çështjes, pasi dyshon se ka bashkëpunëtorë të tjerë dhe, për këtë, është regjistruar procedimi penal nr. ***, viti 2018, për hetime të mëtejshme për të identifikuar këta bashkëpunëtorë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. ***, datë 26.4.2019, ka vendosur deklarinimin fajtor dhe dënimin e tyre përkatësisht me 5 vjet e 4 muaj burgim dhe 6 vjet burgim. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 6.11.2019.

10.6 Gjatë hetimeve të procedimit penal nr. ***/2017, me vendimin nr. ***, datë 25.5.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur lejimin e marrjes së të dhënave dhe komunikimeve nga adresat e shoqërisë “Facebook” të shtetasve R.L. dhe Xh.M. (disponimi i IP-së që i përkasin adresës së shtetasve Xh.M. në Facebook, të dhënat e logimit që i përkasin adresës www.facebook.com dhe administrimi i komunikimeve midis adresave të mësipërme për harkun kohor 1.5.2017 - 1.9.2017). Shoqëria “Facebook”, me shkresën datë 20.7.2018, konfirmon se të dhënat e dërguara asaj (adresat link të profileve) nuk janë të sakta dhe nevojitet një vendim i ri ku të shënohen të sakta adresat e profileve objekt hetimi.

10.7 Gjatë hetimeve për procedimin penal nr. ***, viti 2018, me kërkesën e subjektit të rivlerësimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me vendimin nr. ***, datë 18.1.2019, ka vendosur marrjen e të dhënave nga shoqëria “Facebook” për komunikimet midis bashkëpunëtorëve të veprës penale.

10.8 Në korrespondencën e datës 4.3.2019 shoqëria “Facebook” kërkon nga Prokuroria Fier të dhëna të tjera (përfshirë mënyrën se si është përfshirë llogaria e kërkuar në hetim, nenin e Kodit Penal, vendndodhjen e informacionit, përmbajtjes në profil, URL dhe pamjen e ekranit të përmbajtjes në fjalë) për të dërguar informacionin që ajo i kërkon, por subjekti pas kësaj date nuk ka pasur më komunikim me shoqërinë “Facebook”. Në datën 30.7.2019, bazuar në nenin 326/1 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pezullimin e procedimit penal nr. *** dhe dërgimin e akteve në Komisarriatin e Policisë Fier me arsyetimin se i ka dërguar të gjitha të dhënat që disponon, por nuk u bë e mundur marrja për bashkëpunëtorët e tjerë.

10.9 Bashkëshortët K. e kanë ankimuar vendimin e pezullimit dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. ***, datë 2.12.2019, ka vendosur mospranimin e ankimit me arsyetimin se Prokuroria i ka kryer të gjitha veprimet e mundshme hetimore në kuadër të procedimit penal nr. ***, gjithashtu, në analizë tërësore të akteve të fashikullit, evidentohet dijenia dhe indicia për përkrahjen e autorëve të veprës nga shtetasja B.M., por në bazë të neneve 300 dhe 302 të Kodit Penal kjo shtetase përjashtohet nga përgjegjësia penale për shkak të lidhjes gjinore me shtetasin Xh.M. (vëllai i saj). Duke qenë se vendimi gjyqësor që vlerëson vendimin e pezullimit të hetimeve është i paankimueshëm, ka marrë formë të prerë.

10.10 Nga përmbajtja e vendimit nr. ***, datë 26.4.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier rezulton se përgjimi ambiental i shtetasve R.L. dhe Xh.M. është transkriptuar në datën 26.12.2018 nga Seksioni i Teknologjisë pranë Drejtorisë së Policisë Fier në zbatim të vendimit datë 21.12.2018, të gjyqtarit të seancës paraprake. Pra, subjekti i rivlerësimit, në këtë rast, ka zbatuar një vendim gjyqësor.

Për sa më lart, Komisioni nuk konstatoi mangësi në veprimet procedurale të subjektit të rivlerësimit.

11. Denoncim nr. * prot., datë 5.7.2019, nga Zyra e Përmbarrimit Gjyqësor “****” sh.p.k.**

11.1 Kjo Zyrë Përmbarrimore pretendon se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. ***, ka vendosur pranimin e ankimit dhe kthimin e dosjes përmbarrimore nr. ***, datë 25.11.2018, që i është sekuestruar kësaj zyre përmbarrimore sipas vendimit nr. ***, datë 24.12.2018. Kjo dosje ka objekt ekzekutimin e vendimit nr. ***, datë 25.9.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Zyra Përmbarrimore i është drejtuar subjektit me kërkesë datë 28.6.2019, kurse në datën 4.7.2019 i drejtoi kërkesë prokurorëve E.Sh. dhe E.H. dhe për dijëni subjektit të rivlerësimit që t’i kthehet dosja përmbarrimore nr. ***, datë 25.11.2018, por nuk ka marrë përgjigje. Në këtë mënyrë, zyra pretendon se subjekti po bëhet pengesë për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Zyra përmbarrimore ka depozituar kërkesat si më lart.

11.2 Komisioni, pasi administroi¹⁹⁵ vendimin nr. ***, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, vëren se: pas fillimit të procedurave përmbarrimore nga Zyra e Përmbarrimit Gjyqësor “****” sh.p.k. për ekzekutimin e vendimit nr. ***, datë 25.9.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, debitori, shoqëria “****” sh.p.k. ka bërë kallëzimin nr. *** ndaj kësaj zyre përmbarrimore për veprat penale “ekspertim i rremë” dhe “shpërdorim detyrë”. Për qëllime të hetimit, me vendimin nr. ***, datë 24.12.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur sekuestrimin e dosjes përmbarrimore dhe kjo dosje u sekuestrua nga subjekti i rivlerësimit në datën 1.2.2019.

11.3 Debitori shoqëria “****” sh.p.k., pasi i ka kërkuar disa herë subjektit të rivlerësimit kthimin e dosjes përmbarrimore, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, e cila me vendimin nr. ***, datë 12.6.2019, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe detyrimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier që të kthejë dosjen përmbarrimore. Me vendimin nr. ***, datë 9.7.2019, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 12.6.2019, dhe rrëzimin e kërkesës së Zyrës Përmbarrimore “****” sh.p.k. Nuk rezulton që të jetë bërë ankim kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë.

11.4 Meqenëse ligjshmëria e veprimeve të prokurorit gjatë hetimeve paraprake është gjithmonë objekti i kontrollit gjyqësor, përfshirë këtu edhe vendimin e prokurorit për të refuzuar kthimin e sendeve të sekuestruara gjatë kësaj faze, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit me veprimin e tij ka zbatuar vendimet gjyqësore nr. ***, datë 24.12.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe nr. ***, datë 9.7.2019, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe, për këto arsye, nuk mund t’i kthente denoncuesit dosjen përmbarrimore.

Për sa më lart, Komisioni nuk konstatoi mangësi në veprimet procedurale të subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë denoncim.

12. Denoncim nr. *prot., datë 2.8.2021, nga shtetasi O.X.**

12.1 Denoncuesi pretendon për veprime të disa subjekteve të rivlerësimit midis tyre edhe të prokurores Violeta Shkurta, si: mbyllje të hetimeve të paplota, zhdukje të fashikullit me prova materiale, etj., por denoncuesi nuk jep detaje, përveç një dosje penale me nr. ***, viti 2020, me numër protokollit *** dhe datë 22.10.2020, regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

12.2 Bashkëlidhur denoncimit, shtetasi O.X. ka depozituar midis të tjerash, padinë penale datë 16.6.2021, të depozituar prej tij në Gjykatën e Posaçme Tiranë, në ngarkim të disa subjekteve të rivlerësimit, përfshirë edhe subjektin Violeta Shkurta, ku denoncuesi pretendon për: zhdukje ose humbje të fashikullit; fillim të paligjshëm të ndjekjes penale; veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës; kryerjen e veprimeve arbitrare; shkelje të barazisë së

¹⁹⁵Me shkresën nr. *** prot., datë 22.12.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

shtetasve; mosmarrje të masave për ndërprerjen e gjendjes së paligjshme; shpërdorim detyre; mosnjohim i të pandehurit me vendimin e përfundimit të hetimeve.

12.3 Komisioni, pasi administroi¹⁹⁶ dosjen e procedimit penal nr. ***/viti 2020 dhe aktet bashkëlidhur denoncimit, vëren se: mbi bazën e kallëzimit penal nr. ***, datë 15.9.2020, të Drejtorisë së Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve ndaj denoncuesit, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, në datën 18.9.2020, është regjistruar procedimi penal nr. ***, datë 15.9.2020, për veprën penale “goditje për shkak të detyrës” (neni 237 i Kodit Penal). Për këtë çështje është caktuar prokurori P.V. dhe jo subjekti i rivlerësimit. Kjo çështje është duke u gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

12.4 Subjekti i rivlerësimit ka firmosur me cilësinë e titullares së prokurorisë këto akte: (i) shkresën nr. *** prot., datë 18.9.2020, drejtuar IEVP-së Fier për të dërguar kopje të librit të shërbimit të punonjësve që kanë qenë në detyrë në datën e ngjarjes; (ii) shkresën përcjellëse datë 22.10.2020, të kërkesës për dërgimin e çështjes për gjykim drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; (iii) shkresën drejtuar të pandehurit O.X., ku i komunikon dërgimin e kërkesës në gjykatë për gjykimin e çështjes.

12.5 Sipas librit të planizimit të shërbimit të Godinës ***, i dërguar nga IEVP-ja Fier pranë Prokurorisë Fier, nuk figuron në grupin e shërbimit në datën 14.9.2020 (turni i parë) Inspektori i Sektorit D.V., i cili sipas procesverbalit të pyetjes datë 14.9.2020, ka deklaruar se neutralizoi veprimet fizike të shtetasit O.X. në qelinë e burgut.

12.6 Në informacionin për referimin e veprës penale datë 15.9.2020, OPGj-ja kërkon fillimin e procedimit penal për veprën penale “goditje për shkak të detyrës”, e mbetur në tentativë. Në të gjitha aktet e dosjes (procesverbalet e pyetjes së personave që kanë dijeni për ngjarjen, procesverbali për kallëzimin e krimit datë 14.9.2020, raporti i incidentit datë 14.9.2020, etj.) citohet se shtetasi O.X., në datën 14.9.2020, ka tentuar t’i hedhë vaj të nxehtë ndihmësinfermierit të IEVP-së Fier, por ndërhyjnë policët e sigurisë dhe nuk erdhi asnjë pasojë e dëmshme. Nga ana tjetër, prokurori i çështjes, në vendimin e komunikimit të veprës penale dhe në kërkesën për gjykim drejtuar gjykatës, edhe pse citon që veprimet e policëve që neutralizuan veprimet e shtetasit O.X. për të hedhur vaj të nxehtë drejt tyre, sërish e klasifikon veprën si “goditje për shkak të detyrës” pa përmendur faktin që kjo veprë mbeti në tentativë.

12.7 Me urdhrin datë 18.9.2020, “Për delegimin e veprimeve hetimore” prokurori i çështjes urdhëron OPGJ-në që të kryejë disa veprime hetimore, midis të tjerash edhe administrimin e pamjeve filmike të kamerave të burgut, por në dosje nuk ndodhet procesverbali i sekuestrimit të këtyre kamerave.

12.8 Në dosjen hetimore ndodhen disa vendime gjyqësore¹⁹⁷ dhe vërtetimi i gjendjes gjyqësore datë 13.10.2020, ku rezulton se shtetasi O.X. ka qenë i dënuar edhe për vepra të tjera penale.

12.9 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier konfirmon¹⁹⁸ se kjo çështje është duke u gjykuar pranë kësaj gjykatë.

¹⁹⁶Me shkresën nr. *** prot., datë 28.12.2021, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier dhe me shkresën nr. *** prot., datë 22.12.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

¹⁹⁷Vendimi nr. ***, datë 22.12.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë për dënimin e tij për veprën penale “mashttrim”; vendimi nr. ***, datë 1.4.2019, i Gjykatës së Apelit Vlorë për dënimin e shtetasit O.X. për veprën penale “vjedhje me anë të mashtimit”; vendimi i formës së prerë nr. ***, datë 13.12.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për dënimin e shtetasit O.X. për veprën penale “mashttrim”; vendim i formës së prerë nr. ***, datë 2.7.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për dënimin e shtetasit O.X. për veprën penale “mashttrim”.

¹⁹⁸Me shkresën nr. *** prot., datë 22.12.2021, drejtuar Komisionit.

12.10 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit nga ku duket se nuk janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore; është bërë kualifikim i gabuar i figurës së veprës penale dhe megjithëse procedimi penal është ndjekur nga një prokuror tjetër, subjekti i rivlerësimit Violeta Shkurta si drejtuese e Prokurorisë Fier nuk ka ushtruar kompetencat e saj që i përcakton neni 43 i ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” pika b) kërkon informacion për ecurinë e procedimeve dhe nëse është e nevojshme, nxjerr udhëzime me shkrim sipas këtij ligji; pika ç) verifikon ecurinë dhe përfundimin e çështjeve dhe, kur është e nevojshme, udhëzon me shkrim sipas nenit 48 të këtij ligji kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale përpara se të merret vendimi mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

12.11 Në prapësime, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se me cilësinë e titullares, pasi është njohur me aktet e procedimit penal, ka vlerësuar se hetimet janë të plota dhe cilësimi juridik i veprës penale është i drejtë. Veprimet e të pandehurit O.X. nuk kanë mbetur në tentativë, por janë kryer dhe plotësojnë elementët e veprës penale.

12.12 Në lidhje me konstatimin e Komisionit se subjekti nuk ka ushtruar kompetencat që i përcakton neni 43 pika b), i ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” subjekti ka shpjeguar se neni 48/3 i këtij ligji përcakton se udhëzimet jo të detyrueshme për çdo çështje konkrete mund të jepen në momentin e caktimit të çështjes për ndjekje prokurorit ose, më pas, kur vlerësohet e nevojshme për mbarëvajtjen e ecurisë së procedimit. Pra, sipas kësaj dispozite, ndërhyrja e Drejtuesit të Prokurorisë nuk është e detyrueshme për çdo çështje. Në praktikë, për shkak të ngarkesës së madhe të punës, ndërhyrja vlerësohet rast pas rasti në raport me rëndësinë e faktit penal, ngjarje të rënda dhe sensitive, pretendime të palëve në proces, etj.

12.13 Në rastin konkret, subjekti shpjegon se nuk e ka parë të nevojshme të ndërhyjë për të nxjerrë ndonjë udhëzim për këtë çështje, pasi nuk ka pasur pretendime apo kërkesa nga i pandehuri ose mbrojtësi i tij për marrje provash apo hetime të tjera, fakti penal ka qenë i qartë, janë kryer hetime të plota dhe brenda afateve. Me vendimin nr. ***, datë 18.1.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, i pandehuri është dënuar për veprën penale për të cilën është akuzuar.

12.14 Bashkëlidhur prapësimeve, subjekti i rivlerësimit ka depozituar vendimet nr. *** datë 22.9.2020, nr. *** datë 17.12.2020 dhe nr. *** datë 18.1.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Vlerësimi i Komisionit

12.15 Pasi shqyrtoi prapësimet e subjektit dhe provat e depozituara nga subjekti, Komisioni vlerëson që shpjegimet e subjektit janë të mjaftueshme dhe bindëse dhe, për këtë arsye, ato janë marrë në konsideratë.

Për sa më lart, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për sa pretendohet në këtë denoncim.

Në përfundim të hetimit të kriterit profesional, duke parë në tërësi dhe llojshmëri konstatimet që rezultuan nga hetimi, Komisioni vëren se mangësitë e vërejtura të subjekti i rivlerësimit në ushtrimin e detyrave të tij, nuk vlerësohen të rënda deri në atë

masë, saqë ndaj subjekti të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra në lidhje me kriterin profesional duke u konsideruar, kështu, “i aftë” në lidhje me këtë kriter.

Qëndrimi përfundimtar i subjektit

Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti ka deklaruar që vlerëson se me të gjitha provat, argumentet dhe shpjegimet që ka dhënë gjatë dy seancave, si dhe me provat në vazhdimësi: ka provuar të kundërtën e barrës së provës të caktuar nga Komisioni; ka provuar se pasuria e familjes së saj është e ligjshme; buron nga burime të ligjshme; të ardhurat e familjes mbulojnë pasurinë; kostot e jetesës; shpenzimet; ka plotësuar kriterin në lidhje me figurën; me përshtatshmërinë për të vazhduar në lidhje me figurën; ka arritur nivelin në lidhje me vlerësimin profesional; nivelin kualifikues në lidhje me vlerësimin profesional dhe i kërkon Komisionit që ta konfirmojë në detyrë.

VLERËSIMI I ÇËSHTJES NGA TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

Trupi gjykues, referuar nenit D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës, kreut IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, në provat e administruara, në raportin dhe në rekomandimet e relatorit të çështjes, në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludoi se subjekti i rivlerësimit Violeta Shkurta:

a) Ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë.

Nga analiza financiare rezulton se me të ardhurat e fituara nga punësimi i saj dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur burime të mjaftueshme financiare për kryerjen e investimeve dhe të shpenzimeve të deklaruara duke rezultuar me një balancë financiare negative prej 18,307,828 lekësh, para dhe gjatë detyrës, si dhe personi i lidhur gjatë periudhës së divorcit.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit Violeta Shkurta nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

b) Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

c) Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues çmon se referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë”, duke arritur nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

Bazuar në konkluzionet sa më sipër, si dhe në vlerësimin tërësor të procedurave në kuptim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit Violeta Shkurta nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, në pikat 1, 2, 3 dhe 5, në nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të pikës 1/c të nenit 58 dhe të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Violeta Shkurta, Drejtuese e Prokurorisë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 28.2.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes SHULI
Kryesuese

Olsi KOMICI
Relator

Xhensila PINE
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj